



**TITULLI ORIGINAL**  
**AËLEDE IKË CËHAN SAÂDETI**

**PËRKTHEU**  
Elona Sytari

**REDAKTOI**  
Dr. Irida Hoti

**FAQOSJA**  
Bledar Xama

**BOTIMI I**  
Qershor 2020, Shkodër

**PROGRESI BOTIME**  
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti  
Shkodër, Shqipëri  
Mob: +355 67 340 6182

# LUMTURIA FAMILJARE

Osman Nuri TOPBASH



وَمَا تَوْفِيقِي إِلَّا بِاللَّهِ

## Parathënie

Falënderimet dhe lavdërimet e pafundme qofshin për Krijuesin Fuqiplotë,

Salavate dhe selame të pafundme qofshin për të Dërguarin e Allahut.

Lexues të shtrenjtë,

Allahu i Lartësuar e dërgoi Pejgamberin ﷺ si “usve hasene” pra, si shembullin më të përkryer në çdo çështje, përfshirë këtu edhe jetën familjare.

Nisur nga kjo, ringjallja dhe shpëtimi i jetës familjare të cilat po vihen gjithnjë e në rrezik nga tronditjet dhe amullia shpirtërore e kohëve të fundit, mund të arrihen vetëm përmes ndjekjes së modelit profetik si burim edukimi për sa e sa personalitete shembullore.

Nga Ai ﷺ burojnë shembujt më të bukur dhe më të duhur. Tek Ai ﷺ gjendet i gjithë sekreti dhe metoda edukuese në arritjen e prehjes, dashurisë dhe ekuilibrit në marrëdhëniet bashkëshortore, po aq edhe në edukimin e pasardhësve në mënyrën më të përkryer duke i kthyer ata në çinarë të palëkundur.

Mirëpo, kur zbatojmë në praktikë jetën e Tij familjare si një udhëzues të përkryer të njerëzimit, nuk duhet rënë pre e syzeve, lenteve të turbullta, rrymave dhe mentaliteteve të huaja, por duhen ndjekur shembujt e pastër dhe unik nga jeta profetike familjare. Përndryshe endja pas ndikimit të një bote që reflekton mbeturinat e kapitalizmit, komunizmit, ateizmit, deizmit apo rrymave të tjera, mashtrimi pas qasjeve dhe botëkuptimeve të pavlera, nuk është gjë tjetër veçse një sflitje e kotë. Edhe nëse këtyre botëkuptimeve t'u shtohet fjala Islam, asgjë prej tyre nuk mund të pasqyrojë strukturën e vërtetë familjare profetike.

Vetëm Hz. Muhamedi dhe Ehl-i Bejti<sup>1</sup> janë mishërimi i vërtetë i modelit familjar profetik.

Si u ndërtua ky model?

---

1. Familja e Pejgamberit.

Ky model u ndërtua në një klimë të brumosur me besim, devotshmëri dhe virtyte të jashtëzakonshme.

Modeli i tij familjar;

Ishte larg një pafundësie ëndrrash të zbrazëta që ka filluar të shpërbëjë çdo familje, përfshirë këtu edhe atë Islame, ishte larg një vargu pritshmëri të pakuptimta, larg çdo lakmie dhe merakosjeje ndaj kësaj bote të kamufluar me pretekstin e botës tjetër; Modeli i tij familjar ishte ndërtuar mbi kënaqësinë e Allahut. Mbi kënaqësinë legjitime të anëtarëve të familjes. Këto familje ishin brumosur me devotshmërinë që stoliste shpirtrat me paqe dhe lumturi. Baballarët ishin shtylla e palëkundur e shtëpisë. Ndërsa nënat ishin prehri i sa e sa bijve trima që edukoheshin me aq shumë përkushtim.

Modeli i tij familjar;

Ndërtohej mbi mbështetjen tek Allahu dhe dorëzimin në caktimin hyjnor.

Në modelin e tij familjar;

Respektohej kufiri midis hallallit (të lejuarës) dhe haramit (të ndaluarës) dhe nuk bëhej asnjë lëshim sado i vogël kur flitej për Islamin dhe qëndrueshmërinë në fe.

Në modelin e tij familjar;

Përtej ulje-ngritjeve të jetës, virtytet mbe-

tën të paprekshme, respekti i ndërsjellë ishte i natyrshëm, dashuria e sinqertë ishte aq e pastër, dorëzimi i robit ndaj Krijuesit ishte i palëkundur.

Në modelin e tij familjar;

Nuk mbizotëronte frika nga shkrumbi i xhehenemit, por zelli për paqen e xhenetit.

Sepse modeli i tij familjar;

Nuk ishte një model i njëanshëm i zhytur në kërkim të kënaqësisë dhe rehatisë së jetës së kësaj bote. Nuk ishte një mashtrim i kufizuar vetëm në qëllime dhe dëshira të përkohshme. Përkundrazi modeli i tij ishte ngritur mbi bazën e realitetit njerëzor. Thënë ndryshe, krijimi i një hapësire lumturie dhe paqeje në këtë botë, po aq edhe arritja e lumturisë dhe paqes në botën e amshueshme.

Si një shoqëri e tërë jemi aq nevojtarë për një model të tillë familjar...

Sepse;

Për fat të keq në ambientet tona familjare por përjetohen trazira dhe shqetësime të thella po aq sa edhe në ambientet e jashtme. Zemërimi në zemrat e njerëzve nuk di të shuhet. Jemi në një udhëkryq ku interneti, moda e qasjet e helmua filozofike, kanë robëruar dhe rrënuar shpirtin njerëzor. Kemi dy rruge ose të lartësojmë edhe një herë vlerat e familjes siç bënë të parët tanë duke arritur si



komb virtytet dhe lumturinë e përhershme që i japin drejtimin e duhur krejt njerëzimit ose (Zoti na ruajt!) krejt e kundërta.

Zgjidhja jonë e vetme;

Është të frymëzohemi nga jeta shembullore e Profetit tonë të nderuar siç bëri Ehli Bejti, sahabët fisnikë apo të parët tanë. T'i rikthehemi edhe një herë atij modeli të pashoq, të hijshëm dhe plot elegancë.

Duhet të rikujtojmë se;

Bashkëshortet e Pejgamberit a.s. fituan emrin / *أُمَّهَات* / nënat e besimtarëve edhe pse ato nuk sollën në jetë fëmijë. Siç dihet vetëm Hz. Hatixhja dhe Hz. Marija lindën fëmijë. E megjithatë të gjitha u regjistruan në librin hyjnor si ummehat/ nënat e besimtarëve.

Sepse ato u bënë shembulli i dhembshurisë dhe mëshirës si fryti më i pastër i mëmësisë. Ato thirrën bashkëshortet e sahabëve në rrugën e fesë. Ato blenë robëresha për t'ua falur lirinë, rritën jetime dhe i martuan. U bënë udhërrëfyese për këdo që priste një dritë udhëzimi.

Prandaj,

Të gjitha gratë e devotshme të këtij umeti duhet të dinë të marrin shembull nga gjendja shpirtërore e nënave të besimtarëve.

Nënat fisnike të historisë sonë arritën ta

realizonin këtë qëllim. Mundësitë materiale të kësaj bote arritën t'i kthenin në përfitim për botën tjetër duke ndërtuar sa e sa vakufë e duke lënë pas shumë vepra bamirësie. Ndërtuan xhami, komplekse, mensa për të varfërit, çezme, spitale. Ato u kujdesën për jetimët, vejushat, të përvuajturit e të pashpresët duke u dhuruar një përkujdesje që ne as mund ta imagjinojmë. Për shembull ato ngritën vakufe që dëmshpërblenin edhe vlerën e një pjate të thyer nga një shërbëtor në mënyrë që ai të mos ndihej i poshtëruar. Dora e tyre e mëshirës u shtri edhe për zogjtë shtegtarë.

Kjo nuk ishte veçori vetëm e shtresës së lartë të shoqërisë, por e gjithë atyre zemrave të mbushura me besim që vrapuan drejt karvanit të shërbimit dhe përpjekjes. Ato ishin nënat e tërë shoqërisë.

Në të njëjtën kohë, familjet shpalosën vlerat e vëllazërimit përmes dashurisë dhe respektit të ndërsjellë mes tyre. Ata u bënë bashkë si në gëzime ashtu edhe në hidhërimi.

Nënat e asaj kohe i nisën bijtë e tyre në frontin e luftës thujse po i përgatisnin për dasmë. Sepse ato vlerësonin fenë, atdheun, nderin dhe pastërtinë më shumë se gjithçka tjetër.

Edhe ne sot duhet t'i shpëtojmë amullisë dhe rrymave të helmuara të perëndimit që

trumbetojnë feminizmin dhe barazinë gjinore dhe të përpiqemi t'i kthehemi shembullit të nënave tona që arritën lumturinë e të dy botëve.

Në mënyrë të veçantë,

Çdo zonjë e këtij umeti duke u frymëzuar nga nënat e besimtarëve të Epokës së Lumturisë, duhet të përpiqet të jetë një nënë e vërtetë përmes mëshirës dhe dhembshurisë së natyrshme pavarësisht nëse Zoti i ka dhuruar apo jo fëmijë. Ajo duhet t'i qaset me ndjenjën e përgjegjësisë çdo fëmije dhe në mënyrë të veçantë fëmijëve jetim dhe të braktisur. Duhet të jetë këmbëngulëse për të arritur një mëmësi të denjë për filizat e rinj që presin një udhërrëfyes.

Po ashtu,

Çdo besimtar duhet të jetë babai i bijve të umetit.

Me pak fjalë,

Të gjithë së bashku përmes familjeve tona duhet të ndërtojmë dhe t'i japim jetë lumturisë së dy botëve. Çdo familje duhet të ndërtohet mbi bazën e dy kahjeve.

Pra,

Struktura jonë familjare duhet të bazohet mbi edukatën dhe parimet profetike në mënyrë që të formësohet një jetë e duhur në

këtë botë dhe të arrihet jeta e përsosur në Ahiret.

Për këtë qëllim,

Kemi përgatitur këtë libërth që mbani në duar. Fjalët janë modeste dhe libri është i vogël, por qëllimi ynë është i lartë.

E lusim Krijuesin Fuqiplotë të na mbrojë ne dhe brezat e rinj nga trazirat e kohës. Të na kthejë çerdhen tonë familjare në një vatër xheneti.

T’i dhurojë çdo familjeje lumturinë e dy botëve, larg mashtrimit nga jeta e përkohshme e kësaj bote.

Dhe kështu e ktheftë këtë vatër në një klimë të lartë xheneti (në një dimension të lartë shpirtëror) ku u edukuan personalitete shembullore, si: Ebu Hanifja, Fatih Sulltan Mehmeti, Nakshibendiu, Yunus Emre, Hudaji etj...

**Amin!**

**Osman Nuri TOPBASH**

Janar 2020, Xhemadë'l-ahir 1441

Akmesxhid

---

Shënim: Falënderoj M. Ali Eshmeli dhe M. Asim Kycykashçë për kontributin e tyre në përgatitjen e këtij libri dhe i lutem Zotit të Gjithësisë që përpjekjet e tyre të jenë një sadaka rrjedhëse.



# NJË KRAHASIM MIDIS SË SHKUARËS DHE TË TASHMES

Babai im i shtrenjtë, Musa Efendiu në vitin 1987 shkroi një artikull. Shkrimi sillte në vëmendje disa skena nga jeta familjare dhe shoqërore të vendësve të Stambollit të kohës së fëmijërisë së tij dhe mbante titullin:

## DALLIMI 60 VJEÇAR I EDUKATËS NË JETËN TONË SHOQËRORE

Mbase në aspektin kohor ky dallim është zgjeruar thuajse në një shekull por në aspektin praktik kemi krijuar një hendek shumë më të madh nga ajo shoqëri elitare.

Le të lexojmë disa rreshta plot mesazhe të vyera nga ky artikull dhe më pas të përpiqemi të hedhim dritë për një shoqëri të pastër, të thjeshtë plot dashuri dhe paqe. Musa Efendiu tregon:

“Isha afërsisht shtatë apo tetë vjeç. Mërzitem dhe pikëllohem shumë kur kujtoj sinqeritetin, dashurinë dhe mirësjelljen ndaj njëri-tjetrit të njerëzve të Erenkojit, aty ku kalova fëmijërinë time dhe vërej që nuk ka të krahasuar me ditët e sotme.

Të gjithë e donin njëri-tjetrin sinqerisht dhe ndanin çdo gëzim dhe çdo pikëllim sikur të ishin anëtarë të një familjeje të përbashkët. Të gjithë bëheshin bashkë në dasma dhe kalonin ditë të bukura dhe të këndshme.

Të sëmuret vizitoheshin, u thuheshin fjalë të ëmbla dhe më fytyra të qeshura thuajse iu lehtësoheshin sado pak dhimbjet.

Të varfërit, nevojtarët, të brengosurit ndihmoheshin për hir të Allahut nga çdo kush me aq sa kishte mundësi.

Të pasurit ishin përherë pranë të varfërve.

Doktorët u qaseshin të sëmurëve me mëshirën e një prindi dhe shumë herë u blenin ilaçet të varfërve nga xhepi i tyre.

Kur kishte një rast vdekjeje të gjithë banorët e lagjes merrnin pjesë në xhenaze dhe ndjenin keqardhje sikur të ishin dashamirët më të afërt, ngushëllonin familjen dhe u dërgonin atyre ushqim për ditë të tëra.

Të gjithë kishin respekt të plotë për njëritjetrin.

Në vend të të ashtuquajturve të ditur të kohëve tona, kishte shumë “të paditur” që dinin ç’është respekti dhe nderi.

Mbizotëronte vëllazëria midis njerëzve pa dallim moshe apo pasurie. Askush nuk mburrej me atë që hante e pinte, apo me çka vishej. Ata e dinin se gjithçka është mirësi nga Krijuesi Fuqiplotë prandaj e falënderonin Atë së tepërmi. Ata nuk shpërdoronin, ndërsa me pasurinë e mbledhur mbronin të varfërit, vejushat, jetimët dhe lumturoheshin nga ndihma materiale dhe shpirtërore që u jepnin të rinjve në pamundësi për të krijuar familje.

Askush nuk sillej me dashakeqësi, smirë e përgojim. Edhe sikur të ndodhte e kundërta të gjithë e dinin se do haste në reagime qor-

tuese nga të tjerët dhe do humbiste respektin në shoqëri.

Pas adhurimeve farz (të detyrueshme) “gëzimi i zemrës së besimtarit” vlerësohej si adhurimi më i rëndësishëm. Përherë thuheshin fjalë të ëmbla e që qetësonin shpirtin.

Njerëzit nuk trazonin njëri-tjetrin me poshtërimi e përbuzje. Të rinjtë silleshin me respekt ndaj të moshuarve, ndërsa të moshuarit silleshin me mëshirë ndaj të rinjve. Fjala e prindërve nuk bëhej dysh por respektohej pa kushte, plotësisht.

Të rriturit tregoheshin të kujdesshëm të silleshin me pjekuri ndaj të vegjëlve në mënyrë që ata të mos llastoheshin, por të bëheshin individë të pjekur, seriozë e dinjitozë të së ardhmes.

## KARAKTERI

Gjatë bajrameve dhe netëve të mëdha, veçanërisht gjatë 30 ditëve të muajit të Ramazanit, të pasurit shtronin sofrë gostie për të varfërit. Të gjithë gëzonin në ato sofrë, pa dallim pozite e pasurie. Bamirësit ndihmonin shumë të varfërit e jetimët.



## RESPEKTI PRINDËROR

Më herët nuk ka patur ditë të veçanta feste për nënën apo babain siç shohim rëndom në ditët e sotme.

Fëmijët e edukuar me frymën islame tregojnë përherë respekt ndaj prindërve, u shërbejnë dhe plotësojnë çdo nevojë të tyre. Nuk ua diskutonin fjalën.

Një pasardhës i tillë i ushqen prindërit e tij gjatë gjithë jetës dhe i bën dhurata sipas mundësisë materiale. Nga kjo ndjen kënaqësi. Po aq fiton edhe kënaqësinë e Allahut Fuqiplotë.

## EDUKIMI I FËMIJËS

Edukimit të fëmijës i kushtoj shumë rëndësi, doza e të ushqyerit nuk përcaktohet sipas tekave të fëmijës dhe nuk plotësohet detyrimisht çdo dëshirë e paarsyeshme. Në këtë mënyrë fëmija shtyhet të edukohet drejt një lloj bindjeje se jo çdo dëshirë e tij mund të realizohet. Po aq i kushtoj rëndësi edhe brumosjes së fëmijës me vlera fetare, kombëtare dhe shoqërore; edukimit të tij me moral të bukur, ndjesinë e turpit dhe drejtësisë.

Anëtarët e familjes mblidheshin në sofrën e tyre të përbashkët për të konsumuar ushqimin nën një klimë dashurie. Nuk kishte

orare të ndara, të ndryshme për nënën, babain apo fëmijët. Mbas mbrëmjes zakonisht qëndrohej në shtëpi, nganjëherë vizitoheshin të afërmit ose u shërbehej mysafirëve me mikpritje, fytyrë të qeshur dhe gjuhë të ëmbël. Bisedat me fëmijët zhvilloheshin në atë nivel që ata të kuptonin.

Fëmijët nuk shkonin askund pa marrë pëlqimin e prindërve dhe respektonin orarin e kthimit në shtëpi kur merrnin leje.

## EDUKATA E TË FOLURIT

Nuk flitej në mënyrë të zbrazët dhe të pakuptimtë.

E folura me zë të lartë në prani të të mëdhenjve dhe njerëzve të ngritur, konsiderohej diçka e turpshme dhe sjellje e pahijshme. Fëmijët nuk uleshin asnjëherë në krye si rrjedhojë e edukatës me të cilën ishin brumosur në familjet e tyre.

## QETËSIA SHPIRTËRORE DHE PAQJA QË BURONTE NGA NDJENJA E MJAFTUESHMËRISË

Atdheu i sapoçliruar nga forcat pushtuese të armikut (pas Luftës së Parë Botërore) dukej shumë i varfëruar. Për shkak të mungesës së

\_\_\_\_\_ Një krahasim midis së shkuarës dhe të tashmes

ushqimit ishin shfaqur një sërë sëmundjesh. Xhepat ishin boshatisur. Varfëria mbizotëronte çdokund.

Sidoqoftë kjo skamje nuk shtyu askënd në pesimizëm e pikëllim. Sepse e rëndësishme ishte fitorja e arritur ndaj armikut. Të gjithë falënderonin Krijuesin Fuqiplotë dhe zemrat ishin plot paqe dhe lumturi.

Sot bashkë me mirëqenien ka shumë probleme, shqetësime shpirtërore e pikëllime, ndërsa atëherë kishte skamje, por kishte më shumë qetësi shpirtërore.

Në vend të grumbullimit të pasurisë pa pyetur nëse është hallall (e lejuar) apo haram (e ndaluar), atëherë njerëzit mjaftoheshin me atë që kishin. Çdokush para se të mendonte rehatinë dhe përfitimin vetjak, shqetësohej për komshiun dhe të afërmit. I pari i familjes sillej me shumë butësi dhe mëshirë ndaj pjesëtarëve të tjerë. Të gjithë së bashku mundoheshin të praktikonin urdhrat e Krijuesit të Gjithësisë në mënyrë sa më të plotë.

Nuk kishte shpërdorim e harxhime pa kriter. Secili i llogariste shpenzimet sipas të ardhurave që kishte.

## PËRGOJIMI

Një grua që nuk sorollatet përjashta është e mbrojtur nga sëmundja e përgojimit. Ajo

jeton e lumtur në shtëpinë e saj, e lidh zemrën së pari me Allahun e më pas me bashkëshortin dhe fëmijët e saj, e ruan mendjen nga gjëra të zbrazëta dhe për këtë është e qetë, e lumtur, e paqtë. Prandaj është në një shkallë të lartë morali e si rrjedhojë është një element i respektuar dhe i nderuar i familjes së saj.

Ata që bien pre e sëmundjes së përgojimit nuk mund të jenë kurrë të lumtur. Si mund të jetë falënderues një person që është i zënë me të ardhurat dhe të metat e të tjerëve?!

## EKUILIBRI NË TË USHQYER

Çështja e ushqimit nuk ishte diçka parësore siç është bërë sot. Atëherë njerëzit ushqeheshin me çfarë kishin dhe ishin falënderues ndaj Allahut. Edhe sikur të hanin bukë të thatë ishin të lumtur dhe nuk linin pas dore asnjëherë duanë e falënderimit. Edhe pse babai ynë ishte shumë i pasur, kalonin shumë ditë dhe nuk hanin mish, por asnjëherë nuk mërzhiteshim për këtë.

Askush nuk hante duke e tejmbushur stomakun. Njerëzit nuk ishin aq të dhënë pas konsumimit të mishit. Sëmundjet e stomakut, të zemrës apo sëmundjet shpirtërore ishin tepër të rralla. Çdo lagje kishte vetëm një doktor i cili ishte i mjaftueshëm për të gjithë. Po ashtu edhe sëmundjet reumatizma-

\_\_\_\_\_ Një krahasim midis së shkuarës dhe të tashmes

le ishin tepër të rralla për shkak se të gjithë praktikonin namazin, hanin pak, bënëin ecje duke vënë në lëvizje muskujt e trupit.

## VESHJA

I kushtohej rëndësi veshjes së pastër, të rregullt dhe të bukur përkundër prirjeve të sotme për të pasur veshje të çuditshme, të çrregullta deri në kapërdisje.

Robot ishin të pastra, pa njolla e të hekurosura. Zakonisht visheshin derisa të vjetëroheshin. Këpucët ishin të lyera dhe të rregullta. Edhe ato përdoreshin derisa të vjetëroheshin.

Çdokush vishej sipas shijes së vet, por askush nuk mburrej me çfarë vishej e çfarë ushqehej.

Njerëzit krenoheshin kur përdornin prodhime vendase. Rrallë ishin ata që përdornin mallra të huaja. Njerëz të tillë nuk shiheshin me sy të mirë, madje qortoheshin.

Allahu i Lartësuar i krijoi njerëzit në forma të ndryshme, disa të shkurtër, disa të gjatë, disa të shëndoshë, disa të dobët, disa brunë, disa ngjyrëgështenjë e disa bjondë. Diçka që i shkon njerit mund mos t'i shkojë tjetrit, shijet janë pafund. Sa qesharake, pafundituri dhe kufizim është të braktisësh një det

të tërë shijesh në emër të ndjekjes së diçkaje të çuditshme të quajtur “modë”.

## LËNGU I TRËNDAFILIT

Zonjat fisnike të asaj kohe përdornin lëngun e trëndafilut në vend të esencave, kremrave dhe pomadave të llojlojshme që dëmtojnë dhe irritojnë ndjeshëm lëkurën, ndonëse janë të paketuara me një ambalazh luksoz dhe mashtrues. Edhe gratë e moshuara shtatëdhjetë apo tetëdhjetë vjeçare kishin një fytyrë dhe lëkurë tejet të freskët. Lëngu i trëndafilut ushqen fytyrën, e mban atë të butë, nuk e irriton dhe parandalon gjithashtu edhe rrudhat.

## TË ARDHURAT FAMILJARE

Zonja e shtëpisë ishte shumë e bindur ndaj bashkëshortit të saj. Ajo nuk kundërshtonte, përkundrazi mundohej ta ndihmonte bashkëshortin në çdo çështje. Nuk këmbëngulte për gjëra që ai nuk mund t'i merrte dot. Për këtë arsye në familje mbizotëronte lumturia dhe qetësia duke iu shmangur edhe problemeve financiare në të ardhura. Veshjet dhe orenditë shtëpiake përdorshin me shumë kujdes, edhe pse të vjetëruara askush nuk synonte t'i rinovonte pa arsye.

Përdorej përherë parimi: “Femra është ajo që e kthen shtëpinë e saj në xhenet.” Nënati edukonin fëmijët e tyre me parimin e mos shpërdorimit dhe kursimit. Kështu fëmijët mbanin gjithnjë diçka të kursyer në xhepat e tyre, kësisoj jo vetëm që nuk kishin nevojë të merrnin hua, por me paratë e tyre ndihmonin të varfërit dhe i mëshironin ata.

Njerëzit kishin frikë nga haku i robit dhe nga borxhi. Borxhliu pranonte të mbeste i uritur vetëm për ta paguar borxhin në kohë. Kësisoj çdokush mund të merrte hua sepse njerëzit ishin brumosur me një moral të tillë, njerëzit ishin të drejtë, të palëkundur.

Gruaja, si zonjë shtëpie ishte përgjegjëse për edukimin e fëmijëve dhe menazhimin e shtëpisë, ndërsa burri ishte i zënë me punët e jashtme dhe siguronte çdo nevojë të familjes.

## EDUKIMI SHPIRTËROR

Një fëmijë i brumosur me edukimin shpirtëror, larg çdo sjelljeje të pahijshme, kthehej në një shtyllë të rëndësishme të shoqërisë duke u bërë i dashur për të gjithë.

Prijësit fetarë dhe mësuesit e Kuranit gëzonin një respekt të thellë. Nderimi që i bëhej atyre ishte shumë më i madh në raport me njerëzit e tjerë.

## DITËT SHPIRTËRORE

Nuk kishte sjellje të pamatura. Të gjithë ishin të lumtur, të gëzuar.

Në ditët e bajrameve dhe netëve të mëdha tregohej respekt dhe të gjithë vizitonin njëri-tjetrin; lexohej Kuran dhe këndohej Mevlud duke përhapur kështu në çdo shtëpi flladin e miskut hyjnor.

Është e vështirë t'i përshkruajmë ato ditë siç është e vështirë të përshkruajmë shijen e mjaltit. Me pak fjalë, ato ditë ishin përjetime që as nuk mund t'i imagjinojmë dot, ishin dimensione të tjera...



# NËNAT E NDERUARA



*Prindërit më të mëshirshëm  
janë ata që i përgatisin fëmijët e tyre  
për të ardhmen e vërtetë të Ahiretit  
duke i brumosur me edukatën kuranore.*





# NËNAT E NDERUARA

## NËNA, BURIMI I MIRËSISË

Hudhejfe ﷺ tregon:

Një ditë nëna më pyeti:

“Kur u takove për herë të fundit me të Dërguarin e Allahut?”

“Ka disa ditë që nuk jam takuar.”-u përgjigja.

Nëna u zemërua shumë me mua dhe më tërhoqi vërejtjen. Ndërsa unë i thashë: “Mos u zemëro nënë. Do shkoj menjëherë ta takoj të Dërguarin e Allahut, të falem bashkë me të në namazin e akshamit dhe më pas do i kërkoj të

lutet për ty dhe për mua.” (Tirmidhî, Menâkib, 30; Ahmed, V, 391-2)

Sa shembull kuptimplotë i edukimit dhe përkujdesjes së një nëne të nderuar ndaj djalit të saj!

Nënat besimtare që u brumosën me edukimin shpirtëror profetik u bënë edukatoret dhe heroinat e padukshme të Epokës së Lumturisë.

Ato i përcillnin bashkëshortët në mëngjes me lutje duke u thënë:

*“Ki kujdes! Mos sill në shtëpi diçka të fituar në rrugë të ndaluar. Sepse ne mund ta durojmë urinë në jetën e kësaj bote, por nuk mund ta durojmë dënimin në jetën e botës tjetër.”* (Abdülhamid Keşk, *Fi Rihâbi't-Tefsîr*, I, 26)

Edukimi i nënave fisnike është një domosdoshmëri për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë siç e kërkon Islami.

Kështu në ajetin kuranor thuhet:

**“... edhe ata (besimtarët) që thonë: “O**

*Një grua e devotshme është arkitektja e vërtetë e shoqërisë. Sepse ajo mban në shpirt përgjegjësinë e lartë të ruajtjes së brezit dhe miredukimit të fëmijëve.*

**Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë dhe na bëj shembull për të mirët!”** (Furkan, 74)

Qeliza e shoqërisë është familja. Familja ndërtohet përmes kurorëzimit në emër të Allahut. Në mungesë të kurorëzimit nuk mund të ketë as rend familjar dhe shoqëror, por vetëm krijesa që sorollaten si një tufë.

Krijuesi i Gjithësisë kërkon prej nesh të ndërtojme një shoqëri mbi bazën e devotshmërisë. E kush më shumë se nënat e devotshme dhe të përkushtuara ndaj fëmijëve të tyre mund të ndërtojnë një shoqëri të tillë paqeje dhe qetësie? Të parët tanë kanë thënë:

Këtë të vërtetë e kanë shprehur edhe me fjalët: “Folenë e ndërton zogu femër.”

## FEMRA E SHTYPUR NË KOHËN E INJORANCËS

Në kohën e hershme të injorancës fëmijët vajza ishin të padëshirueshme. Atyre u bëhej

*“Nëse edukoni një djalë keni edukuar një individ. Nëse edukoni një vajzë keni edukuar një familje, madje një pjesë të madhe të shoqërisë.”*



padrejtësi, e drejta për trashëgimi u mohojë, madje disa prej tyre varroseshin të gjalla.

Në shumë luftëra mes fisesh gruaja ishte objekt shfrytëzimi çnjerëzor. Nderi dhe dinjiteti i saj nëpërkëmbje përtej çdo lidhjeje të ligjshme kurorëzimi.

Sipas transmetimit të Katades arsyeja pse vajzat groposeshin të gjalla në periudhën e injorancës nga fiset arabe të asaj kohe ishte:

“nga frika e nëpërkëmbjes së nderit të tyre në rast robërimi nga fiset e tjera si dhe druajtja nga varfëria.”

Për t’iu shmangur kësaj gjendjeje, thuhet se i vrisnin fëmijët e tyre vajza që në moshë të vogël dhe në vend të tyre ushqenin qentë. (Taberî, *Tefsîr*, VIII, 68, [el-En’âm, 140])

Natyrisht të tregosh dhembshuri ndaj krijesave dhe t’i ushqesh ato është diçka e bukur. Por të zëvendësosh qentë me fëmijët dhe t’i ushqesh ata në vend të tyre në këndvështrimin familjar dhe shoqëror është padyshim një çështje shqetësuese.

*Si edukatorë të fëmijëve tanë duhet të pyesim veten shpesh:*

*“Çfarë u kemi dhënë fëmijëve që presim kaq shumë prej tyre?!”*



Ndërsa sot, në kohën e injorancës moderne femra shihet si një mall, si një objekt për shitje dhe argëtim duke abuzuar kështu me personalitetin e saj. Vlera e një gruaje nuk mund të matet nga gjinia e saj, por nga personaliteti që zotëron. Rezultati i kërkimit të vlerës në lëkurë, gjini apo në ekspozimin e trupit është një katastrofë e dhimbshme njerëzore. Kjo ngjan me shkeljen e një luleje të rrallë të mbirë në kalldrëme apo me flakjen e një diamanti në koshin e mbeturinave. Kjo gjendje s'është tjetër vetëm se turp i njerëzimit.

Islami nga ana tjetër e ka ngritur femrën në pozitën e një gruaje fisnike. Sepse kur gruaja është e tillë, ka dobi individi, familja dhe e gjithë shoqëria. Në të kundërt kur gruaja humbet dëlirësinë dhe dinjitetin e saj e tërë shoqëria pëson goditje.

Kurani i Lavdishëm shpesh vë në dukje rëndësinë e bamirësisë ndaj prindërve. Në shumë ajete fëmijët ftohen të jenë mirënjohës, bamirës dhe të bëjnë lutje për prindërit e tyre dhe në mënyrë të veçantë për nënat të cilat i sollën në jetë pas shumë mundimesh:

*Një mendimtar (i urtë) thotë:*

*Ata që duartrokasën femrat që zhvishen në emër të artit, përse vallë shkelin mbi të drejtat e atyre që mbulohen për hir të Zotit, përse i përbuzin ato femra që nuk pranojnë të shfaqen si rrjedhojë e devotshmërisë?!*



Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë:

“O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ti kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!” (Ahkaf, 15)

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“*Xheneti është nën këmbët e nënës.*” (Nesâi, Xhahâd, 6)

Thënë ndryshe, asnjë fëmijë nuk mund të pretendojë të hyjë në derën e xhenetit pa fituar kënaqësinë (zemrën) e nënës.

Një sahabi e pyeti të Resulullahun:

“O i Dërguar i Allahut! Kush e meriton më shumë përkujdesjen time?”

*Çdo fëmijë lind në natyrë të pastër  
ashtu siç edhe vetë toka e paprekur.  
Ajo duhet të lëvrohet siç lypset të përpunohet  
edhe një mineral i thjeshtë.*



Ai ﷺ u përgjigj:

*“Nëna, pastaj nëna, pastaj përsëri nëna, pastaj babai, pastaj më të afërmit tuaj.”* (Muslimi, Birr, 2)

I Dërguari i Allahut ishte shembulli më i bukur i shprehjes së mirënjohjes dhe respektit ndaj mëndeshës së tij. Se herë e shihte zonjën Halime e thërriste: “Nënë e dashur, nënë e dashur!” Ai tregonte dashuri dhe respekt, shtrinte në tokë veshjen (pelerinën) e tij për të dhe nxitonte të kryente çdo kërkesë dhe nevojë që ajo kishte. (Ibn-i Sa’d, I, 113, 114)

Janë të paharrueshëm personalitete të shumta islame që kanë ndjekur shembullin e të Dërguarit të Allahut në respektimin dhe nderimin e nënës.

Imam Ebu Hanifja e pati refuzuar propozimin e udhëheqësit të shtetit të asaj kohe Mansurit, për t’u bërë kadi (gjykatës) i Bagdatit, nga frika e keqpërdorimit të ixhtihadit për interesat e tij. Për rrjedhojë Ebu Hanifja u burgos. Por shqetësimi i tij i vetëm ishte frika se nëna e tij do mërzitej kur të mësonte këtë lajm.

*Formimi dhe edukimi i fëmijëve është i lidhur ngushtë me përkujdesjen dhe përkushtimin e prindërve ndaj tyre. Fara që mbillet në të ardhmen mund të dhurojë trëndafila dhe fruta të ëmbla, ashtu sikurse mund edhe të japë shkurre e fruta të hidhura.*



Abdurrahman Xhami respektin dhe mirënjohjen ndaj nënës së tij e shpreh me fjalët:

*“E si mos ta dua nënën. Ajo më barti për një kohë në trupin e saj, pastaj në krahët e saj, e për gjithë jetën në zemrën e saj.”*

Bahauddin Nakshibendi thotë:

*“Kush dëshiron të vizitojë varrin tim, fillimisht të ndalet në varrin e nënës sime...”* duke u përpjekur të bëhej kështu një sadaka rrjedhëse për nënën e tij.

Allahu i Lartësuar në Kuranin Famëlartë përmes tregimeve na ka paraqitur shembuj të nënave dhe baballarëve fisnikë e të familjeve të ndritura:

## NËNAT SHEMBULLORE PËR NJË FAMILJE SHEMBULLORE

Allahu i Lartësuar në Kuranin Famëlartë ka përmendur Hz. Merjemin si simbol të ndershmërisë dhe dëlirësisë dhe si model të zonjës fisnike.

*Fëmijët janë amaneti hyjnor  
dhuruar prindërve dhe mësuesve  
për t'i edukuar ata me dituri, mençuri  
dhe moral të bukur.*

Pas çdo personaliteti të ndritur qëndron një nënë e përkushtuar, kështu edhe nëna e Hz. Merjemit ishte një shembull i bukur i **sinqeritetit dhe devotshmërisë**.

Allahu i lartësuar përmes nënës së Hz. Merjemit, zonjës Hanne na ka ofruar një shembull konkret se si duhen edukuar fëmijët nga prindërit e tyre. Kështu në Kuranin Famëlartë një sure mban emrin, familja e Imranit (Al-i Imran) e cila përbën një shembull të përkushtimit ndaj edukimit të një brezi të shëndoshë dhe shembullor.

Nëna e Hz. Merjemit kur ishte ende shtat-zënë duke menduar se foshnja që mbante në bark ishte djalë, ia kushtoi atë Bejtul Makdis-it.

Në thelb kjo ishte një shfaqje e devotshmërisë sepse:

- Të duash për fëmijën si qenia më e shtrenjtë e nënës, që ai të rritet dhe të edukohet në formën më të bukur brenda një atmosfere besimi dhe adhurimi,
- Të dëshirosh që ai të bëhet një sadaka

*Fëmijët e privuar nga edukimi shpirtëror, larg frymës kuranore dhe profetike, Ditën e Gjykimit do të ankohen për prindërit e tyre.*



rrjedhëse për prindin dhe një pasardhës i denjë,

➤ Ta shkëputësh atë nga prehri për t'ia kushtuar Zotit në thelb është simbol i një besimi dhe devotshmërie të thellë.

Nëna e Hz. Merjemit nuk e theu betimin edhe pse fëmija që lindi ishte vajzë. Përmes një vendosmërie të thellë ajo u tregua besnike ndaj premtimit që i kishte dhënë Krijuesit Fuqiptotë duke iu lutur me fjalët:

**“Zoti im!.... E kam lënë atë me pasardhësit e saj nën mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar.”** (Al-i Imran, 36)

Allahu i Lartësuar e pranoi zotimin e saj si shprehje e një qëllimi të pastër dhe e rriti atë si një filiz të njomë.

Hz. Merjemi i shërbente vazhdimisht faktorës së shenjtë (xhamisë), ishte gjithnjë e zënë me adhurim, ruhej nga gjërat e ndaluara dhe e mbronte nderin e saj me dëlirësi.

Por edhe pse nuk e kishte prekur dorë nje-

*Hz. Mevlana thotë:*

*Ki kujdes ndaj hakut të nënës.  
Ajo është kurora e kokës tënde.  
Pa vuajtjet e nënës asnjë fëmijë  
nuk do vinte në jetë.*

riu ajo mbeti shtatzënë dhe lindi Hz. Isain, një ndër profetët më të rëndësishëm të historisë.

Allahu i Lartësuar e ka përmendur 34 herë emrin e saj në Kuranin Famëlartë. Shpeshherë kur është folur për Isain a.s. është përmendur në formën “Isai, biri i Merjemes” duke iu dhuruar kështu një nderim dhe respekt nënës së tij, Hz. Merjemit.

Hz. Merjemi gostitej me mirësi të shumta nga Krijuesi i Gjithësisë. Ndërkohë që ajo ishte zënë me adhurim Allahu i Lartësuar e gostiste me fruta (të xhenetit).

Po ashtu në momentet e vështira të lindjes së Hz. Isait, asaj iu dhuruan hurma të freskëta dhe pranë u çel një burim uji si mirësi nga Zoti i Gjithësisë.

Por pas lindjes së fëmijës pa baba si një mrekulli hyjnore, njerëzit e paditur e sulmuan me akuza të pabaza dhe shpifje. Ndërsa Krijuesi Fuqiptotë i dhuroi Isait a.s. mrekullinë e të folurit që në djep që ai të shpallte ndershmërinë dhe dëlirësinë e nënës së tij.

*Pavarësisht shumë viteve të tjera të hidhura nga jeta e Profetit a.s., emërtimi i vitit të vdekjes së Hz. Hatixhes si “viti i hidhërimit” është shprehja më e qartë e vlerës së një gruaje të devotshme.*



Allahu i Lartësuar duke dëshiruar që Hz. Merjemi të fitojë grada të larta në adhurim, shprehet:

**“O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!”** (Al-i Imran, 43)

Urtësia e këtij tregimi;

➤ Besimtarët që e jetojnë jetën me devotshmëri dhe ndershmëri janë nën mbrojtjen e Allahut dhe të lartësuar si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën.

➤ Prindërit e përkushtuar edukojnë një brez të dobishëm.

➤ Brezi i ri duhet të edukohet me parimin e shërbimit në rrugën e Zotit përmes frymës kuranore, dhe qetësisë shpirtërore të sexhdeve dhe mesxhideve.

Kurani Famëlartë na mëson se gratë e të Dërguarit të Allahut duhet t'i vlerësojmë si nënat tona. Secila prej tyre është nëna e umetit dhe shembull për ne. Në krye;

*Një çoban i urtë nuk e kullot tufën në vende të thata, por në vende të lagështa, me gjelbërim e bereqet. Në mënyrë të ngjashme, edhe një prind i përgjegjshëm, krahas rritjes me ushqim të lejuar duhet ta orientojë fëmijën e tij që në moshë të vogël drejt vendeve ku mund të brumoset me edukimin e duhur shpirtëror.*

## HZ. HATIXHJA

HZ. Hatixhja është bashkëshortja e parë e të Dërguarit të Allahut, nëna e të gjithë fëmijëve të tij me përjashtim të Ibrahimit, njeriu i parë që i besoi profecisë së tij dhe shembulli më i bukur i një gruaje fisnike.

Ajo ishte përkrahja më e madhe materiale dhe shpirtërore e të Dërguarit të Allahut që në ditët e tërheqjes së tij në shpellën Hira deri në kohërat më të vështira të bojkotit mekas.


Kështu kur i Dërguari i Allahut që kthyer i shqetësuar nga ajo që i kishte ndodhur në Hira duke pyetur:

*“-O Hatixhe, e kush do të më besojë mua?”*

Ajo i tha:

*“-Mos ki frikë! Allahu kurrë nuk do të të turpërojë! Sepse ti i ruan lidhjet farefisnore, thua të vërtetën, i ndihmon nevojtarët, u fal fukarenjve, i mirëpret mysafirët dhe i mbron ata të cilëve u është bërë padrejtësi.”*, duke e mbështetur kështu moralisht të Dërguarin e

*Bashkëshortet e sahabeve i qortonin fëmijët e tyre në rast se ata nuk takoheshin me Profetin ﷺ për një kohë të gjatë. Ato përpiqeshin t'i shoqëronin fëmijët e tyre me njerëz të mirë në mënyrë që të përfitonin sa më shumë prej tyre.*



Allahut. (Buhârî, Bed‘u’l-Vahj, 1; Muslim, Îmân, 252; Ibn-i Sa‘d, I, 195)

H. Hatixhja me besnikërinë dhe bujarinë e saj unike shpenzoi të gjithë pasurinë që zotëronte për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij në një kohë kur Islami përjetoj vitet më të vështira të bojkotit mekas, duke u bërë kështu një simbol i sakrificës dhe besimit të palëkundur.

Vdekja e saj ishte aq e rëndë (e dhimbshme) për të Dërguarin e Allahut sa që sahabët e nderuar e quajtën atë vit, “Viti i Dëshpërimit”. Profeti ynë i dashur kishte kalur sprovat e ndryshme: vdekja e fëmijëve një nga një, vrasja çnjerëzore e xhaxhait të tij H. Hamzait dhe sahabëve të tjerë të nderuar, e sa e sa vuajtje të tjera, por asnjë nga këto ngjarje nuk u quajt me atë emër... Emërtimi i vitit të vdekjes së H. Hatixhes, si: “Viti i Dëshpërimit” është një tregues domethënës i mbështetjes së thellë morale që ajo i dha të Dërguarit të Allahut.

Pejgamberi ﷺ nuk e harroi kurrë hijeshinë shpirtërore dhe delikatesën e saj. Sa herë priste

*Prindërit duhet të jenë një shembull i mirë për fëmijët e tyre. Çdo fjalë e artikuluar nga goja e tyre është si një gur i vendosur në murin e karakterit të fëmijës.*



ndonjë kurban, nuk harronte të dërgonte një pjesë edhe të afërmeve të saj dhe të interesohej për ta.

Ai e vlerësonte kështu Hz. Hatixhen:

“Gruaja më e mirë e kohërave të shkuara është Mejremi. Ndërsa gruaja më e mirë e këtyre kohërave është Hatixhja.” (Buhârî, Menâkibu’l-Ensâr, 20, Enbijâ, 45; Muslim, Fedâilu’s-Sahâbe, 69)

Bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut janë për ne një shembull të një nëne fisnike. Le të sjellim shembullin e një personaliteti tjetër madhështor:

## Hz. AISHJA

I Dërguari i Allahut duke u martuar me Hz. Aishen, vajzën e mikut të tij më të shtrenjtë Ebu Bekrin, i dha asaj formimin më të plotë në fushën e jurisprudencës duke e kthyer në një burim të rëndësishëm të diturisë aq sa ka thënë:

*Nëse duam të rrisim një fëmijë  
të përsosur, fillimisht ne si prindër  
duhet të jemi të përsosur.*



“Kërkojeni një të tretën e diturisë nga shtëpia e Aishes.” (Dejlemî, II, 165/2828)

Hz. Aishja përmes nipërve ka ndarë diturinë e saj në rreth 300 nxënës. Sipas Ibn-i Abbasit nuk ka dijetarë që të mos kenë përfituar nga dituria e Hz. Aishes.

Shkalla e lartë e bujarisë dhe devotshmërisë së Hz. Aishes shihet edhe në tregimin e mëposhtëm:

I Dërguari i Allahut u varros aty ku ndërroi jetë, në shtëpinë e Hz. Aishes. Po ashtu edhe Hz. Ebu Bekri pati nderin të varrosej pranë Resulullahut. Tashmë kishte mbetur vetëm një vend dhe Hz. Aishja e dëshironte atë për vetë. Mirëpo si rrjedhojë e dëshirës së madhe të Hz. Omerit për t’u varrosur pranë të Dërguarit të Allahut, ajo nuk e refuzoi kërkesën e tij. Hz. Aishja tregon:

“Kur hyja në dhomën time aty ku ishte varrosur i Dërguari i Allahut dhe babai im e hiqja mbulesën pa ndrojtje sepse e dija që aty ishte

*Nëna e Hz. Sulejmanit e këshillonte:*

*“Biri i nënës! Mos fli shumë natën.  
Sepse gjumi i tepërt e lë të varfër  
njeriun në Ditën e Gjykimit.”*

bashkëshorti im dhe babai im, por kur u varros Hz. Omeri betohem se turpëroheshja aq shumë sa kurrë nuk e hoqa mbulesën time. (Ahmed, VI, 202; Hâkim, III, 63/4402)

Secila prej nënave të besimtarëve (bashkëshortet e Pejgamberit) ishin burim virtytesh më vete. Hz. Zejnebi merrej me përpunimin e lekurës dhe me të ardhurat që siguronte u dhuronte nevojtarëve. Në ndodhinë e Hudejbijes i Dërguari i Allahut u konsultua me Hz. Ummu Selemen dhe mbeti shumë i kënaqur nga përgjigjja e saj e urtë.

Secila prej tyre, jetoi një jetë me devotshmëri dhe përkushtim ashtu siç dëshironte i Dërguari i Allahut. Asnjëherë nuk iu ankuan. Pasuria e tyre më e madhe ishte qetësia shpirtërore. Kënaqësia më e madhe ishte ngopja e të uriturve. Shqetësimi më i madh i tyre ishte si të udhëzonin dhe mësonin gratë e besimtarëve dhe si t'i ndihmonin vajzat e reja të përgatisnin pajën e martesës.

*I Dërguari i Allahut zgjonte vajzën e saj Hz. Fatimen dhe dhëndrin Hz. Aliun në namaz nate.*



## TË BËHESH NËNË E KREJT UMETIT

Bashkëshortet e Pejgamberit a.s. fituan emrin **أُمَّهَات** nënat e besimtarëve edhe pse ato nuk sollën në jetë fëmijë. Siç dihet vetëm Hz. Hatixhja dhe Hz. Marija lindën fëmijë. E megjithatë të gjitha u regjistruan në librin hyjnor si ummehat/ nënat e besimtarëve.

Le të sjellim një shembull:

Beshir bin Akrabe el-Xhuheni **رضي الله عنه** tregon:

“U takova me të Dërguarin e Allahut në ditën e luftës së Uhudit dhe e pyeta:

- Në ç’gjendje është babai im?
- *Babai yt ra dëshmor, Allahu e mëshiroftë!*
- u përgjigj ai.

Fillova të qaja. I Dërguari i Allahut më mori pranë vetes, më përkëdheli kokën dhe më tha:

- *A je i kënaqur nëse unë bëhem babai yt, ndërsa Aishja nëna jote?”* (Hejthemî, VIII, 161)

*Qasja me dhembshuri  
dhe mëshirë ndaj fëmijëve nuk nënkupton  
vetëm detyrimin për t’i ushqyer,  
veshur, rehatuar dhe argëtuar duke e kufizuar  
kuptimin e jetës vetëm në këndvështrimin  
e kësaj bote.*

Ndërsa unë u përgjigja:

“Të qofshin falë nëna dhe babai o i Dërguar i Allahut, patjetër që jam i kënaqur!”

Edhe pse tashmë jam thinjur, aty ku preku dora e bekuar e Resulullahut, flokët janë ende të zeza.” (Buhârî, et-Târîhu'l-Kebîr, II, 78; Ali el-Muttakî, XIII, 298/36862)

Bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut u bënë shembulli i mëshirës dhe dhembshurisë që buronte nga mëmësia. Ato u bënë edukatore të grave të umetit, harxhuan pasurinë e tyre për të blerë robëresha me qëllim që t'u dhuronin lirinë, i rritën dhe i martuan jetimet në përputhje me ajetin e mëposhtëm:

وَأَنْكِحُوا الْيَامَى مِنْكُمْ

“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju...” (Nur, 32)

Nisur nga kjo, të gjitha gratë e tjera të këtij umeti duhet të marrin shembull nga Nënat e Besimtarëve.

*Dhembshuria dhe mëshira e vërtetë është shpëtimi nga dënimi i jetës së përhershme, edukimi i personalitetit të tyre me vlerat shpirtërore, para së gjithash është ushqimi i shpirtit të tyre.*



Kështu që;

Çdo besimtare duhet t'i dhurojë umetit mëshirën dhe dhembshurinë e një nëne, pavarësisht nëse Zoti i ka dhuruar apo jo fëmijë. Kjo qasje duhet t'i përfshijë të gjithë dhe në mënyrë të veçantë fëmijët jetimë e të vetmuar duke u përpjekur që të jetë burim udhëzimi për secilin nga këto filiza që presin të formësohen.

Gjatë historisë shumë gra bamirëse kanë ngritur vakufe dhe kanë përmbushur më së miri detyrën e mëmësisë.

Transmetohet se Sulltan Abdu 'l-Hamiti nga 150 robëresha (shërbëtore) të sarajit ka ndihmuar në martesën e 149 prej tyre përveç njëres që ishte me aftësi të kufizuara.

Orientimi drejt shembullit plot mirësi që ofron i Dërguari i Allahut në ndërtimin e jetës familjare dhe mbrojtjen e saj, është një domosdoshmëri.

Dashuria dhe respekti që shohim tek bashkëshortet e Pejgamberit është e paarritshme.

*Ditën e Gjykimit do të japin llogari  
ata prindër që nuk u kanë mundësuar  
fëmijëve të tyre të shijojnë kuptimin e Kuranit  
ngase vetë nuk kanë dashur të përfitojnë  
(të freskohen) nga burimi i pashtershëm  
kuptimor i tij.*

Po ashtu edhe dashuria dhe mirësjellja e të Dërguarit të Allahut ndaj bashkëshorteve të tij është e pashembullt.

Asnjë vajzë nuk mund ta dojë babain e saj siç e deshi Hz. Fatimja Resulullahun.

Asnjë baba nuk mund ta dojë vajzën e tij siç e deshi Resulullahu Hz. Fatimen.

## NËNA E EHLI BEJTIT

Një tjetër shembull i shquar nga nënat fisnike të këtij umeti është edhe Hz. Fatimja.

Ajo është fëmija i vetëm i të Dërguarit të Allahut që ka jetuar gjatë gjithë jetës së tij, është nëna e Hz. Hasanit dhe Hz. Husejnit, është bashkëshortja e Hz. Aliut dhe padyshim burimi i mirësive të pafundme.

Kur femohuesit e Mekës ofenduan dhe sulmuan të Dërguarin e Allahut, ajo vrapoi drejt tij për ta ndihmuar dhe mbështetur pa u frikësuar aspak nga keqbërësit (nga mizora e tyre.). Nisur

*Lumturia në të dy botët  
arrihet vetëm duke i edukuar fëmijët  
tanë si amanet hyjnor me frymën  
kuranore.*



nga kjo dhembshuri që tregoi ndaj babait të saj u quajt “nëna e babait të saj” (ummu ebi).

Hz. Fatimja fizikisht ishte e dobët dhe e pafuqishme. Ndërsa punët e shtëpisë ishin shumë të lodhshme. Kur ndizte zjarrin për të gatuar ndodhte që shkëndijat e flakës t’i digjnin vende-vende fustanin. Mbulohej e tëra nga pluhuri sa herë pastronte shtëpinë me fshesë. Shpesh duart i gjakoseshin kur bluante miellin në mulli e shpina i zinte plagë nga bartja e ujit. Por pavarësisht vështirësive ajo nuk ka patur kurrë shërbyese. Bereqeti i familjes së tyre ishte devotshmëria, mbështetja dhe kënaqësia ndaj Allahut.

Në jetën e tyre modeste ka shembuj kup-timplotë të dhurimit në kushte të vështira.

Transmetohet se;

Hz. Fatimja bashkë me bashkëshortin e saj Hz. Aliun për tri ditë rresht i dhuruan ushqimin e tyre të vetëm, një të varfri, jetimi dhe një robi të cilët trokitën derën e tyre pikërisht në kohë yftari. Për rrjedhojë Allahu i Lartësuar zbriti këto ajete:

*Trashëgimia më e vyer që mund t'i lërë njeriu fëmijës së vet është karakteri dhe personaliteti Islam.*



**“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë:**

**Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.**

**Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.”**

(Insan, 8-11)

Le të sjellim shembullin e një tjetër zonje fisnike që ka lënë gjurmë në historinë islame:

Siç vepronte shpesh, një natë Hz. Omeri kishte dalë rrugëve të Medines. Kur po kalonte pranë një shtëpie dëgjoji dy persona duke biseduar me zë të lartë. Nëna po i thoshte vajzës:

“Bija ime, shto pak ujë në qumështin që do shesim nesër.”

Vajza u përgjigj:

“Nënë e dashur, halifja na e ka ndaluar ta përziejmë ujin me qumësht.”

*Ne si prindër nuk duhet të mjaftohemi vetëm me shkollimin e fëmijëve tanë në medrese apo kurse fetare, por duhet të ndjekim ecurinë e tyre me shumë kujdes.*



Këtë herë nëna i foli me ton qortues:

“E si do ta marrë vesh halifja që kemi shtuar ujë në qumësht në këtë kohë të natës?”

Përsëri vajza, zemra e së cilës ishte ndriçuar me devotshmëri, nuk pranoi urdhrin e gabuar të nënës së saj dhe tha:

“Nënë e dashur, edhe sikur të mos shohë halifja, sheh Allahu. Është e lehtë ta fshehim këtë hile nga njerëzit, por është e pamundur ta fshehim atë nga Krjuesi i Gjithësisë që sheh dhe di gjithçka...”

Hz. Omeri pasi e gjeti këtë vajzë, e martoi me të birin e tij, Asimin. Nipi i kësaj familjeje të begatë, Omer bin Abdulazizi, u bë halifja i pestë i myslimanëve.

Siç e shohim edhe në këtë shembull, nëna të tilla fisnike kanë qenë mbështetja më e madhe e personaliteteve të shquar të historisë. Edhe nëna e Abdulkadir Gejlanit ka qenë një prej tyre.

Tregohet se Abdulkadir Gejlani udhëtoi në

*Nëse sot nuk i brumosim  
fëmijët tanë me frymën kuranore,  
nuk duhet të harrojmë se nesër  
do të qëndrojmë në një varr të shkretë,  
të vetmuar e të penduar thellë.*

kërkim të dijës që në moshë shumë të vogël. Karvani ku ai udhëtonte një ditë u ndal nga plaçkitësit të cilët e pyetën:

“A mban ar me vete?”

Ai me shumë naivitete u përgjigj:

“Në këmishën e brendshme nëna më ka qepur një kuletë ku mbaj 40 monedha ari.”

I pari i plaçkitësve u befasua nga kjo përgjigje dhe e pyeti:

“Djalë, përse tregove që mban ar me vete? Sikur të mos flisje askush nuk do të të kontrollonte.”

Djaloshi tha:

“Kur u largova nga shtëpia i premtova nënës sime që nuk do të gënjej kurrë. E si mund ta prish premtimin tim për 40 monedha ar?”

Të mahnitur nga kjo fisnikëri dhe dinjitet që buronte nga zemra e djaloshit të vogël, plaçkitësit u penduan dhe hoqën dorë nga ai akt i shëmtuar duke u bërë njerëz të mirë.

*Ne duhet t'u përkushtohemi  
fëmijëve tanë, t'u injektojmë në zemrat  
e tyre të pastra dashurinë për Allahun dhe të  
Dërguarin e Tij dhe t'i edukojmë me kulturën  
kuranore dhe profetike.*



Ja pra, këto nëna u bënë shembujt më të bukur të umetit islam. Përgjatë gjithë historisë ata u bënë edukatore të nënave të reja si simbol i ndershmërisë, dëlirësisë, dhembshurisë, shërbimit, mëshirës dhe bujarisë.

Ka shumë prej tyre që sot nuk ua dimë as emrin. Kjo sepse ata e ruajtën të fshehur mirësinë e tyre larg syfaqësisë dhe e kushtëzuan vetëm në diturinë e Allahut të Lartësuar. Kjo gjendje nuk kishte të bënte me atë që shumë njerëz të paditur dhe të cektë e quajnë sot, si: “qëndrim në plan të dytë”. Por ishte një zgjedhje e vetëdijshme në përputhje me natyrën e pastër islame. Përndryshe, në ditët tona shohim se sa më shumë të vendosen në të ashtuquajturën “plan të parë”, gratë detyrohen të marrin përsipër edhe përgjegjësitë e burrave. Si rezultat, ato përballen me çrregullime të rënda psikologjike.

Sidoqoftë, këto zonja fisnike kanë lënë gjurmë në histori përmes bamireshive të tyre:

Bashkëshortja e Harun Reshidit, zonja Zu-

*Bazuar në vërtetësinë e fjalës:*

*“Për sa kohë arritjet e njerëzve vlerësohen dhe shpërblehen, merren rezultate të mira dhe ruhet suksesi” edhe ne duhet t’i motivojmë fëmijët tanë me dhurata dhe lëvdata që të nxisim zhvillimin e bukurisë së tyre shpirtërore.*

bejde ka harxhuar një pjesë të madhe të pasurisë për t'u siguruar haxhilerëve ujë të freskët. Akoma sot përmendet me emrin e saj kanali i ujit që ka çelur. Gjatë historisë i njëjti kanal është mirëmbajtur nga bashkëshortja e Kanuni Sulltan Sulejmanit, Sulltaneshë Mihrimah dhe më pas nga halla e Sulltan Abdulhamitit, Sulltaneshë Adile dhe të afërmit e saj.


Në historinë Osmane janë regjistruar 1400 vepra bamirësie. Ky numër tregon vetëm ato që kanë kaluar në regjistra. Por në mënyrë të veçantë vakufet e oborrtarëve të sarajit ishin shumë të mëdhenj dhe të jashtëzakonshëm.

## ATO NËNA...

**Sulltaneshë Nur Banu Valide** ka ndërtuar shumë vepra bamirësie si në pjesën aziatike ashtu edhe në pjesën evropiane të Stambollit. Pjesë e këtyre veprave janë edhe xhamia Atik Valide në Yskydar, mensa për të varfërit (imaret'hane), medreseja, qendra shëndetësore

*Imam Maliku thotë:*

*"Babai më bënte një dhuratë  
sa herë mësoja një hadith përmendsh.  
Erdhi një kohë që unë ndjeja kënaqësi  
sa herë mësoja hadithe të reja edhe nëse  
babai nuk më bënte më dhurata."*



(darush-shifa, ose spitale), hamame për meshkuj dhe për femra.

**Sulltaneshah Mahpejker Kosem Valide** ka hedhur themelet e Xhamisë së Re, ka ndërtuar Xhaminë Xhinili në Yskydar dhe pranë saj edhe një mekteb, çeźme, daru'l-hadith (shkollë për mësimin e haditheve) dhe një sebil (struktura prej guri, e bërë posaçërisht ngjitur me xhamitë, ku shpërndahej uji i pijshëm për bamirësi) si dhe një xhami tjetër në Anadolu Kavagi.

Vakufi që ajo ngriti enkas për t'i mbrojtur dhe martuar vajzat jetime është një simbol i vyer i mëshirës. Tërheq vëmendjen fakti që edhe Sulltaneshah Kosem e njohur në histori për madhësitë dhe autoritetin e saj tregonte mëshirë dhe dhembshuri në mënyrë të natyrshe.

**Sulltaneshah Hatixhe Turhan** përfundoi ndërtimin e Xhamisë së Re, themelet e së cilës ishin hedhur më parë. Po ashtu, pranë saj ndërtoi vepra të tjera bamirësie, si: mejtep, medrese, mensë, bibliotekë dhe çeźme.

*Në fjalën e urtë, thuhet:  
"Nuk ka të dashur si nëna  
Nuk ka vend si Bagdadi."*

Tërheq vëmendjen po ashtu edhe mbi-shkrimi në vakfijen e Xhamisë së Re ku thuhet:

“Gjatë netëve të Ramazanit dhe Netëve të Mëdha në disa çezme do të rrjedhë sherbet i përgatitur nga mjalti më cilësor i kohës me të cilën do të gostitet xhemati i xhamive.”

**Sulltaneshja Pertevnijal Valide** ka ndërtuar në Aksaraj të Stambollit Xhaminë Valide dhe Mexhidin Ja Vedud dhe më pas një bibliotekë, çezme dhe mejtep.

**Sulltaneshja Mihrimah** ka ndërtuar po ashtu nga një xhami të llojit “selatin”<sup>2</sup> në Edirnekapi dhe në Yskydar.

Sipas traditës Osmane ndërtimi i xhamive me dy minare ishte karakteristikë e sulltanëve. Sot komplekset historike të xhamive me dy minare mbeten një kujtim prej tyre.

Një ndër sulltaneshat më bujare dhe barmirëse është **Sulltaneshja Bezmialem Valide** e

---

2. Xhamitë Selatin, janë xhami të ndërtuara nga sulltanët dhe sulltaneshat. (shën. i përkthyesit.)

*Në fjalën e urtë thuhet:*

*“Nëse dikush qan, ajo është nëna ime.*

*Pjesa tjetër, gënjen.”*



cila ka ndërtuar plot vepra bamirëse që kanë shërbyer për shekuj me radhë dhe janë bërë pjesë tashmë e historisë. Xhamia më e madhe që ka ndërtuar është Xhamia Valide përballë Sarajeve të Dollmabahçes. Edhe Ura e famshme e Gallatës është vakuf i saj (vepër bamirësie).

Është domethënës vakfija e një prej vakfeve që ajo ngriti në Sham. Aty thuhet:

“Të ardhurat e këtij vakufi do vihen në shërbim të dëmshpërblimit të sendeve të thyera apo të dëmtuara nga shërbëtorët me qëllim që të mos nëpërkëmbet dinjiteti dhe personaliteti i tyre.”

Një nga veprat më madhështore bamirëse të Sulltaneshës Valide është Spitali “Gurabâ-i Muslimîn” të cilin e ndërtoi duke dhuruar të gjithë pasurinë e saj. Kjo vepër e mrekullueshme që nga viti 1843 i ka shërbyer sidomos shtresës së varfër të shoqërisë. Edhe sot e kësaj dite vazhdon të jetë nën shërbimin e komunitetit nën emrin Spitali Bezmialem Valide Sulltan.

Në vulën e saj shkruheshin disa fjalë që

*“...mos u thuaj atyre (prindërve)  
as “uh!”, mos i kundërshto, por drejtoju atyre  
me fjalë respekti.”*

(Isra, 23)



dëshmojnë horizontin e gjerë shpirtëror që kishte brumosur tek ajo dashurinë për bamirësi dhe mëshirë:

Prej dashurisë lindi Muhamedi  
Pa Muhamed ç'dashuri mund të lindë  
Bezmalem është fryt i kësaj dashurie.

Të njohur për bamirësinë e tyre, **Kamil Pasha** dhe bashkëshortja e tij **Zonja Zejnep** ndër-tuan spitalin “Zejnep Kamil” i cili sot është ende në shërbim të shoqërisë duke u bërë kështu për vite me radhë një sadaka rrjedhëse për to.

Mbaj mend të kem dëgjuar një histori nga babai im i ndjerë (rahmet pastë) Musa Efendiu në lidhje me këtë familje të njohur me bujarinë e tyre të madhe:

Dera e shtëpisë së kësaj familjeje qëndronte e hapur gjatë gjithë Ramazanit. Një ditë Sulltan Abdulazizi erdhi për yftar në konakun e Kamil Pashës dhe zonjës së tij Zejnep. Pas gostitjes i erdhi rradha e “diş kirasi”. “Dis kirasi” ishte emri elegant i dhuratës që i jepej mysafirëve pas gostitjes në sofër.

*“O Profet, thuaju grave  
dhe vajzave të tua, si dhe grave  
të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre  
(të kokës) përreth trupit.”*

(Ahzab, 59)



Kryeveziri Jusuf Kamil Pasha vendosi tapinë e atij konaku madhështor si dhe disa dokumente të tjera në një tabaka argjendi dhe ia shtroi Sulltan Abdulazizit në shenjë dhurate si “diç kirasi”.

Sulltani e mori:

“U ndjeva i gëzuar dhe i vlerësuar! Tani edhe unë po jua dhuroj ju.” - tha dhe ua ktheu dhuratën.

Ndërsa Zonja Zejnep në shenjë dhurate vendosi në tabakanë e argjendë një Mushaf me kaligrafi të Shejh Hamdullah të shkruar dhe të zbukuruar me bojë ari, të cilën padishahu e pranoi pasi e puthi tri herë dhe e vendosi në ballë në shenjë respekti.

Me pak fjalë, ato nëna fisnike zotëruan pasuri përrallore, thesare dhe xhevahire të mahnitshme. Por ata nuk ranë pre e egos së tyre, përkundrazi dhuruan gjithçka për umetin.

Sot nuk i shohim pasuritë e tyre të ekspozuara nëpër muze. Por e ndjejmë shkëlqimin e kupolave të Stambollit dhe qyteteve të tjera.

*Dashuria ndaj Ehli Bejtit është besnikëri ndaj të Dërguarit të Allahut. Në një hadith thuhet:*

*“Edukoni fëmijët me tre parime: Dashuria ndaj Profetit, dashuria ndaj Ehli Bejtit dhe leximi i Kuranit...” (Munâvî, I, 226)*

Shpërblimi i bamirësisë së tyre do vazhdojë të ruhet në fletoren e veprave të mira deri në Ditën e Kijametit. Kjo është pasuria e vërtetë, ky është thesari më i çmuar...

## SEKRETI I FITOREVE


Nënat fisnike ishin fuqia e padukshme që fshihej pas fitoreve dhe sukseseve. Ato janë heroinat e padukshme të fitoreve të të parëve tanë, që rritën dhe edukuan trima të vërtetë, i mëkuan ata me qumështin më të dëlirë, dhe i rritën me ninullat e lutjet për fitore të mëdha.

Kur në betejën e Uhudit Hz. Sumejra mori lajmin e martirizimit të dy djemve, babait, bashkëshortit dhe vëllait e saj, fillimisht ajo pyeti me një shqetësim të madh:

“A i ndodhi gjë të Dërguarit të Allahut?”, por pasi pa që Ai ﷺ ishte gjallë tha:

“Të qofshin falë nëna dhe babai o i Dërguar i Allahut! Nuk më shqetëson asgjë tani që të pashë (shëndosh e mirë)!”

*I Dërguari i Allahut familjen e tij të nderuar (Ehli Bejt) e la amanet umetit; ne na ngarkoi me detyrën që ta duam,| ta respektojmë dhe të marrim shembull nga Ehli Bejti deri në Ditën e Gjykimit.*



Po ashtu në luftën e Kadisijes, Hz. Hansa humbi katër djemtë e saj dhe kur e mori vesh lajmin e hidhur e falënderoi Allahun me një ndjenjë të lartë besimi duke thënë:

**“Qofshin falë katër djemtë e mi për një fitore të Islamit. Falënderimet i qofshin Allahut që në Ditën e Gjykimit do më ringjallë si nënë e katër dëshmorëve.”**

Ninullat e shumta me të cilat nënat fisnike të Anadollit qëndisnin shpirtin e fëmijëve janë simbol i dëshirës së zjarrtë për t'i lënë pasardhësve të tyre si trashëgimi një moral dhe personalitet të vyer islam:

Të vë të flesh me ninullë

Të rris me emrin e Allahut

Të mësoj të ecësh me Fjalën e Tevhidit  
(shehadetit)

Fli e rritu vogëlush

Që të ecësh hap e hap vogëlush.

.....

*Familja më e lumtur në botë  
është çerdhja e të Dërguarit të Allahut  
dhe Ehli Bejtit. Kriterin më të lartë të një prijësi  
të vërtetë të familjes dhe një babai shembullor  
e shohim tek i Dërguari i Allahut.*

Uji vjen nga kopshtet  
Dhikri dëgjohej nga teqet  
Foshnja ime në djep është shtrirë  
Tani do t'i vijë gjumë.

(Âmil ÇELEBIOĞLU, Ninnilerimiz)

Ishin ato nëna që i dërgonin bijtë e tyre në luftë sikur t'i dërgonin në dasmë. Ishin po ato nëna që i dërgonin bijtë e tyre kundër armikut pasi bashkëshortët nuk ktheheshin më.

Ato nëna u bënë heroinat e suksesit të Çanakalasë. Ardhmëria e një kombi arrihet vetëm përmes edukimit të një brezi me zemër të ndjeshme të mbushur me ndjenjën e lartë të sakrificës. Një brez që hodhi në vargjet e ninullave epopenë e Çanakalasë do dijë të mbrojë natyrshëm fenë, gjuhën, historinë, flamurin, atdheun e kombin, me pak fjalë të gjitha vlerat materiale dhe shpirtërore.

Kjo është vlera dhe dinjiteti që i është dhënë një nëne fisnike në fenë tonë dhe në historinë tonë të lavdishme.

*H. Hatixhja. H. Fatimja, H. Aishja dhe nënat e tjera fisnike janë modeli më i çmuar i mëmësisë. Në këtë kontekst fëmijët e tyre që u brumosën përmes parimeve më të larta të mëmësisë, H. Hasani dhe H. Husejni morën hise nga bota shpirtërore e të Dërguarit të Allahut.*



## PLASARITJE XHAMI

Fatkeqësisht në ditët tona mëmësia dhe detyrat e gruas në familje nuk vlerësohen sa duhet. Në kundërshtim dhe ndryshe nga natyra e tyre e krijimit, femrat po kthehen në objekte komerciale dhe po përfshihen në çdo fushë njësoj me burrat. Këto thirrje egoiste, për fat të keq kanë gjetur përgjigje në shumë njerëz që lëngojnë nga dëshira për t'u dukur.

Në të kaluarën vajzat edukoheshin që herët për të qenë të afta të kryejnë detyrën si nënë dhe si amvisë dhe përgatisnin pajën e tyre duke mos e hequr dore kanavacën dhe dantellën. Fëmijët edukoheshin t'u shërbenin në mënyrë të veçantë të moshuarve dhe mysafirëve.

Ndërsa tani me keqardhje shohim që edhe vajzat e mbuluara shpenzojnë kohën duke qëndruar nëpër kafene.

Në ditët tona, dërgimi i fëmijëve në kopshte, i prindërve në azile, endja deri në hutim pas një edukimi dhe karriere në ambiente të

*Bashkëshortet e Pejgamberit a.s. fituan emrin  
أُمَّهَاتُ nënat e besimtarëve. Edhe pse ato nuk  
sollën në jetë fëmijë u bënë edukatoret shpirtërore  
të fëmijëve të të gjithë umetit.*

çoroditura, darkimi në ambiente të jashtme, apo porositja e ushqimit nga jashtë është kthyer në një stil jete në përmasa epidemike që po minon gjithnjë e më shumë familjen, bereqetin dhe dashurinë. Jemi përballë një brezi që nuk di as të gatujë.

Fatkeqësisht, rrymat feministe dhe të barazisë gjinore kanë depërtuar tashmë edhe në shoqërinë tonë. Që nga koha e Tanzimatit, relativisht ishim të mbrojtur materialisht dhe shpirtërisht në saje të strukturës së fortë familjare që zotëronim. Por tashmë këto rryma kanë depërtuar thellë në familjet tona. Numri i divorceve është shtuar. Dhuna në familje dhe në mënyrë të veçantë ndaj gruas është shtuar.

E vërteta është që këto nuk janë dëgjuar në historinë e të parëve tanë. Ishte e famshme shprehja “Nuk ngrihet dorë ndaj femrës - Femra është e paprekshme”, ajo mbahej me respekt dhe vlerësohej.

Shkaku më i madh i dhunës në familje është nënvlerësimi dhe dobësimi i edukimit shpirtëror.

*Çdo zonjë e këtij umeti duhet të përpiqet të jetë një nënë e vërtetë përmes mëshirës dhe dhembshurisë së natyrshme pavarësisht nëse Zoti i ka dhuruar apo jo fëmijë. Ajo duhet t'i qaset me një ndjenjë përgjegjësie çdo fëmije dhe në mënyrë të veçantë fëmijëve jetim, të vetmuar dhe të braktisur.*



Feja jonë përmes normave dhe moralit të bukur e ka garantuar paqen dhe qetësinë shpirtërore në familje.

Në Kuranin fisnik thuhet:

**“Jetoni e silluni mirë me to (gratë)!”** (Nisa, 19)

I Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Më i miri nga ju është ai i cili sillet më mirë me familjen e tij...”* (Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 50; Dârimî, Nikâh, 55)

*“Mos i rrihni gratë tuaja! Ata që i rrahin gratë e tyre nuk janë prej të mirëve.”* (Ebû Dâvûd, Nikâh, 42; Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 51)

*“O ju njerëz! Respektoni të drejtat e grave! Silluni me mirësi dhe dashuri ndaj tyre! Ju këshilloj t'i frikësoheni Allahut për hakun e tyre. Ju i keni marrë gratë tuaja si amanet nga Allahu dhe i keni bërë të lejuara nderin dhe dëlirësinë e tyre në emër të Allahut!”* (Muslim, Haxh, 147)

Për sa kohë gratë të garojnë me burrat në emër të feminizmit dhe barazisë gjinore, ato

A dëshirojmë të jemi  
nën krahët e mëshirës së Resulullahut  
Ditën e Gjykimit?

Atëherë le ta pyesim veten:  
Sa i ngjan jeta jonë familjare  
modelit profetik?





do të mbesin pre e sjelljeve të ashpra të shoqërisë.

Vlerësimi i çështjeve familjare në mënyrë të njëanshme është e gabuar. Në ditët e sotme dhuna në familje e burrave ndaj grave po merr përgjigje me të njëjtën monedhë nga ana e grave. Kjo është njësoj si të mundohesh të fikësh zjarrin me flakë. Një plan i fshehtë dhe djallëzor po mundohet të shkatërrojë familjen.

Qasjet e sotme ndaj gruas nuk mund të quhen aspak përpjekje për ta vlerësuar atë. Personalitete të shumta të grave fisnike që i kemi përmendur në temat e mëparshme kanë lënë gjurmë në histori përmes vlerave të tyre shembullore.

Por përpjekjet e sotme për ta njësuar gruan me burrin në kundërshtim me natyrën e saj të krijimit, nxitja e tyre për të vrapuar në të njëjtin drejtim me ta, s'është gjë tjetër vetëm se zhvlerësim i figurës së gruas, përpjekje për ta shkatërruar familjen dhe për t'i lënë fëmijët pa përkujdesje.

*Nënat fisnike mund të lartësojnë një shoqëri të tërë. Gratë e shkujdesuara mund ta çojnë drejt shkatërrimit një shoqëri të tërë. Për shkak të tyre shoqëria pëson plasaritje deri në çorientim të brezave.*



Vlera e gruas nuk shfaqet duke u ekspozuar por duke u mbuluar. Gruaja fisnike është e çmuar brenda intimitetit të familjes. Mbulesa është nderi dhe dinjteti i femrës myslimane. Qëndrimi i saj larg të huajve është mbrojtje për të.

## ISLAMI DHE NATYRA E PASTËR E KRIJIMIT

I Dërguari i Allahut thotë:

*“Gratë janë gjysma plotësuese e burrave.”*  
(Ebû Dâvûd, Tahâret, 94; Tirmidhî, Tahâret, 82)

Tek Krijuesi Fuqiplotë burrat dhe gratë nuk zotërojnë asnjë epërsi ndaj njëri-tjetrit përveç se në shkallën e besimit, adhurimit, apo në çështjen e llogaridhënies. Epërsia qëndron vetëm në nivelin e devotshmërisë.

Mes burrave dhe grave ekzistojnë dallime të natyrshme, por që në të njëjtën kohë plotësojnë njëri-tjetrin. Në këtë pikë Islami bën një ndarje të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve në përshtatshmëri me këto dallime.

*Bahauddin Nakshibendi  
duke dashur të ishte një sadaka rrjedhëse  
për nënën e tij thoshte:*

*“Kush dëshiron të vizitojë varrin tim,  
fillimisht të ndalet në varrin e nënës time...”*

Islami kundërshton me forcë çdo tendencë krahasimi dhe barazimi mes burrit dhe gruas. Sepse kjo fe është kundër tjetërsimit të natyrës së pastër të krijimit.

Madje në Epokën e Lumturisë me shfaqjen e disave që dukej sikur po lakmonin njëri-tjetrin për karakteristikat e ndryshme që mbartnin, Allahu i Lartësuar zbriti ajetin kuranor:

**“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët:**

**- meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar**

**- e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar.**

**Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.”**  
(Nisa, 32)

Sipas transmetimit të Muxhahidit ky ajet u zbrit pasi Ummu Seleme tha:

**“O i Dërguar i Allahut! Burrat dalin në**

*Abdurrahman Xhami thotë:*

*“E si mos ta dua nënën.*

*Ajo më barti për një kohë në trupin e saj,  
pastaj në krahët e saj, e për gjithë jetën  
në zemrën e saj.”*



frontin e luftës, ndërsa ne jo, ne na jepet vetëm gjysma e trashëgimisë së burrave. Ah sikur të ishim edhe ne si ata. (Vâhidî, *Esbâbu'n Nuzûl*, Bejrut 1985, s. 104; Ibnu'l-Xhevzî, *Zâdu'l-Mesîr fi Ilmi't-Tefsîr*, Bejrut 1384/1964, II, 69)

Sipas një transmetimi të Ikrimesë, gratë kërkuan të marrin pjesë në luftë duke thënë:

“Dëshirojmë që Allahu ta bëjë edhe për ne farz (detyrim) luftën në mënyrë që edhe ne të fitojmë shpërblimin e burrave.” Për rrjedhojë Allahu i Lartësuar zbriti ajetin kuranor:

“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët.” (Vâhidî, *Esbâbu'n Nuzûl*, Bejrut 1985, s. 105)

Me pak fjalë mund të themi që:

Allahu i Lartësuar kërkon prej nesh që burri dhe gruaja të ruajnë tiparet e natyrshmërisë së krijimit dhe të shërbejnë secili në fushën e vet në përputhje me këtë natyrshmëri.

*Imam Ebu Hanifja*

*e refuzoi propozimin e udhëheqësit*

*të shtetit të asaj kohe Mansurit, për t'u bërë kadi*

*(gjykatës) i Bagdatit, për rrjedhojë u burgos.*

*Ai tha: “Nuk mërzitem nga burgu, por nga frika e trishtimit të nënës sime.”*

## NJË PLAGË QË LËNGON: TRASHËGIMIA

Shpesh shtrohet pyetja: “Përse Kurani i ka dhënë gruas gjysmën e të drejtës së trashëgimi-së në raport me burrin?” Kur thellohemi rreth urtësisë së kësaj dispozite themi se:

Islami nuk i ka ngarkuar gruas barrën e sigurimit të të ardhurave për jetesë, as për veten e saj e as për anëtarët e familjes. Kjo detyrë i përket gjithmonë burrave. Kur është fëmijë, femra fillimisht është nën përkujdesjen e babait, nëse mbetet jetime është nën përkujdesjen e vëllait, xhaxhait, apo gjyshit. Kur martohet është nën përkujdesjen e bashkëshortit, nëse mbetet e ve është nën përkujdesjen e fëmijëve apo nipërve.

Kjo dispozitë vlen për të siguruar një ambient të qetë dhe të paqte familjar në mënyrë që gruaja të përmbushë detyrën e saj themelore, atë të edukimit të fëmijëve. Për më tepër, gratë si në të kaluarën ashtu edhe sot, kanë dhënë

*Burimi i dashurisë është Allahu i Lartësuar, një prej emrave të të Cilit është edhe Vedud (i Dashur). Burri dhe gruaja duhet të përpiqen ta gjallërojnë dashurinë midis tyre, të bëhen të dashur për njëri-tjetrin, të gjejnë mënyrën e duhur për t'u afruar me njëri-tjetrin.*



kontributin e tyre vullnetar në mirëqenien e familjes duke punuar si brenda ashtu edhe jashtë ambientit familjar.

Këto detyra janë më të përshtatshme për gratë, nisur nga natyra e krijimit më të brishtë dhe të butë në raport me burrat.

Në thelb puna e gruas është më e rëndë se ajo e burrit. A mund të ketë detyrë më të vështirë sesa edukimi i fëmijëve? Me cilin profesion mund të krahasohet misioni i edukimit të një nëne që rri zgjuar natë e ditë në shërbim të edukimit të fëmijës?

Ndërsa burri ka përgjegjësi si për familjen dhe të afërmit e tij, ashtu edhe për atdheun, kombin e fenë. Natyra më e fortë dhe e qëndrueshme e burrit në raport me gruan është në përputhje me detyrimet e tij. Për rrjedhojë, hisja shtesë që i jepet burrit në mënyrë të tërthortë është në shërbim të përmbushjes së nevojave të jetesës për bashkëshorten, vajzat, madje edhe nënën dhe motrat e tij.

Përkundër kësaj, gruaja nuk ka asnjë de-

*Gruaja dhe burri duhet të jenë të drejtë dhe besnikë ndaj njëri-tjetrit. Veçanërisht në kohë të vështira duhet të jenë mbështetje për njëri-tjetrin dhe jo burim ankesash e lodhjeje.*



tyrim të harxhojë pasurinë e saj për askënd, me përjashtim të rasteve kur ajo dëshiron të shprehë bujarinë e saj.

Në shumë kultura djali është ai i cili siguron të ardhurat e familjes, ndërsa vajza shkon nuse në një familje tjetër.

Nisur nga kjo, shumë kultura e kanë përjashtuar vajzën nga e drejta e trashëgimisë, veprim të cilin Islami e ka konsideruar padrejtësi dhe e ka refuzuar duke i dhënë si gruas ashtu edhe burrit të drejtat përkatëse.

Kështu Islami e ka lartësuar femrën duke i dhënë pjesën që meriton dhe duke e mbajtur atë larg çdo terreni akuzash për marrje të një trashëgimie të pamerituar.

**Nëse bëjmë një përmbledhje, mund të themi se:**

Në ligjin e trashëgimisë islame është vendosur ekuilibri i duhur midis detyrimeve dhe hiseve. Parimisht burri i cili ka shpenzime më të mëdha përfiton pjesë më shumë se gruaja. Sepse burri përveç detyrimit të mehrit dhe

*Mes burrit dhe gruas duhet të mbizotërojë  
sinqeriteti dhe jo arroganca.*

*Serioziteti dhe jo mendjemadhësia.*

*Modestia dhe jo përbuzja.*



shpenzimeve të dasmës, është përgjegjës edhe për sigurimin e të ardhurave për familjen.

Pra, dallimi midis burrit dhe gruas në çështjen e hiseve të trashëgimisë është i lidhur me dallimin e detyrimeve të ndryshme të njëjës palë dhe tjetrës. Midis tyre është vendosur një ekuilibër i drejtë. Gruaja nuk konsiderohet përgjegjëse për sigurimin e të ardhurave familjare për shkak të detyrës së saj të vështirë të edukimit të brezit dhe sigurimit të mbarëvajtjes së punëve familjare. Për këtë arsye e drejta e saj për trashëgimi është përgjysmuar. Kjo pjesë e trashëgimisë është dhënë duke marrë parasysh rastin e grave që nuk kanë mundësi të martohen, që shkurorezohen, apo për të përmbushur disa nevoja të tyre personale.

Ata që kundërshtojnë ligjin kuranor të ndarjes së trashëgimisë me pretendimin se nuk është koherent nuk duhet të harrojnë këtë ajet në vazhdë të legjislacionit të trashëgimisë:

**“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë**

*Besimtari mos ta urrejë  
bashkëshorten e tij. Nëse nuk i pëlqen  
një sjellje, i pëlqen një tjetër.*

*(Muslim, Rada, 61)*





**përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.”**

(Nisa, 14)

Grave u janë dhuruar virtyte të tilla, si: delikatesa, dhembshuria, mëshira, turpi, sakrifica, ndjesia e përkujdesjes ndaj fëmijëve dhe ruajtjes së brezit. Përgjithësisht ato nuk janë të fuqishme fizikisht, por zotërojnë një botë ndjesore shumë të thellë dhe ndjenja e mëshirës është shumë e lartë. Për rrjedhojë ato bien në dobësi fizike dhe shpirtërore në rast përballjeje me shumë të papritura të jetës. Kjo është arsyeja pse dëshmia e gruas në Islam ka vlerë të përgjysmuar.

## DËSHMIA dhe GRUAJA

Rregulli dhe ekuilibri i përsosur që ka vendosur Islami bazuar në natyrshmërinë e krijimit të njeriut anashkalohet si rezultat i armiqësisë apo injorancës së atyre që e sulmojnë Islamin duke keqinterpretuar çështjen e dëshmisë së femrës.

E vërteta është se:

*Sot, lufta më e shenjtë e grave është mbrojtja e familjes brenda kornizave që ka urdhëruar Allahu dhe përpjekja për të edukuar një brez të brumosur me besim.*



Allahu i Lartësuar krijoi çdo qenie për një qëllim të caktuar dhe i dhuroi atyre aftësitë fizike (biologjike) dhe shpirtërore (psikologjike) për të qenë të aftë të përmbushin këtë qëllim. Krijuesi Fuqiplotë e krijoi mashkullin më të fortë fizikisht dhe më të qëndrueshëm shpirtërisht që të jetë i aftë të përmbushë ashtu siç duhet detyrën e tij për t'i bërë ballë jetës dhe për të siguruar jetesën e familjes.

Ndërsa gruaja mbart misionin e vyer të rritjes dhe edukimit të brezit të ri, duke e mbështetur dhe mbrojtur atë në kohët më delikate dhe të vështira. Për këtë arsye fuqia shpirtërore e saj është mbizotëruese ndaj asaj fizike, gjë që bën të mundur rritjen e fëmijës me mëshirë dhe dashuri atëherë kur ai është më i dobët dhe në fazat më të vështira të jetës.

Nëse gruaja ngarkohet me një detyrë tjetër përveç asaj që është në përputhje me natyrshmërinë e saj të krijimit kjo do të ishte humbje. Si rrjedhojë e mëshirës së saj, mundësia e devijimit nga drejtësia të një gruaje ndaj një fajtori është shumë e lartë. Kjo është një nga

*“Xheneti është nën këmbët e nënës.”*

*(Ahmed, 3, 429)*

*Ky nderim nuk i është bërë baballarëve, por i është dhuruar nënave. Këto nëna fisnike që mbajnë në këmbë familjen e tyre, meritojnë një mirënjohje të përjetshme.*

urtësitë hyjnore sepse dëshmia e gruas vlen sa gjysma e burrit.

Nga ana tjetër, Islami përcakton shkallën e dëshmisë në përputhje me strukturën psikologjike të njeriut. **Në raste të caktuara dëshmia e burrit nuk merret për bazë, ashtu sikurse në raste të caktuara dëshmia e gruas pranohet në mënyrë të plotë.** Për shembull, dëshmia e gruas konsiderohet e mjaftueshme aty ku prezenca e burrit është e pamundur.

Ata që pretendojnë se gruaja është e mangët duke marrë shkas nga dëshmia e përgjysmuar e saj nuk e kuptojnë apo nuk duan ta kuptojnë se Islami është larg këtyre akuzave përmes vendosjes së një ekuilibri të drejtë midis të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me natyrshmërinë e krijimit pa harruar asnjë qelizë të shoqërisë.

## NATYRA E KRIJIMIT E GRUAS DHE E BURRIT

Natyra e brishtë, e mëshirshme dhe e ndje-

*“Kush i ngjason një populli,  
është prej tyre.” (Ebu Davud, Libas, 4/4031)*

*“Kush e pëlqen një popull,  
Allahu e ringjall atë njeri në mesin  
e atij populli.”*



shme e gruas është më e përshtatshme në shërbim të edukimit të brezit.

Nëna mund ta kalojë natën zgjuar për fëmijën e saj, por babai nuk mund ta përballojë këtë për një kohë të gjatë.


Fuqia fizike e meshkujve, aftësia e tyre për të gjykuar dhe arsyetuar me gjakftohtësi janë tipare të përshtatshme për të përmbushur detyrat e tyre të mbrojtjes së familjes dhe atdheut.

Prishja e natyrës së pastër të krijimit është bërë shkas i shfaqjes së grave të cilat nuk duan ta pranojnë mëmësinë.

Ndërsa nga ana tjetër janë shfaqur meshkuj që nuk janë orvatur të pranojnë detyrimet e tyre familjare.

Në fakt, nëse mendojmë më thellë shohim se kjo përpjekje për të barazuar meshkujt me femrat është në dëm të palës më të brishtë. I Dërguari i Allahut e ka krahasuar femrën me një kristal dhe ka bërë me dije se përkujdesja ndaj saj duhet të jetë e ndryshme nga ajo e meshkujve:

*Sado që perëndimi të mundohet të përsërisë mashtrimin se Islami e nëpërkëmb femrën, nënat besimtare që i brumosin fëmijët e tyre me dashurinë për fenë, besimin, atdheun, flamurin, që i dërgojnë fëmijët e tyre në frontin e luftës thua se po i përgatisin për dasmë, janë padyshim përgjigjja më e merituar për to.*



Në kohën kur udhëtimet bëheshin me deve, ato nxiteshin të ecnin me ritmin e shkretëtirës.

Në një udhëtim të tillë, një shërbëtor me emrin Enxheshe i nxiti devetë të ecnin më shpejt duke recituar ode (kaside). Por ky nxitim ishte i papërshtatshëm për gratë që gjendeshin brenda dhomëzave mbi deve.

I Dërguari i Allahut tha:

*“O Enxheshe! Ki kujdes, mos të thyhen xhamat!”* (Buhârî, Edeb, 95; Ahmed, III, 117)

Pra kuptimi i kësaj ishte lëvizja e karvanit me shpejtësi të përshtatshme për gratë. E vërteta është se ata që ndjekin teorinë e barazisë gjinore e detyrojnë gruan t’u përshtatet kushteve të burrit duke e shtrënguar atë të punojë në orare dhe kushte të njëjta. Kjo sjell zhdukjen me ngadalësi të delikatesës së femrës deri në ashpërsimin dhe tjetërsimin e natyrës së saj femërore.

*“Xheneti është nën këmbët e nënës.”*

(Ahmed, 3, 429)

*Ky nderim nuk i është bërë baballarëve, por i është dhuruar nënave. Këto nëna fisnike që mbajnë në këmbë familjen e tyre, meritojnë një mirënjohje të përjetshme.*



## FATKEQËSIA MË E HIDHUR E DITËVE TONA

Në epokën tonë ka nisur tashmë një garë artificiale dhe e padrejtë a barazisë midis burrave dhe grave. Kjo garë që bie në kundërshtim me tiparet e natyrshme të krijimit të gruas, ka sjellë me vete dobësimin e rolit të gruas në familje dhe misionit të saj të mëmësisë duke rezultuar në dëmtimin e jetës familjare. Për këtë arsye rastet gjithnjë e në rritje të aborteve në ditët e sotme, nuk janë gjë tjetër vetëm se një formë e modernizuar e groposjes gjallë të vajzave të periudhës së inyorancës, pra një formë vrasjeje e këtij shekulli.

Dallimi midis femrës së sflitur dhe të lodhur të këtij shekulli me femrën e periudhës së inyorancës është tashmë vetëm një çështje gardarobe, thënë ndryshe ato i ndan vetëm mënyra e të veshurit. Kjo s'është gjë tjetër veçse fundi i një shoqërie të ndërtuar mbi parimet e një edukimi të pashpirt materialist.

*Islami kërkon që si burri ashtu edhe gruaja të jetojnë në përputhje me karakterin dhe natyrën e tyre. Kështu, i Dërguari i Allahut ka mallkuar çdo mashkull që i ngjason femrave dhe çdo femër që i ngjason meshkujve.*

## TË DREJTAT E VËRTETA TË GRUAS

Islami ka hedhur hapat më të drejtë dhe më të qytetëruar në rrugën e mbrojtjes së të drejtave të gruas.

I Dërguari i Allahut e ka refuzuar konceptin e injorancës ku burri është superior ndaj gruas.

Një ditë kur Pejgamberi ﷺ ishte në shtëpinë e vajzës së tij, Hz. Fatmës, nipërit Hz. Hasani dhe Hz. Husejni i kërkuan të pinin ujë. I Dërguari i Allahut fillimisht i dha Hz. Hasanit.

Hz. Fatma mendoi se i Dërguari i Allahut donte më shumë Hz. Hasanin. Ndërsa Pejgamberi ﷺ tha:

*“Jo, por Hz. Hasani kërkoi i pari (ujë).”* (shih: Ahmed, I, 101)

Pastaj tha:

*“Trajtoni në mënyrë të barabartë fëmijët tuaj kur i shpërbleni. Nëse do të mbaja dikënd më*

*“Kush i ngjason një populli, është prej tyre.”*

*(Ebu Davud, Libas, 4/4031)*

*“Kush e pëlqen një popull, Allahu e ringjall atë njeri në mesin e atij populli.”*

*(Hejthemi, X, 281)*



*lart, do të mbaja vajzat.*” (Hejthemi, IV, 153; Ibn-i Haxher, el-Metâlibu'l-Âlije, IV, 69)

Në shumë hadithe vihet re një nxitje e veçantë për t'i edukuar vajzat në formën më të bukur.

*“Kush ka tri vajza dhe është i butë ndaj tyre, i furnizon ato, i edukon ato dhe i marton ato, do t'i bëhet atij obligim hyrja në Xhenet.”* (Ebû Dâvûd, Edeb, 120-121/5147; Tirmizî, Birr, 13/1912)

*“Kush kujdeset dhe edukon dy vajza derisa ato të rriten, në Ditën e Gjykimit do të jemi unë dhe ai kështu dhe bashkoi gishtat e tij (pra së bashku).”* (Muslim, Birr, 149)

I Dërguari i Allahut vlerën e gruas së devotshme e ka shprehur përmes këtyre haditheve:

*“Më e mira e asaj që është në pronësi të njeriut është gjuha që nuk ndalet së adhuruari, zemra që nuk pushon së falënderuari dhe gruaja e mirë që e ndihmon bashkëshortin e saj të mbajë gjallë imanin.”* (Tirmîdhî, Tefsîr, 9/9)

*“Kjo botë (jetë) është një përfitim i përkohshëm. Krijesa më e çmuar që sjell përfitim në këtë*

*I Dërguari i Allahut ka thënë:*

*“Më janë bërë të dashura (nga Allahu) tri gjëra:*

*Namazi, drita e syve të mi,*

*Misku (era e mirë),*

*Gruaja e devotshme.”*

*(Nesâî, Ishretu'n-Nisâ, 10)*





*botë është gruaja e devotshme.”* (Muslim, Radâ, 64; Nesâi, Nikâh, 15; Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 5)

*“Më janë bërë të dashura (nga Allahu) tri gjëra:*

*Namazi, drita e syve të mi,*

*Misku (era e mirë),*

*Gruaja e devotshme.”* (Nesâi, Ishretu'n-Nisâ, 10)

Zgjidhja e vetme, është kthimi nga rruga e sheriatit (fesë) dhe natyrshmëria e krijimit. Është mbrojtja e familjes sipas kriterëve kur'anore dhe profetike. Është respektimi i plotë i parimeve të mbulesës dhe kufirit midis hallallit dhe haramit. Është ndërtimi i familjes me mirësi, mëshirë dhe dhembshuri.

**Allahu i begatofte fëmijët tanë, djemtë dhe vajzat tona! Qofshin dritë e syrit dhe kënaqësi e shpirtit. I shndërroftë brezat e rinj në vatër devotshmërie!**

**Amin!**

*“Kjo botë (jetë)  
është një përfitim i përkohshëm.  
Përfitimi më i çmuar në këtë botë  
është gruaja e devotshme.”*

*(Muslim, Radâ, 64)*





# EDUKIMI I PAQES NË FAMILJE



(ata thonë:) “O Zoti ynë,  
na dhuro nga gratë tona  
dhe trashëgimtarët tanë, ç’është  
prehje për sytë tanë dhe na bëj shembull  
për të mirët!” (Furkan, 74)





## EDUKIMI I PAQES NË FAMILJE

### E DREJTA E FËMIJËVE

Kalifi Omer bin Abulazazi jetonte një jetë shumë të thjeshtë dhe modeste edhe pse ishte udhëheqësi i shtetit islam që kishte shtrirë kufijtë e tij në përmasa kolosale.

Një ditë veziri i propozoi:

“Zotëri, shuma që merrni nga “thesari i shtetit (bejtu’l-mal)” duket se nuk ju mjafton. Sikur të merrni pak më shumë në mënyrë që të kurseni diçka dhe pas vdekjes suaj t’u mbetej fëmijëve dhe nipërve tuaj për nevojat e tyre të domosdoshme?!”

Kalifi dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“Nëse pasardhësit e mi do jenë nga të mirët (salih), nuk druhem aspak për të ardhmen e tyre, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Në të vërtetë, Mbrojtësi im është Allahu, i Cili ka zbritur Librin dhe kujdeset për të mirët.” (Araf, 196)

Nuk shqetësohem aspak për sa kohë Allahu i Lartësuar është mbrojtësi dhe kujdestari i tyre në çfarëdo situatë me të cilën mund të përballen në të ardhmen.

Në të kundërt, nëse ata do jenë nga shpërdoruesit (sefih) atëherë Allahu i Lartësuar thotë për ta në Kuran:

“Mos e lini në dorë të të paaftëve mendërisht pasurinë tuaj.” (Nisa, 5)

E si mund t'i lë trashëgimi diçka fëmijëve të mi pas kësaj ndalesë hyjnore?” (Ebu'l-Ûlâ Mardin, *Huzur Dersleri*, Istanbul 1966, II-III, 769-770)

Transmetohet se Lukmani i urtë ka thënë:

*Shpirti i një gruaje fisnike  
është një vatër mëshire që strehon  
jo vetëm të voglin e saj por të gjithë fëmijët e  
pafuqishëm dhe nevojtarë të botës. Pas mirësisë së  
besimit kjo është mirësia më madhe që mund të  
zotërojë një besimtar.*

“Nuk është pasuri ajo që e mbledh në dorë, e lë trashëgimi për tjetër kënd, pastaj jep llogari vetë për të.”

I Dërguari i Allahut trashëgiminë më të mirë e përshkruan me fjalët:

*“Asnjë baba nuk i ka lënë trashëgimi më të mirë fëmijës së tij sesa një moral të bukur.”*

(Tirmidhî, Birr, 33/1952)

Pra;

Pasuria më e çmuar që mund t’u lihet pasardhësve është pajisja e tyre me moralin dhe karakterin e bukur islam. Është përpjekja për t’u lënë atyre trashëgiminë e Ahiretit. Nëse edhe ata do jenë të aftë t’u lënë të njëjtën trashëgimi brezit pasardhës, kjo do të jetë një sadaka rrjedhëse duke u bërë kështu pasuria më e madhe shpirtërore.

Në ditët e sotme nuk është e mjaftueshme të jesh thjesht një nënë apo baba biologjik. Është për të ardhur keq që fëmijët tanë po edukohen nga interneti, televizioni, moda apo reklamat. Mentaliteti dhe bota shpirtërore e brezit të ri

*Një grua fisnike nuk kursen asnjë sakrificë  
për familjen e saj në kohë të vështira.*

*Ajo përpiqet të lehtësojë barrën  
e bashkëshortit të saj. Po ashtu ajo është e kënaqur  
me gjithçka që ai sjell në shtëpi,  
falënderon dhe nuk ankohet.*



sa vjen e po tjetërsohet. Me pak fjalë, shejtani po bëhet partner i fëmijëve tanë.

Për këtë arsye, sot është e domosdoshme të përpiqemi shumë që t'u lëmë trashëgimi fëmijëve tanë një personalitet dhe karakter islam.

As'hab Kehfi (Shokët e Shpellës) e këshillonin njëri-tjetrin në mënyrë që të ruanin besimin e tyre me fjalët:

**“Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t'ju gjuajnë me gurë ose do t'ju kthejnë (me forcë) në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kurrsesi.”** (Kehf, 20)

Sot një prind që i kushton vëmendje dhe kujdes fesë dhe besimit të fëmijës së tij duhet të mendojë e të pyesë veten:

**“A mund ta ruajë besimin fëmija im nëse shoqërohet me njerëz të prishur e të shkujdesur apo nëse krijon marrëdhënie intelektuale në një hapësirë me njerëz që e mohojnë Zotin?”**

Ne duhet t'u tregojmë fëmijëve tanë se jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit. Duhet t'i bindim ata

*“Asnjë baba  
nuk i ka lënë trashëgimi më të mirë  
fëmijës së tij sesa një moral të bukur.”*

*(Tirmidhî, Birr, 33/1952)*



se diploma e vërtetë është arritja e kënaqësisë së Allahut. Duhet t'u mësojmë atyre se nuk kemi ardhur në këtë botë për të bërë karrierë, por për të fituar ahiretin duke e njohur Krijuesin Fuqiplotë e duke jetuar me devotshmëri.

## SHQETËSIMI PËR BREZIN

Shqetësimi për brezat tek të gjithë pejgamberët ka qenë i njëjtë:

Hz. Ibrahim i lutej me fjalët:

**“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin!”** (Ibrahim, 40)

Edukimi i Hz. Ismailit nga Hz. Ibrahim përbën një shembull të bukur se si duhet të edukojë një baba fëmijën e tij.

Babë e bir ndërtuan së bashku Qaben e Madhnueshme. U lutën së bashku. Pastruan xhaminë së bashku. Kur u urdhërua të bëhej kurban, Hz. Ismaili iu dorëzua plotësisht urdhrorit të Krijuesit Fuqiplotë.

*Transmetohet se Lukmani i urtë ka thënë:*

*“Nuk është pasuri  
ajo që e mbledh në dorë,  
e lë trashëgimi për tjetër kënd,  
pastaj jep llogari vetë për të.”*



Shqetësimi për brezin ishte tek të gjithë pejgamberët.

Hz. Zekerija iu lut Allahut të Lartësuar t'i dhuronte një pasardhës të mirë nga frika se mos familja e Jakubit do të shkatërrohej. Kështu lindi Hz. Jahja. Ai u bë shembulli ideal i një të riu islam.

Po ashtu çdo qenie e gjallë bart me vete shqetësimin për brezin e ri. Këtë të vërtetë poeti Nexhip Fazëll e shpreh me fjalët:

“Pema që nuk nxjerr sythe, s’është gjë tjetër vetëm se një dru.”

Besimtari duhet të përpiqet t’u lërë trashëgimi brezave të rinj formimin me një personalitet dhe karakter islam. Përqendrimi i shqetësimeve të prindërve vetëm për jetën e kësaj bote, e kufizon misionin prindëror. Për të zbrapsur këtë mendësi Kurani shprehet:

“**Ta dini se pasuria dhe fëmijët tuaj janë sprovë.**” (Enfal, 28)

*“Mos i rrihni gratë tuaja!  
Ata që i rrahin gratë e tyre  
nuk janë prej të mirëve.”*

*(Ebû Dâvûd, Nikâh, 42; Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 51)*

## LUKMANI عليه السلام

Allahu i Lartësuar në lidhje me edukimin e fëmijëve dhe ndërtimin e familjes na ka ofruar edhe shembullin e Hz. Lukmanit. Emri i këtij pejgamberi apo njeriu të urtë është përmendur në Kuranin Fisnik edhe si emri i një sureje në të cilën përfshihen këshillat e tij të vyera.

Le të lexojmë dhe të meditojmë rreth këshillave të tij:

**“Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë): “Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim.” (Lukman, 12)**

Nga tre misionet e pejgamberëve, i dyti është pastrimi shpirtëror, ndërsa i treti është mësimi i Kuranit dhe mësimi i urtësisë, diturisë së thellë fetare. Nga kjo kuptojmë që arritja e urtësisë është e lidhur ngushtë fillimisht me pastrimin shpirtëror. Për këtë arsye vetëm zemrat

*O njerëz!*

*Kini kujdes ndaj të drejtave të grave!  
Silluni më butësi dhe dashuri ndaj tyre!  
Ju këshilloj t'i frikësoheni Allahut  
për hakun e tyre...!”*

*(Muslim, Haxh, 147)*



e pastra mund të ndriçohen nga Libri (Kurani) dhe urtësia dhe ky nivel përbën shkallën më të lartë të virtyteve.

Urtësia përbën anën e padukshme të gjërave, ngjarjeve apo ndodhive.

Në kryevepra të tilla, si Methnevija i jepet shumë rëndësi urtësisë së mësimeve hyjnore.

Sipas transmetimeve, i biri dhe bashkëshortja e Hz. Lukmanit ishin idhujtarë. Hz. Lukmani si mirënjohje ndaj Krijuesit Fuqiptotë për urtësinë që i ishte dhuruar, nuk u lodh së këshilluari ata me një stil shumë të butë e të mëshirshëm.

Besimtari duhet të përpiqet t'u lërë trashëgimi brezave të rinj formimin me një personalitet dhe karakter islam.

Më në fund ata u dorëzuan përballë këtij stili mëshirues, e pranuan Islamin dhe u udhëzuan. (Ebû Hajjân, el-Bahru'l-Muhît, Lukmân, 13)

Këto këshilla fillojnë me fjalët:

**“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar:**

*Po ashtu çdo qenie e gjallë bart me vete  
shqetësimin për brezin e ri. Këtë të vërtetë poeti  
Nexhip Fazëll e shpreh me fjalët:*

*“Pema që nuk nxjerr sythe,  
s’është gjë tjetër vetëm se një dru.”*

**“O djali im!**

**- Mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)!**

**- Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe!” (Lukman,13)**

Nga këto ajete kuranore mund të nxjerrim këto mësimë:

• **Rëndësia e këshillimit**

Në ajetin fisnik thuhet:

**“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!” (Nahl, 125)**

Në këtë ajet janë përcaktuar tri mënyra këshillimi në varësi të bashkëbiseduesit:

1. Ata të cilët zotërojnë një shkallë të lartë perceptimi këshilloji me urtësi.

2. Njerëzit e thjeshtë këshilloji me porosi dhe fjalë të bukura.

3. Ndërsa me njerëzit që kundërshtojnë çdo gjë diskuto në formën më të bukur.

*Përqendrimi i shqetësimeve të prindërve vetëm për jetën e kësaj bote, e kufizon misionin prindëror.*

*Për të zbrapsur këtë mendësi Kurani shpreh:*

*“Ta dini se pasuria dhe fëmijët tuaj janë provë.”*

*(Enfal, 28)*



Është e nevojshme të mos heqim dorë nga predikimi dhe këshillimi. Udhëzimi natyrisht është në dorë të Allahut të Lartësuar. Çdo moment i kohës duhet vlerësuar si një mundësi e vyer e pranimit të duave, andaj duhet të lutemi pa marrë parasysh se nuk mund të dimë kohën kur duatë pranohen. Kurrë nuk duhet të humbin shpresën. Në ajetin kuranor thuhet:

**“Ti përsëri këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve.”** (Dharijat, 55)

#### • Stili i butë

Hz. Lukmani i drejtohej djalit të tij me fjalët “biri im i dashur”! Të folurit me ëmbëlsi është çelësi i zemrave, e fton atë të pranojë çdo gjë.

#### • Idhujtaria është gjynahi më i rëndë

Idhujtaria është një marrëzi dhe shkujdesje që e përhumbe njeriun deri në vendosjen e shenjës së barazisë midis Krjuesit Fuqplotë që i dhuroi krijesave çdo mirësi e dhunti me një njeri të thjeshtë të cilin Ai ﷻ e krijoi nga hiçi. Allahu i Lartësuar nuk do ta falë një njeri që

*“Trajtoni në mënyrë  
të barabartë fëmijët tuaj kur i shpërbleni.  
Nëse do të mbaja dikënd më lart,  
do të mbaja vajzat.”*

(Hejthemî, IV, 153; Ibn-i Haxher,  
el-Metâlibu'l-Âlije, IV, 69)



vdes me këtë mendësi dhe ai nuk do të përfitojë nga shefaati (ndërmjetësimi) i askujt.

Njeriu duhet të jetë i kujdesshëm edhe ndaj shirkut (idhujtarisë) së fshehur (të padukshme, shpirtërore). Syfaqësia dhe dëshirat egoiste të shndërruara në idhuj, janë shembuj të shirkut të padukshëm.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Gjëja për të cilën frikësohem më shumë për umetin tim është idhujtaria. Me këtë fjalë nuk kam për qëllim adhurimin e hënës, diellit apo idhujve. Ajo që më frikëson mua janë veprat që bëjnë për të tjerët e jo për Allahun dhe dëshirat e fshehura (për t’u dukur).”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 21)

Në ajetin kuranor thuhet:

**“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot?”** (Furkan, 43)

Për shembull;

Do të ishte e rrezikshme nëse një bamirës ndërton një xhami apo vepra të ngjashme dhe kërkon të vendosë emrin e tij kur ai është ende gjallë.

*Vajzat janë nderi, bereqeti,  
mëshira e familjes. Ato janë  
sulltaneshat e familjes së tyre,  
janë zonjat që e mbajnë në këmbë familjen  
duke i edukuar fëmijët dhe duke  
i orientuar ata në veprat e mira.*



Por;

Fëmijët mund ta vendosin këtë emër pas vdekjes së tij. Ky do ishte një shembull motivues për bamirësi si dhe shkak për dua dhe lutje për shpirtin e tij.

Po ashtu edhe përpjekja për të zbuluar dhe për t'u mburrur me një gjendje shpirtërore të lartë duke i atribouar vetes çdo meritë, përbën një shirk të kamufluar, të fshehtë.

Pas çlirimit të Mekës të gjitha fiset e Gadishullit Arabik filluan të pranonin islamit grupe-grupe. Për të mos i lënë shteg nefsit dhe egos në lidhje me këtë arritje dhe sukses historik, Allahu i Lartësuar zbriti ajetet e sures Nasr ku thuhet:

“Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.”

Nisur nga kjo;

*Fëmijët e paedukuar me vlerat e moralit të bukur islam fatkeqësisht janë “sejje xharije”... Që do të thotë burim i pashtershëm gjynahesh për prindërit edhe pas vdekjes së tyre!*



Bamirësinë, veprat e mira, edukimin e nxënësve apo arritje dhe suksese të tilla nuk duhet t'ia atribuojmë kurrë vetes, por duhet t'i vlerësojmë si një mirësi e Krijuesit Fuqiplotë.


Çështja më e rëndësishme e tasavufit është zbrapsja e unit dhe egos. Për edukimin e unit njerëzor janë vënë në praktikë metoda të shumta edukuese.

Nisur nga kjo e fundit mund të sjellim shembullin e:

Ibrahim Bin Et'hemit i cili refuzoi postin dhe ofiqet; Aziz Mhamud Hydajin i cili pas detyrës si kadi dilte të shiste mushkëri në pazar i veshur me kaftanin e tij. Junus Emresë iu desh të priste shumë para së të pranohej nga mësuesi i tij. Dijetarë të shquar si Halid Bagdadi u morën me pastrimin e tualeteve etj.

Shembuj të tillë janë tregues të metodave edukuese në shërbim të thyerjes së mendjemadhësisë dhe unit njerëzor.

*Nëna jonë, Hz. Aishja ishte një ndër 7 dijetarët më të njohur për fetvatë e tyre. Devotshmëria e saj ishte për t'u marrë shembull. Sipas një transmetimi ajo kishte 300 nxënës.*



## TË DREJTAT E PRINDËRVE

Allahu i Lartësuar përmes këshillave të Hz. Lukmanit të përmenduara në Kuranin fisnik na bën të ditur të drejtat e prindërve dhe detyrimet ndaj tyre:

**“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.”** (Lukman, 14)

Ajeti kuranor bën të ditur në mënyrë të qartë se me çfarë ndjenje dhembshurie dhe mirësie duhet t’u qasemi prindërve veçanërisht në moshën e pleqërisë:

**“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as**

*Në qytetërimin tonë nuk janë shënuar ditë të caktuara për të shprehur dashurinë dhe respektin ndaj nënave apo të moshuarve. Çdo ditë ka qenë dita e nënës, çdo ditë ajo është respektuar dhe nderuar.*

“uh!”, mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” (Isra, 23)

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton:

“Erdhi një burrë dhe e pyeti të Dërguarin e Allahut:

-Me kë duhet të sillem më mirë?

I Dërguari i Allahut tha:

“-Me nënën tënde!”

“-Po pastaj?”-pyeti burri.

“-Me nënën tënde!”- tha përsëri i Dërguari i Allahut.

“-Po pastaj?”-pyeti përsëri burri.


“-Me nënën tënde!”- tha përsëri i Dërguari i Allahut.

“-Po pastaj?”-pyeti burri.

“-Me babain tënd!”- tha i Dërguari i Allahut. (Buhârî, Edeb, 2; Muslim, Birr, 1)

Nënat fisnike meritojnë falënderime dhe lutje të përvjetshme.

*Në qytetërimin tonë nuk janë shënuar ditë të caktuara për të shprehur dashurinë dhe respektin ndaj baballarëve, apo të moshuarve, por ata nderoheshin dhe respektoheshin çdo ditë. Dashuria dhe respekti ndaj gruas nuk shprehej vetëm në përvjetore martese, por ajo përvjetohej çdo ditë.*



Sa keq!

Në ditët tona ku injoranca ka arritur kulmin, shumë prej tyre po largohen nga misioni i lartë i mëmësisë.

Në injorancën e kohëve të shkuara vajzat e vogla groposeshin të gjalla, ndërsa në injorancën e kohëve tona ato po mbyten nga xhelatet e abortit. Foshnjët po shuhën që në barkun e nënës. Fëmijët po lihen pas dore me justifikimin se prishin rehatinë e nënave. Këto janë shenja të zvenitjes së ndërgegjes dhe zhdukjes së mëshirës nga zemrat e tyre. Nëse vërejmë edhe një mace madje është e mëshirshme ndaj të vegjëlve të saj. Stili i sotëm i jetës materialiste dhe sekulare, i ka bërë njerëzit më të egjër dhe egoistë.

Në lidhje me aktin barbar të vrasjes, Allahu i Lartësuar i tërheq vërejtjen njeriut të periudhës së injorancës po aq edhe njeriut modern duke u shprehur:

**“Kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrarë; (atëherë çdokush**

*Shkaku më i madh i dhunës në familje është nënvlerësimi dhe dobësimi i edukimit shpirtëror. Feja jonë përmes normave dhe moralit të bukur e ka siguruar paqen dhe qetësinë shpirtërore në familje.*

do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur për këtë Ditë.)” (Tekvir, 8-9)

Nga ana tjetër, dërgimi i prindërve në azile kur ata arrijnë moshën e pleqërisë është pasqyrim i mungesës së mëshirës dhe ndërgjegjes së fëmijëve të tyre.

Është vërtet për të ardhur keq. Në të vërtetë një nënë apo baba që kanë nevojë për ndihmë dhe përkujdesje, në fakt janë pasuria më e çmuar për ahiretin e njeriut.

Nga ana tjetër një fëmijë i edukuar në formën më të bukur do të bëhet bastuni mbështetës i prindërve në moshën e tyre të pleqërisë dhe mbase edhe një sadaka rrjedhëse kur ata të ndahen nga kjo jetë.

Në vitet e para të Islamit disa anëtarë të së njëjtës familje e pranuan Islamin ndërsa të tjerët jo. Kësisoj, disa prindër filluan të abuzonin me të drejtën e prindërore kundër fëmijëve të tyre. Për shembull;

Kur Sad bin Ebi Vakkasi pranoi Islamin në moshën 17 vjeçare (sipas një trasmetimi tjetër

*Më i miri nga ju është  
ai i cili sillet më mirë me familjen e tij.*

*(Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 50;*

*Dârimî, Nikâh, 55)*



19 vjeçar) nëna e tij u zotua që nuk do t'i fliste dhe hiqte dorë nga të ushqyerit, por ai i tha që nuk do të kthehet nga kjo fe.

Nëna pasanike e Musab bin Umejrit e kërcënoi se do ta privonte nga trashëgimia e pasurisë në rast se nuk do kthehej nga Islami.

Babai i Ebu Xhendelit e lidhi atë (të birin) me zinxhirë që ta ndalonte nga emigrimi në Medine.

Ky ajet kuranor tregon mënyrën si duhet vepruar në raste të tilla:

**“Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë.”** (Lukman, 15)

- Nuk kundërshtohet Krijuesi për hir të krijesave.

Adhurimi i përket vetëm Allahut të Madhë-

*Enes bin Maliku r.a. thotë:*

*I Dërguari i Allahut më edukoi me dashuri. Pas vdekjes së tij e shihja në çdo ëndërr.*

ruar. Për këtë arsye nëse prindërit i detyrojnë fëmijët të bëjnë diçka në kundërshtim me vullnetin e Krijuesit Fuqiplotë atëherë bindja ndaj tyre është e ndaluar. Përtej kësaj bindja ndaj prindit është e detyrueshme.

Për shembull nëse nëna dhe babai urdhërojnë vajzën e tyre të heqë mbulesën (hixhabin) në këtë rast bindja ndaj tyre refuzohet. Fëmija nuk konsiderohet gjynahqar si rezultat i kësaj mosbindjeje. Përkundrazi, shpërblehet nga Allahu i Lartësuar për zbatimin e këtij urdhri hyjnor.

- Ecja nën gjurmët e atyre që i binden Allahut.

Në këtë urdhër hyjnor vëmendja përqendrohet tek karakteristika që ka zemra për t'u ndikuar nga bota e jashtme. Në këtë kontekst është domosdoshmëri shoqërimi me njerëz të mirë dhe largimi nga të këqinjët.

Një ajet dhe një hadith:

*“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra).”* (Teube, 119)

*Çdo antëtar i familjes është përgjegjës dhe ka detyrime ndaj njëri-tjetrit, bashkëshorti për bashkëshorten, prindërit për fëmijët dhe anasjelltas.*



*“Mos u ulni në të njëjtin vend me idhujtarët dhe mos u shoqëroni me to. Nuk është prej nesh ai që rri dhe shoqërohet me to.”* (Hâkim, Mustedrek, II, 141)

Gazaliu thotë:

*“Ndarja e dimensioneve të përbashkëta mendore, i hap rrugë dimensioneve të përbashkëta shpirtërore.”*

- Kthimi është tek Allahu.

Besimi në Ahiret (Jetën e Përtejme) është shumë i rëndësishëm. Në ajetin vijues shohim përsëri këshillat e Lukmanit a.s. drejtuar të birit, i cili i mëson atij si duhet medituat rreth Jetës së Përtejme:

*“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njih mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.”* (Lukman, 16)

- Vetëdija ndaj Ihsanit.

I Dërguari i Allahut “Ihsanin” e ka përku-fizuar me fjalët:

*I Dërguari i Allahut ka thënë:*

*“Të gjithë ju jeni çobanë dhe përgjegjës të tufës suaj. Burri është çoban i familjes së vet dhe përgjegjës i tufës së tij. Gruaja është çobaneshë e familjes së saj dhe përgjegjëse e tufës së saj.”*

*(Buhârî, Ahkâm, 1)*





*“Adhuroje Allahun me bindjen se Ai po të sheh. Sado që ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.”*  
(shih: Buhârî, Îmân, 37)

H.z. Lukmani është përpjekur ta brumosë të birin me bindjen se Allahu i Lartësuar është përherë pranë dhe vëzhgon në çdo moment dhe në çdo vend punët e tij.

- Meditimi është çelësi i imanit.

H.z. Lukmani e shtynte të birin të meditonte rreth qiejve dhe tokës.

Një meditim që nis nga vepra për të mbërritur tek Vepruesi, nga shkaku tek Shkaktari, nga arti tek Artisti...

Fatkeqësisht sot shkencat pozitiviste trajtohen me një metodë shumë larg këtij meditimi dhe urtësie. E vërteta është se diturinë e fal i Dituri (Allahu xh.sh.). Shkencat pozitiviste konsistojnë në përcaktimin e një tërësie rregullash të vendosura nga vetë Krijuesi Fuqiplotë.

Andaj ne duhet t’u mësojmë fëmijëve tanë shpërfaqjet e panumërta në univers të fuqisë dhe madhësisë së Allahut të Lartësuar.

*Poeti i shquar Nexhip Fazëll thotë:  
Lotoni, që niveli i ujit të lartësohet.  
Mbase anija që batis do shpëtohet.*

*Nënë sille sexhaden,  
dua bëj për ne që të pranohet!*



**“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve.”**

(Lukman, 17)

## EDUKIMI I NAMAZIT

Hz. Lukmani pasi e këshillon të birin për domosdoshmërinë e adhurimit të të vetmit Krijues, e porosit atë të vazhdojë me ibadet, me punë të mira e me thirrje në rrugë të drejtë:

- Ne duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me namaz.

Hz. Lukmani e urdhëroi fillimisht të birin të bëhet prej namazfalësve. Në ajetin kuranor thuhet:

**“Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë!”** (TaHa, 132)

I Dërguari i Allahut na porosit:

*“Mësoni fëmijët tuaj të falen që në moshën*

*“O djali im, kryeje namazin,  
urdhëroje të mirën, pengoje të keqen  
dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet!  
Me të vërtetë, ky është thelbi  
i patundur i të gjitha punëve.”*

(Lukman, 17)



*7 vjeçare. Nëse në moshën 10 vjeçare e anashkalojnë namazin atëherë ndëshkojini lehtësisht.”*  
(Tirmidhî, Salât, 299)

Fatkeqësisht shumë prindër sot e anashkalojnë edukimin e fëmijëve të tyre me rëndësinë e namazit dhe tregohen shumë dorëlëshuar me pretekstin se:

“Janë ende fëmijë, ta jetojnë fëmijërinë...”

Nuk duhet harruar se egoja nuk ngopet kurrë. Ajo nuk kënaqet. Përkundrazi krijon varësi. Dhe si përfundim nuk të lëshon më.

I Dërguari i Allahut i zgjonte për namaz nate të bijën Hz. Fatmën dhe dhëndrin e tij Hz. Aliun.

Fillimisht duhet t’u mësojmë fëmijëve tanë Kuranin Fisnik në mënyrë që t’i mësojmë ata me faljen e namazit.

Mësimi i Kuranit është një detyrë që duhet të përmbushet me kujdes që në moshë të re.

Sepse veshët dhe zemra e fëmijëve duhet të njihen me zërin dhe botën e Kuranit që në

*“Urdhëroje familjen tënde  
që të falë namazin  
dhe këmbëngul për këtë!”*

(TaHa, 132)



moshë të vogël. I Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Kush e mëson Kuranin në moshë të vogël ai ndriçohet me nurin e tij.”* (Ali el-Muttakî, Kenz, I, 532)

Hz. Lukmani pas këshillave të besimit dhe adhurimit vijon me këshillat morale.

Sepse besimtari në të folur, të ecur, të qëndruar, të shikuar, me pak fjalë në çdo veprim të tij duhet të përçojë mirësjellje dhe hijeshi:

**“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!”**  
(Lukman, 18)

**“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”** (Lukman, 19)

Shqetësimi më i madh i Hz. Lukmanit dhe i peygamberëve apo njerëzve të tjerë të devotshëm është ndarja nga fëmijët e tyre në botën tjetër.

#### Gazaliu thotë:

*“Shoqërimi me njerëz të prishur e të shkujdesur, me kalimin e kohës ndikon në përvetësimin e veseve të tyre si në planin mendor ashtu edhe në atë shpirtëror. Për njeriun kjo s’është gjë tjetër veçse një rrugëtim drejt greminës ku fundi është shkatërrim.”*

## NDARJA E DHIMBSHME

Sado i devotshëm dhe i përkushtuar të jetë një njeri në fenë e tij, kjo nuk i mjafton për të shpëtuar të afërmit që kanë vdekur duke e mohuar Zotin e Gjithësisë.

Kështu Allahu i Lartësuar na tregon she-mbullin e djalit të Nuhit a.s., babait të Ibrahimit a.s. dhe gruas së Lutit a.s.. Po ashtu edhe she-mbullin e xhaxhallarëve të Pejgamberit a.s. Ebu Talibin dhe Ebu Lehebin. Të gjithë këto persona nuk besuan dhe mohuan Zotin e Gjithësisë. Lidhja e tyre e afërt me pejgamberë nuk u bëri asnjë dobi.

Mes anëtarëve të një familjeje është e natyrshme të ketë një lidhje të ngushtë shpirtë-rore dhe asnjëri prej tyre nuk do dëshironte të ndahej nga tjetri. Por nuk duhet të harrojmë se ndarja më e dhimbshme do të ndodhë në Ditën e Kijametit.

Atë ditë, zemrat e mbushura me devot-shmëri do të përshëndeten me fjalët:

*“Mos u ulni në të njëjtin vend  
me idhujtarët dhe mos u shoqëroni  
me to. Nuk është prej nesh ai që rri  
dhe shoqërohet me to.”*

*(Hâkim, Mustedrek, II, 141)*



**“Paqe!” do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë.”** (Jasin, 58)

Ndërsa gjynahqarët sado të afërt të jenë me familjet e tyre do të qortohen me fjalët:

**“(Ndërsa keqbërësve Ai do t’u thotë): “Veçohuni sot ju, o kriminelë!”** (Jasin, 59)

Ata do të jenë udhëtarët e një udhëtimit të trishtë. Sa ndarje e dhimbshme do jetë ajo.

Me pak fjalë e vetmja mënyrë për të mos u ndarë në Ahiret nga familja, fëmijët dhe prindërit tanë është përpjekja e përbashkët për t’u bërë njerëz të mirë (të devotshëm). Thënë ndryshe përpjekja për të jetuar brenda kufijve të rrugës së drejtë.

Sekreti i ndërtimit të një shoqërie të paqtë dhe të një familjeje të lumtur si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën, është shprehur në vargjet e mëposhtme kuranore:

**“(edhe ata që thonë): “O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe na bëj shembull për të mirët!”.** (Furkan, 74)

### *E vetmja mënyrë*

*për të mos u ndarë në Ahiret nga familja, fëmijët dhe prindërit tanë është përpjekja e përbashkët për t’u bërë njerëz të mirë. Thënë ndryshe përpjekja për të jetuar brenda kufijve të rrugës së drejtë (sirati mustakim).*

Krijuesi Fuqiplotë dëshiron një shoqëri të ndërtuar mbi parimet e devotshmërisë. Një shoqëri e paqtë, buron nga familje të paqta. Ndërsa roli dhe detyra e gruas në ndërtimin e kësaj familjeje është vendimtare. Edukimi dhe formimi i nënave të reja me një karakter dhe personalitet të pastër islam është shumë i qenësishëm. Nënata e brumosura me këto virtyte, janë një shkollë më vete për fëmijët e tyre.

Nëse nëna është e përkushtuar, edhe fëmijët do jenë të devotshëm, sepse nënat janë ato që ndërtojnë brezin.


Sa më shumë t'i bindemi Allahut të Lartësuar dhe të veprojmë sipas udhëzimeve të Tij, aq më shumë do të ndiejmë ndihmën e Tij, aq më shumë do të përjetojmë urtësinë e ajetit:

**“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** (Fatiha, 5)

Muhamed Ikbali drejtohet gruas besimtare përmes një poezie:

“O vajzë besimtare që me mbulesën tënde je simboli më i bukur i nderit tonë! Nuri i fytyrës tënde është burimi ndriçues i imanit tonë.

*Mes anëtarëve të një familjeje është e natyrshme të ketë një lidhje të ngushtë shpirtërore dhe asnjëri prej tyre nuk do dëshironte të ndahej nga tjetri. Por nuk duhet të harrojmë se ndarja më e dhimbshme do të ndodhë në Ditën e Kijametit.*



Dëlirësia në krijimin tënd është mëshirë nga Krijuesi ynë, fuqi e fesë sonë, është baza e ekzistencës së këtij umeti.

Pasi i mëkon me gji, ti je e para që u mëson fëmijëve tanë Fjalën e Njesisë (shehadetit). Dashuria që ti dhuron i jep kahje gjendjes sonë, mendimit, fjalës, punëve tona.

O ti grua fisnike që t'u besuan mirësitë e kësaj feje. Zjarri i fesë së vërtetë ka marrë flakë nga fryma yte.

Ky shekull është hipokrit, hileqar, mashtrues, i zbukuruar nga jashtë, por i kalbur, i prishur nga brenda.

Hajdutët e këtij shekulli vazhdojnë t'i presin rrugën karvanit të fesë. Largpamësia e këtij shekulli duket se është verbuar. Ai nuk e njeh të Drejtin!

Vetëm ata që kanë humbur njerzillëkun mund t'u dorëzohen zinxhirëve egoistë të këtij shekulli. Syri i këtij shekulli është mbuluar, ndo-

*“Mësoni fëmijët tuaj të falen që në moshën 7 vjeçare. Nëse në moshën 10 vjeçare e anashkalojnë namazin atëherë ndëshkojini lehtësisht.”*

*(Tirmidhî, Salât, 299)*



tur me gjak dhe ambicie, tashmë nuk sheh dot. Qerpikët janë kthyer në kthetra që rrëmbejnë çfarë t'u dalë para.

Ai që bie në kurthin e këtij shekulli e pa-ndeh veten të lirë. Ai është helmosur në duart e këtij shekulli por akoma mendon se është i gjallë.

O grua myslimane! Ti je burimi i jetës së fidanëve të shoqërisë. Ti je mbrojtësja e amanetit të shoqërisë. Atëherë zbulo me mençurinë tënde tiparet e larta që t'u dhuruan.

O grua myslimane! Hz. Fatma është she-mbull për ty, andaj mos e largo syrin e as zem-rën tënde prej saj!

Deri sa dega jote të dhurojë një frut si Hz. Husejni dhe kopshti i trëndafilave të sjellë sti-nën e vjetër.”

Lutemi duke thënë:

“O Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje!

Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të për-  
ulur ndaj Teje!” (Bekare, 128)

*“Kush e mëson Kurandin në moshë të vogël ai ndriçohet me nurin e tij.”*

*(Ali el-Muttakî, Kenz, I, 532)*



LUMTURIA FAMILJARE NË JETËN E DY BOTËVE \_\_\_\_\_

**O Zot! Ringjalle familjen dhe shoqërinë tonë përmes devotshmërisë!**

**Ruaje brezin tonë nga femohuesit, të prishurit e të shkujdesurit!**

**Amin!..**

*Fëmijët e edukuar me moralin islam janë sadaka rrjedhëse për prindërit e tyre. Janë ndriçim për jetët e dy botëve... Janë burim shpërblimi dhe mirësie edhe pas vdekjes së tyre...*

# DETYRAT E PRINDËRVE TË PËRKUSHTUAR NDAJ FËMIJËVE TË TYRE



*Fëmijët janë si fletë të bardha!*

*Mbushja e tyre me besim,  
vepra të mira dhe moral të bukur  
është detyrë e prindërve.*





# DETYRAT E PRINDËRVE TË PËRKUSHTUAR NDAJ FËMIJËVE TË TYRE

## TË DREJTAT E FËMIJËVE

(Sipas një transmetimi) një ditë Hz. Mevlana pa vajzën e tij Melike Hatun duke qortuar një shërbëtore. Ai e këshilloi duke i thënë:

*“- Përse po e rëndon atë me fjalë? Çfarë do të bëje ti nëse do të ishe shërbëtorja e saj? Bija ime, askush nuk mund të jetë në kuptimin e vërtetë të fjalës robi apo shërbëtori i dikujt tjetër përveçse*

*i Allahut. Ata që të shërbejnë sot nuk mund të jenë kurrë robëreshat tuaja, por vetëm motrat tuaja.”* (Eflâkî, Âriflerin Menkıbeleri, v. I, fq. 626)

Fëmijët u janë besuar prindërve të tyre.

Prindërit gjithashtu u janë besuar fëmijëve të tyre. Fëmijët dhe prindërit kanë detyrime dhe të drejta kundrejt njëri-tjetrit.

Rritja dhe edukimi i fëmijëve në formën më të bukur dhe përkujdesja ndaj tyre është një tipar i natyrshëm i njeriut nisur nga fakti se fëmijët përbëjnë një vazhdimësi të prindërve pas vdekjes së tyre.

Mendimtari i njohur Mevlana këtë tipar të natyrshëm të njeriut lidhur me shqetësimin për të ardhmen e brezit të ri e shpreh me fjalët:

*“Fëmija është sekreti i prindit. Për këtë arsye njerëzit në përgjithësi u mësojnë fëmijëve tiparet e tyre të karakterit. Kur trupat e tyre groposen dhe humbasin nga sytë, ata dëshirojnë që këto tipare të mbesin në këtë botë përmes fëmijëve të tyre. Krijuesi Fuqiplotë u ka dhuruar prindërve*

**Burri dhe gruaja**

*nuk duhet të harrojnë për asnjë moment që janë bashkëshoqërues të njëri-tjetrit në këtë botë dhe në botën tjetër.*

*Shembullin më të bukur e shohim tek i Dërguari i Allahut dhe Hz. Hatixhja.*

— Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre *dëshirën dhe ambicien e madhe të edukojnë dhe të rrisin fëmijët e tyre.*”

Fëmijët janë si fletë të bardha!

Mbushja e tyre me besim, vepra të mira dhe moral të bukur është detyrë e prindërve.

Nisur nga kjo le të kujtojmë disa çështje në lidhje me detyrat e prindërve:

## DETYRAT E PRINDËRVE

1. Së pari, prindërit duhet t'i vendosin fëmijës një emër të bukur, sepse emri ndikon tek njeriu dhe karakteri i tij.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Ditën e Kijametit do të thirreni me emrin tuaj dhe emrin e baballarëve tuaj. Atëherë vendosni emra të bukur.”* (Ebû Dâvûd, Edeb, 69)

I Dërguari i Allahut i ndryshoi emrat e pakuptimtë në emra me kuptime të bukura.

“Një ditë Pejgamberi ﷺ solli një deve fe-

*“Hz. Hatixhja karakterizohej nga një urtësi dhe mençuri e thellë. Ajo arriti të dallonte tek i Dërguari i Allahut portretin e një njeriu të jashtëzakonshëm dhe po aq të ndikohej prej tij duke hyrë në histori si një personalitet i pashembullt i mëmësisë.”*



mër dhe pyeti se kush do ta milte? U shfaqën dy persona me emrin Murre (i hidhur), por Pejgamberi ﷺ u tha:

“-Uluni!”

Më pas erdhi një i tretë me emrin Xhemre (flakë), por edhe atij i tha:

“-Ulu!”

Pastaj erdhi një sahabi me emrin Jaish (jetë) dhe si përfundim mori detyrën. (Taberânî, *Múxhem*, XXII, 277; *Muvatta'*, Isti'dhân, 24)

Fatkeqësisht sot u vendosen fëmijëve emra të pakuptimtë që nuk krijojnë asnjë ndjesi shpirtërore.

Ne duhet t'u vendosim fëmijëve tanë emrat e pejgamberëve, të bashkëshorteve të tyre, të sahabeve, të njerëzve të mirë e të devotshëm, emra cilësish të lavdëruar në Kuranin Fisnik apo çdo emër tjetër që ka një kuptim të bukur.

2. Qasja me një vëmendje të veçantë ndaj

*Prindërit e përkushtuar që i besojnë Allahut dhe Jetës së Përtejme kur bëhet fjalë të zgjedhin midis lumturisë së fëmijëve të tyre në jetën e kësaj bote apo atë të Ahiretit, pa asnjë hezitim zgjedhin Jetën e Përtejme.*



— Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre edukimit fetar përbën thelbin e besimit. Duhet t'u mësojmë fëmijëve se kjo jetë është një botë e sprovave.


Mënyra më e përsour për t'u dhuruar fëmijëve këtë edukim është dërgimi i tyre në medrese apo në kurse të ndryshme fetare. Përzgjedhja e ambienteve të tjera mësimore me qëllim arritjen e rehatisë së kësaj bote me shqetësimin e një të ardhmeje profesionale përbën një përgjegjësi të madhe për prindërit për sa kohë këto ambiente frekuentohen nga një gamë nxënësish dhe mësuesish të papërshtatshëm.

Nuk duhet harruar që jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit. E ardhmja e vërtetë është Ahireti. Dituria e vërtetë është njohja e Krijuesit (marifetullah).

“Të ardhmen në këtë botë ta ketë të ndritur, edhe pse në botën tjetër fytyra do i nxihet.”

Prindërit të cilët duhet të investojnë së paku 15-20 vjet për edukimin e fëmijëve të tyre në mënyrë që ata të fitojnë një profesion që do ta praktikojnë për 30-40 vjet në jetën e kësaj bote,

*Një prind i përkushtuar  
nuk mund të thotë: “Në këtë botë  
le të ngopet fëmija im e ta mbushë barkun plot,  
ndërsa në tjetrën po deshi edhe helm  
e zehër le të pijë.”*



duhet të peshojnë mirë rëndësinë e edukimit shpirtëror që do u vlejë fëmijëve pafundësisht në jetën e përtejme. Nisur nga kjo, të mjaftuarit me një kurs fetar njëmuor përbën një qasje nënvlerësuese ndaj edukimit kuranor dhe islam.

U deshën 23 vjet që Kurani të zbriste, të mësohej dhe të praktikohet nga sahabet e nderuar. Në Islam kërkimi i diturisë zgjat nga djepi deri në varr.

Kur bëhet fjalë për edukimin fetar të fëmijëve sot është e nevojshme t'i kushtohet rëndësi edhe burimit të këtij edukimi sepse fatkeqësisht rrymat moderniste dhe historicizmi po krijojnë ndikimin e tyre edhe ndaj edukimit fetar.

I Dërguari i Allahut i ka thënë Abdullah bin Omerit:

*“O Ibn-i Omer! Përqafoje fort fenë tënde, përqafoje fort fenë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Ki kujdes nga kush e mëson fenë tënde! Shkencat dhe dispozitat fetare t'i mësosh nga dijetarët e devotshëm, jo nga ata*

*Ne duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë faljen e namazit që në moshë të vogël ashtu sikurse duhet t'i brumosim me dëshirën për t'i dhuruar dhe kënaqur nevojtarët.*

— Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre *që orvaten majtas djathtas për interesat e kësaj bote!*” (Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi’r-Rivaje, el-Medinetu’l-Munevvere, el-Mektebetu’l-Ilmijje, fq. 121)

3. Nënata dhe baballarët duhet të shfaqin sjellje të bukura shembullore ndaj fëmijëve të tyre. Në të kundërt fëmijët që rriten në ambiente grindjesh dhe mosmarrëveshjesh, reflektojnë në karakterin e tyre një lloj trishtimi dhe rebelizmi. Ndërsa ata të cilët rriten në një ambient të paqte dhe të ekuilibruar fitojnë tipare të bukura dhe rriten të edukuar.

4. Sjellja e fëmijëve duhet të kontrollohet pa u ndier prej tyre. Ata nuk duhet të lejohen të sillen ndryshe kur janë vetëm, e ndryshe në prani të prindërve.

Prindërit nuk mund ta përmbushin detyrën e tyre duke thënë: “Unë i dërgoj fëmijët në medrese prandaj nuk kam më detyrime ndaj tyre.” Tërheqja mënjanë dhe qëndrimi në një plan dytësor në çështjen e edukimit të fëmijëve padiskutim përbën një qasje të gabuar. Përkundrazi, prindërit përveç përzgjedhjes së një ambienti të duhur arsimor, duhet të jenë

*Ne duhet të shqetësohemi  
për të ardhmen e brezit. Duaja e Hz. Ibrahimit e  
shpreh kaq bukur këtë ndjenjë merakosjeje:  
O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të  
kryejmë përherë namazin!*

(Ibrahim, 40)



përherë vigjilent ndaj ambientit shoqëror të fëmijëve të tyre. Kështu në hadithin profetik thuhet:

*“Njeriu është në fenë e shokut të tij. Prandaj secili prej jush le të jetë i kujdesshëm me kë shoqërohet!”* (Ebû Dâvûd, Edeb, 16/4833)

Nisur nga kjo, secili nga ne duhet të thellohet në mesazhin e këtij hadithi profetik:

*“Të gjithë ju jeni çobanë dhe përgjegjës të tufës suaj.*

*Burri është çoban i familjes së vet dhe përgjegjës i tufës së tij.*

*Gruaja është çobaneshë e familjes së saj dhe përgjegjëse e tufës së saj.”* (Buhârî, Vesâjâ, 9; Muslim, Imâre, 20)

Vërtet;

Çobani e ndjen gjendjen shpirtërore të kopësë së vet.

Çobani e kullot tufën në një tokë të begatë, e çlodh dhe e ushqen. Nuk e çon në tokë të thatë.

Me fjalë të tjera, prindërit duhet t’i ushqejnë

*Detyra jonë më e vështirë  
është përpjekja e vazhdueshme  
për t’i ruajtur fëmijët tanë dhe brezin e ri  
nga rrymat helmuese që synojnë të lëkundin  
besimin mbi jetën e Ahiretit (Jetën e Përtejme).*

\_\_\_\_\_ Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre shpirtërisht fëmijët e tyre dhe t'i dërgojnë në ambiente të përshtatshme ku mund ta marrin këtë ushqim shpirtëror.

Çobani e ruan kopenë e vet nga çdo kafshë grabitqare.

Prandaj, një prind duhet ta mbrojë fëmijën e tij nga çdo e keqe (nga gjërat që Allahu i ka ndaluar, nga droga, nga rrugët e gabuara të internetit, televizionit, modës dhe reklamave).

Çobani nuk e lë në mëshirë të ujqërve qoftë edhe një qengj të sëmurë, por e merr atë në krahë dhe e përfshin në tufë.

Prindërit krahas namazit duhet t'u mësojnë fëmijëve edhe mëshirën edhe dhembshurinë. Sepse mëshira është fryt i namazit.


Çobani përherë e kontrollon tufën për të cilën është përgjegjës herë nga para herë nga mbrapa.

Sepse;

Zemra nuk mund të qëndrojë e zbrazët. Nëse ne nuk arrijmë të mbushim zemrën e fë-

*"O Ibn-i Omer! Përqafoje fort fenë tënde, përqafoje fort fenë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Ki kujdes nga kush e mëson fenë tënde! Shkencat dhe dispozitat fetare t'i mësosh nga dijetarët e devotshëm, jo nga ata që përpiqen majtas djathtas për interesat e kësaj bote!"*

*(Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, el-Medinetu'l-Munevvere, el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121)*



mijëve tanë, atëherë do ta mbushin të tjerët. Për këtë arsye krahas edukimit formal duhet t'i kushtojmë rëndësi edhe edukimit informal.

Me pak fjalë:

Nëse duam që fëmijët tanë të kenë një të ardhme të ndritur atëherë duhet t'i edukojmë me mirësi dhe përkushtim.

5. Duhet t'i vlerësojmë dhe t'i shpërblejmë fëmijët kur ata bëjnë punë të mira dhe të dobishme. Imam Maliku përbën një shembull të bukur në këtë çështje. Babai i bënte një dhuratë sa herë mësonte një hadith përmendsh. Erdhi një kohë që ai kënaqej sa herë mësonte një hadith të ri edhe pse tanimë babai nuk i bënte më dhurata.

Gabimet e fëmijëve duhet të ndreqen me një gjuhë të ëmbël dhe duhet bërë përpjekje që të mos përsëriten më.

Dhembshuria prindërore nuk duhet të jetë shkak që të mbyllet një sy ndaj gabimeve të fëmijëve dhe të mos qortohen për gabimet e tyre. Nuk duhet harruar që Krijuesi Fuqiplotë është

*Gruaja fisnike është mbështetja  
më e madhe e bashkëshortit të saj  
dhe edukatorja e parë dhe më e rëndësishme  
e fëmijëve të saj. Nëna të tilla fisnike meritojnë  
falënderime të pafundme.*

\_\_\_\_\_ Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre Mëshirues, Mëshirëplotë dhe Ai ka urdhëruar ato çështje për të cilat njerëzimi ka nevojë. Do të ishte lajthitje e madhe për njeriun të vepronte sikur të ishte më i mëshirshëm se Ai.

Për shembull, të mos e zgjosh nga gjumi për të falur namazin e sabahut një të ri që ka arritur moshën e pjekurisë nuk është mëshirë, përkundrazi është mungesë mëshire.

Hz. Mevlana mëshirën e Mëshiruesit e shpreh me fjalët:

*“Nënave ua mësova Unë dashurinë amësore. Mendo pak si është mirësia dhe dashuria që kam zgjuar në zemër...”* (Methnevi)

6. Fëmijëve nuk duhet t’u jepen dënime pa kriter, sepse kjo mund të krijojë një efekt të padëshiruar. Këta fëmijë në vend që të heqin dorë nga një sjellje jo e hijshme, e kthejnë atë në një ves të keq sa që asnjë këshillë nuk u bën më dobi.

7. Urdhëresat, ndalesat, rregullat dhe çdo çështje tjetër e fesë, fëmijëve duhet t’u mësohen

*Fëmijët imitojnë (kopjojnë)  
prindërit e tyre.*

*Më shumë se nga fjalët,  
ata mësojnë nga sjelljet e tyre.*



në një mënyrë të kuptueshme dhe të qartë, në përputhje me nivelin e tyre të të kuptuarit.

8. Është shumë e rëndësishme të tregohemi të kujdesshëm ndaj rregullave të mirësjelljes. Nëna dhe babai duhet të shfaqin modelin më të bukur në mënyrë që fëmija të fitojë personalitetin dhe identitetin e duhur dhe të rritet i sjellshëm dhe i edukuar.

I Dërguari i Allahut u martua me Ummu Selemen e cila ishte e ve dhe mori përsipër edukimin e fëmijëve të saj.

Një nga këta fëmijë, Ebu Hafsi tregon:

“Unë isha një fëmijë që u rrita nën përkujdesjen e Pejgamberit a.s.. Kur uleshë për të ngrënë dora ime shëtiste në të gjitha anët e pjatës. Atëherë i Dërguari i Allahut me tha:

*-O djalosh! Thuaj bismilah (me emrin e Allahut)! Ha me dorë të djathtë! Ha në pjesën (e pjatës) para teje!*

Që nga ajo ditë kam ngrënë ashtu siç më ka mësuar ai.” (Buhârî, Et‘ime 2-3; Muslim, Eshribe 108)

*Një grua fisnike  
është mbrojtëse e paqes, e familjes së saj  
dhe dritë e kristaltë  
që ndriçon zemrat.*



— Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre

9. Fëmijëve duhet t'u lejohet ta jetojnë fëmijërinë e tyre brenda kufijve legjitimë. Por nga ana tjetër është e nevojshme që këto kufij të përcaktohen në mënyrë të duhur.

Kur i Dërguari i Allahut emigroi në Medine, nëna e Enes Bin Malikut i kërkoi Pejgamberit të pranonte djalin e saj 10 vjeçar që t'i shërbente. Mirëpo një fëmijë i kësaj moshe ishte e pamundur t'i shërbente një profeti. Sidoqoftë, i Dërguari i Allahut e pranoi kërkesën e asaj nëne me qëllim që të na mësonte se si duhet edukuar një fëmijë.

Hz. Enesi tregon që shpesh ai harronte detyrat me të cilat ishte ngarkuar dhe përfshihej në lojëra, por asnjëherë i Dërguari i Allahut nuk e qortonte, përkundrazi sillej me butësi dhe dashuri ndaj tij.

Kur i Dërguari i Allahut falej si imam në xhami, vinin nipërit e tij, Hasani dhe Husej-ni dhe kur ai ishte në sexhde ata i hipnin mbi shpinë. Por, i Dërguari i Allahut nuk i trazonte, priste në sexhde derisa ata të uleshin. (Hejsemí, IX, 175)

*Një grua fisnike është shembulli  
më i bukur i përpjekjes dhe sakrificës  
për t'u përfshirë në atmosferën e Kuranit  
pa lënë pas dore kontributin e saj të  
pazëvendësueshëm në familje.*



Kjo sjellje e Pejgamberit na mëson dy gjëra:

- Dashuria dhe dhembshuria ndaj nipërve.
- Bërja e namazit të dashur.

10. Fëmijët duhet të mësohen të meditojnë rreth mirësive të panumërta të Krijuesit Fuqiplotë. Ata duhet të mësohen ta falënderojnë Allahun e Lartësuar, ta lavdërojnë Atë dhe të nisin çdo punë me emrin e Tij.

Kur një nga fëmijët e Abdulmutalibëve fillonte të fliste, i Dërguari i Allahut i mësonte ajetin 111 të sures Isra duke ia përsëritur atë 7 herë. (Abdurrezzâk, IV, 334; Ibn-i Ebî Shejbe, I, 348)

وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي لَمْ يَتَّخِذْ وَلَدًا  
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ شَرِيكٌ فِي الْمُلْكِ  
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ وَلِيٌّ مِنَ الذُّلِّ وَكَبْرَهُ تَكْبِيرًا

“Thuaj: “Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës” dhe madhëroje Atë, duke

*“Ai që bëhet shkak për një punë të mirë,  
ka shpërblim sikur ta ketë bërë vetë atë të mirë.”*

*(Tirmidhî, Ilim, 14)*

*Anëtarët e familjes që ndihmojnë njëri-tjetrin për të fituar kënaqësinë e Allahut marrin gjithashtu shpërblim nga kjo përpjekje.*

— Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre

**ngritur lart madhështinë Tij!”** (Isra, 111)

Imam Rabbani i mësonte me ngulm fëmijët e tij që ta përmendnin Krijuesin Fuqiplotë. Në një letër drejtuar të birit Muhamed Masum, thotë:


“Është koha për dhikër. Të gjitha prirjet dhe dëshirat egoiste vendosi brenda fjalës «**لا**» që të mund t’i çrrënjosësh e të mos biesh pre e tyre. Kënaqu me caktimin e Allahut të Lartësuar!

Kur të shqiptoni pjesën ‘përveç Allahut’ në fjalën e dëshmisë, meditoni rreth madhësisë së Allahut që është përtej çdo imagjinate dhe diturie dhe përbën për ne një mister. Mos e humbni kohën pas shtëpive, pallateve, pasurive e sa e sa gjërave të tjera që ju thërrasin drejt kësaj bote.»

11. Fëmijët duhet të mësohen që në moshë të re ta duan adhurimin dhe të ndejnë kënaqësi nga shërbimi në rrugë të fesë.

H.z. Ibrahim i me të birin H.z. Ismailin ndër-tuan Qaben dhe e pastruan atë së bashku.

*Gratë fisnike duhet të jenë gjithmonë pranë bashkëshortëve në përpjekjet e tyre për t’i shërbyer fesë, besimit e Kuranit. Nga ana tjetër, edhe burrat nuk duhet t’i pengojnë bashkëshortet në përpjekjet e tyre për t’i shërbyer edukimit fetar për sa kohë ky shërbim kryhet në kushte të përshtatshme.*



Sahabet e nderuar agjëronin në Ditën e Ashures bashkë me fëmijët e tyre dhe i jepnin atyre lodra në duar që të mund ta kalonin kohën deri në yftar.

Babai im i ndjerë Musa Efendiu na shëntiste në vende historike dhe shpirtërore dhe pasi kishte ndarë ca para kërkonte nga ne që t'ua dhuronim njerëzve në nevojë që rrinin në oborret e xhamisë Ejub Sulltan, Ullu Xhami apo Emir Sulltan. Ne vraponim për të kryer këtë shërbim dhe gëzoheshim me lutjet e atyre njerëzve të vuajtur.

Po ashtu duhet të ngulisim në shpirtin e fëmijëve tanë dashurinë për atdheun, forcën e besimit dhe guximin.

12. Dashuria është themeli i edukimit të fëmijëve. Ne si prindër duhet të bëhemi të dashur tek fëmijët tanë dhe po ashtu t'ua bëjmë të dashur atyre Krijuesin Fuqplotë dhe të Dërguarin e Tij.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Edukoni fëmijët tuaj në tre aspekte:*

*Nëse edukimi i brezit lihet pas dore,  
e ardhmja do të jetë e trishtë. Fëmijët tanë  
do të largohen nga feja dhe qytetërimi, duke  
humbur kështu identitetin e vërtetë.*

— Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre

*Dashurinë ndaj Profetit, dashurinë ndaj Ehli Bejtit dhe leximin e Kuranit...*” (Munâvî, I, 226)

Fatkeqësisht pushtimi i huaj kulturor po mësyn në zemrat e fëmijëve tanë. Rrezikun e drejtimit në rrugë të kundërta nga rruga profetike e dashurisë dhe devotshmërisë, Hz. Mevlana e shpreh me fjalët:

*“Kush synon një sofër tjetër pos sofrës së dijes së Profetit, ta dijë që s’ka për të kaluar asgjë poshtë gërmazit.*


*Kush shkon në një tryezë tjetër përveç tryezës së Profetit, ta dijë se shejtani do të hajë me të në të njëjtën enë.*

*Kush largohet nga fqinjësia me të ﷺ, nuk ka dyshim se shejtani bëhet fqinj i tij.*

*Kush niset në një rrugë të largët pa të ﷺ, atëherë shoqërues do ketë shejtanin.*

*Edhe në qoftë duke kalëruar një kalë të sojit përsëri lakmia ndaj njerëzve të fisshëm do ta mendojë, sepse tashmë djalli i është qepur pas.*

*Nëse i lëmë pas dore fëmijët tanë,  
atëherë shpirtërisht ata do jenë fëmijët  
dhe brezi i të huajve. Afërsia e mbetur biologjike  
nuk do ketë më asnjë vlerë. Pas kësaj faze as  
britmat e nënave s’do të bëjnë më dobi.*



*O mik! Allahu i Lartësuar na bëri të ditur se kush ndjek shejtanin, ai do të bëhet pjesë në pasurinë dhe fëmijët e tij. (Isra, 64)*

Allahu na ruajtë nga ortakëria me shejtanin e mallkuar.

**13. Me pak fjalë, nëse duam të rrisim një fëmijë të përsosur, fillimisht ne si prindër duhet të jemi të përsosur.**

Prindërit në përgjithësi nisur nga një ndjenjë e natyrshme e shqetësimit për të ardhmen, dëshirojnë t'i lënë një trashëgimi fëmijëve të tyre në mënyrë që të mos vuajnë nga varfëria apo skamja.

Por e vërteta është se trashëgimia e vërtetë është trashëgimia shpirtërore. Pra, edukimi me një karakter dhe personalitet islam.

Nëse prindërit arrijnë t'i brumosin fëmijët e tyre me këtë formim shpirtëror, atëherë këta fëmijë do jenë të aftë ta përdorin siç duhet edhe trashëgiminë materiale duke e bërë atë mjet për të arritur Jetën e Përtejme, pa u llastuar me pasuri dhe pa rënë në rrugë të gabuara.

*Fëmijët lindin me një ndjenjë naiviteti dhe pastërtie të denjë për xhenetin. Mirëpo nëse prindërit e lënë pas dore edukimin e tyre shpirtëror atëherë ata zogj të xhenetit mund t'i orientojnë në një drejtim të gabuar.*

\_\_\_\_\_ Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre

Në të kundërt, trashëgimia materiale pa atë shpirtërore do bëhet shkak që fëmijët të kalojnë çdo kufi duke e shpërdoruar atë pasuri pa kriter, pa falënderuar.

Për t'u mbrojtur nga ky përfundim i dhimbshëm është e nevojshme që prindërit t'i japin rëndësi edukimit shpirtëror.

Nëse prindërit nuk i përmbushin ashtu siç duhet detyrat e tyre, në Ditën e Gjykimit ata do të mundohen të largohen nga fëmijët e tyre.

Në ajetin fisnik thuhet:

**“Atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.”** (Abese, 34-36)

Mirëpo njerëzit e devotshëm do të hyjnë në xhenet së bashku me prindërit, fëmijët dhe bashkëshortet e tyre.

**“Xheneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata dhe BESIMTARËT E NDERSHËM prej prindërve të tyre, grave dhe pasardhësve të tyre.”** (Rrad, 23)

*“Kur njeriu ndërron jetë, mbyllet edhe fletorja e punëve të tij, përveç 3 rasteve:*

- Sadakaja rrjedhëse,
- Një dituri prej të cilës njerëzit kanë dobi,
- Fëmija i mirë që bën dua për të.”

(Muslim, Vasijje, 14)



**Allahu i Madhëruar mos na bëftë prej atyre që në Ditën e Gjykimit do mundohen t'u shmangen fëmijëve të tyre si rrjedhojë e shpërfilljes së misionit prindëror.**

**Na pranofte në xhenetin e Tij të lartë bashkë me fëmijët tanë dhe na mundësoftë të shohim bukurinë e Tij (xhemalullah).**

**Amin!..**

*Fëmijët tanë duhet të rriten  
të vetëdijshëm se pronari i vërtetë  
i çdo pasurie është vetëm  
Allahu i Lartësuar.*





# DETYRAT E BURRAVE DHE GRAVE

për të arritur lumturinë  
në jetën e dy botëve:



*Babai është një diell në qiellin  
e lumturisë familjare, nëna është një hënë  
që shkëlqen butësisht dëlirësinë e saj,  
ndërsa fëmijët janë yjet e atij qielli virtytësh  
të bukur si margaritarë.*





# DETYRAT E BURRAVE DHE GRAVE

për të arritur lumturinë  
në jetën e dy botëve:

## KUSHTI I PARË: DEVOTSHMËRIA

Devotshmëria është kushti i parë për të arritur qetësinë në jetën familjare.

Për të arritur paqen dhe harmoninë në jetën familjare gratë para së gjithash duhet t'i kushtojnë kujdes devotshmërisë dhe bindjes ndaj Allahut të Lartësuar. Krahas kryerjes së

adhurimeve me përkushtim, ato duhet të ruajnë kufirin midis hallallit dhe haramit (të lejuarës dhe të ndaluarës).

Shkalla e devotshmërisë dhe e përkushtimit të grave në familje duhet të jetë në një nivel të lartë sa të ndikojë pozitivisht në punët e mira të bashkëshortit, fëmijëve, të afërmve madje edhe të fqinjëve.

Gratë e sahabëve i përcillnin bashkëshortët në mëngjes me lutje duke u thënë:

“Ki kujdes! Mos sill në shtëpi diçka të fituar në rrugë të ndaluar. Sepse ne mund ta durojmë urinë në jetën e kësaj bote, por nuk mund ta durojmë dënimin në jetën e botës tjetër.”

(Abdülhamid Keşk, Fî Rihâbi't-Tefsîr, I, 26)

Detyra më e rëndësishme e grave pas përkushtimit ndaj fesë, është përkushtimi ndaj familjes.

Një grua fisnike i ngjan një luleje me aromë xheneti që shpërndan lumturi kudo përreth saj.

Një grua fisnike që arrin të bëjë të lumtur bashkëshortin dhe familjen e saj, ka fituar një-

### *Shkalla e devotshmërisë*

*dhe e përkushtimit të grave në familje duhet të jetë në një nivel të lartë sa të ndikojë pozitivisht në punët e mira të bashkëshortit, fëmijëve, të afërmve madje edhe të fqinjëve.*

kohësisht edhe kënaqësinë e Allahut. Kështu, i Dërguari i Allahut ka thënë:

“Gruaja e mirë është ajo, e cila:

- E gëzon burrin kur ai shikon fytyrën e saj,
- Përmbush kërkesat e ligjshme të bashkëshortit të saj,
- Ruan pasurinë dhe nderin edhe në mungesë të bashkëshortit të saj.” (Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 5/1857)

Një zonjë shtëpie duhet të kujdeset për pamjen e jashtme të saj, për pastërtinë dhe rregullsinë.

Ajo duhet të tregohet shumë e kujdesshme të mos vishet në mënyrë të çrregullt dhe nëse ka një ves të tillë duhet ta heqë sa më parë, në mënyrë që të shmangë çdo pamje jo të këndshme për bashkëshortin e saj.

Zemra e atij që nuk e gjen në shtëpinë e tij atë që kërkon, rrëshqet në vende të gabuara jashtë shtëpisë së tij dhe si rezultat shkatërrohet lumturia familjare.

*Një grua fisnike  
i ngjan një luleje me aromë  
xheneti që shpërndan lumturi  
kudo përreth saj.*



Për këtë arsye ajo duhet të jetë si një buqetë me lule të bukura dhe me aromë të këndshme që përhap lumturi dhe qetësi në familjen e saj aq sa bashkëshorti të presë me padurim kthimin në shtëpi.

Për ta arritur këtë, gruaja duhet ta presë me fytyrë të qeshur burrin e saj dhe po ashtu ta përcjellë me fjalë dhe lutje të bukura. Edhe sikur të ketë kaluar një ditë të lodhshme, ajo duhet të mundohet të mos e shfaqë lodhjen e saj duke ndenjtur me fytyrë të vrenjtur përballë bashkëshortit. Ajo duhet të ndajë shqetësimet e bashkëshortit të saj duke i ofruar qetësi shpirtërore.

Burri dhe gruaja duhet të tregohen të kujdesshëm të mos nëpërkëmbin lumturinë e njëri-tjetrit me mërzitje të tepërta dhe me ankesa vend e pavend.

Lidhur me këtë, duhet të kujtojmë sjelljen shembullore të Ummu Sulejmit ﷺ përballë bashkëshortit të saj Ebu Talhasë:

Tregohet se djali i tyre i sëmurë kishte

*Detyra më e rëndësishme e gruas pas përkushtimit ndaj fesë, është përkushtimi ndaj familjes.*

ndërruar jetë kur Ebu Talha nuk ndodhej në shtëpi. Ummu Sulejme mori trupin e pajetë të të birit, e lau dhe qefinosi atë me një durim të pashembullt.

Më vonë, kur Ebu Talha رضي الله عنه, erdhi në shtëpi, pyeti:

“-Si është djali?” Ummu Sulejme رضي الله عنها, tha:


“- Djalit iu qetësuan dhimbjet dhe tani be-soj se është rehatuar.”

Ndërkohë, Ummu Sulejme r.a. i porositi njerëzit e shtëpisë duke u thënë:

“- Kujdes, mos i tregoni Ebu Talhas për vdekjen e djalit, deri sa t’i tregoj vetë!..”  
Më pas, i solli ushqimin burrit të saj dhe ai hëngri. Ndërkohë, Ummu Sulejme رضي الله عنها u zbu-kurua dhe doli para tij. Më pas, ata shkuan të çlodheshin në dhomën e tyre. Në mëngjes, në momentin kur Ebu Talha رضي الله عنه, po bëhej gati të dilte nga shtëpia, Ummu Sulejme, e cila ishte një grua e zgjuar dhe e devotshme, i tha:

“- O Ebu Talha! Shiko ç’bëri ky fqinji ynë

*Një gruaje fisnike i ka hije  
të tregohet e kujdesshme që ta ruajë me  
përkushtim të ardhmen e bashkëshortit të saj  
në jetën e përtejme dhe mos t’i lerë shteg egos  
dhe shejtanit për asnjë devijim.*



... Kur i kërkova të ma kthente amanetin që ia kisha dhënë për ta përdorur, s'deshi të ma jepte.”

Ebu Talha رضي الله عنه, u përgjigj:

“- Po si kështu? Nuk paska vepruar aspak mirë!”

Pas këtyre fjalëve, Ummu Sulejme رضي الله عنها, tha:

“- O Ebu Talha! Djali yt ishte një amanet i Allahut tek ti dhe Ai e mori përsëri.”

Ebu Talha papritur u shastis, heshti dhe më pas tha:

أَنَا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ

“- Ne jemi të Allahut dhe padyshim tek Ai do të kthehemi!”

Kur shkoi në xhami për të falur namazin, i tregoi Pejgamberit صلى الله عليه وسلم, ç'kishte ndodhur.

Ndërsa i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, bëri dua duke thënë:

*Për këtë arsye ajo duhet të jetë  
si një buqetë me lule të bukura dhe me aromë  
të këndshme që përhap lumturi dhe qetësi në  
familjen e saj aq sa bashkëshorti të presë me  
padurim kthimin në shtëpi.*



“- *Allahu i Lartësuar jua begatoftë këtë natë!*” Pa kaluar një vit prej kësaj duaje profetike, Allahu i Lartësuar i fali kësaj familjeje një djalë tjetër. Pejgamberi ﷺ, bëri dua për këtë fëmijë duke ia ëmbëlsuar gojën me pak hurmë dhe e quajti Abdullah. Transmetohet se, me begatinë e kësaj duaje, Abdullahut i lindën shtatë apo nëntë fëmijë dhe të gjithë u bënë hafiza të Kuranit Fisnik. (Buhari, Xhenaiz 42, Akika I; Muslim, Edeb 23)

Në këtë histori shohim me admirim shembullin e një gruaje fisnike që me ndjenjën e nënshtrimit të plotë dhe kënaqësisë absolute ndaj caktimit hyjnor, nxit edhe bashkëshortin e saj të jetë i durueshëm dhe i matur.

Pra,

Janë të papranueshme disa sjellje kapriçoze, të cilat nuk mund të justifikohen nga probleme dhe shqetësime të papërfillshme brenda familjes.

Prandaj themi që,

Një grua fisnike nuk duhet ta neglizhojë

*Gruaja duhet ta presë  
me fytyrë të qeshur burrin e saj  
dhe po ashtu ta përcjellë me fjalë  
dhe lutje të bukura.*



kurrë burrin e saj dhe nuk duhet ta vendosë atë në radhë të dytë ndër pjesëtarët e familjes.

Për ta kënaqur një njeri, fillimisht duhet ta njohësh shumë mirë. Për këtë arsye, gruaja duhet të përpiqet ta kuptojë burrin e saj, idealët, interesat dhe ndjenjat e tij; të ndajë me të dëshirat dhe të mos ndahet kurrë prej tij.

Nga ana tjetër, edhe burri duhet të veprojë në të njëjtën mënyrë me gruan e tij.

Nëse nuk i japin rëndësi kësaj çështjeje, “**uniteti dhe gjërat e përbashkëta**” si ligj i natyrshëm i bashkëshortësisë, do të zbehet dita ditës dhe me kalimin e kohës bashkëshortët do të largohen nga njëri-tjetri.

Nëse nuk ndërhyhet në kohën e duhur, ky përjetim merr një përmasë të atillë, saqë dashurinë dhe unitetin midis bashkëshortëve e zë ndarja dhe urrejtja. Dhe, periodha më e vështirë e këtij përjetimi është pleqëria. Ashtu siç shprehet edhe në Kuranin Fisnik, në jetën martesore qetësia shpirtërore duhet të shndërrrohet në mëshirë dhe dhembshuri të ndërsjellë

*Sjelljet kapriçoze, endja me fytyrë të varur, -të vrenjtur- brenda familjes duke u justifikuar me disa probleme dhe shqetësime të kota përbëjnë veprime aspak të pranueshme.*

mes bashkëshortëve. Burri dhe gruaja duhet të jenë mbështetje për njëri-tjetrin deri në fund të jetës. Për këtë gruaja duhet ta ndihmojë dhe ta mbështesë bashkëshortin e saj në çdo punë të mirë dhe të dobishme, të lejuar.

## LIDHJET FAREFISNORE

Një grua fisnike nuk duhet të tregojë mungesë respekti ndaj të afërmeve të bashkëshortit të saj. Nëse vihet në pozitën e zgjedhjes midis dëshirës dhe sakrificës, ajo duhet të tregojë më tepër afërsi ndaj familjes së tij. Kjo sjellje e gruas, e kënaq burrin e saj.

Nga ana tjetër vjehri dhe vjehra duhet të respektohen si prindër të vërtetë.

Gjithashtu duhet treguar kujdes ndaj respektimit të kufijve të intimitetit që ka paracaktuar Islami.

Sipas parimeve islame, një person nuk mund të veçohet me një person të gjinisë tjetër me të cilin i lejohet martesë. Për shembull, një

*Një grua fisnike nuk duhet ta neglizhojë kurrë burrin e saj dhe nuk duhet ta radhisë atë në plan të dytë ndër pjesëtarët e familjes.*



grua nuk mund të qëndrojë vetëm me kunatin, burrin e motrës etj. Nga ana tjetër një burrë nuk mund të qëndrojë vetëm me kunatën, motrën e gruas etj.

Në mjediset familjare ku janë të pranishëm meshkuj të huaj gruaja duhet të qëndrojë e mbuluar. Edhe nëse këta njerëz janë të afërm, dispozita nuk ndryshon. Nga ky rregull bëjnë përjashtim vetëm të afërmit e ngushtë (pra personat me të cilët nuk mund të martohet, si: vëllai, xhaxhai, daja, nipi etj.)

Nisur nga kjo askush nuk ka të drejtë të justifikohet me qëllimin e tij të pastër apo zemrën e mirë dhe të rrënojë muret e intimitetit. Në mënyrë të veçantë gratë duhet të ruhen nga çdo situatë e dyshimtë që mund të dëmtojë personalitetin e tyre. Kjo, sepse gruaja është si një rrobë e bardhë, në të cilën bie në sy edhe njolla më e vogël. Jo më kot është thënë: *“Qëndroni larg punëve që mund të ngjallin dyshime.”*

Edhe i Dërguari i Allahut ka qëndruar larg çdo situatë që mund të ngjallte dyshime:

*Gratë duhet të ruhen nga çdo situatë e dyshimtë që mund të dëmtojë personalitetin e tyre.*

*Kjo, sepse gruaja është si një rrobë e bardhë, në të cilën bie në sy edhe njolla më e vogël. Jo më kot është thënë: “Qëndroni larg punëve që mund të ngjallin dyshime.”*

Një mbrëmje, teksa i Dërguari i Allahut ﷺ, po ecte në një rrugicë me një prej grave të tij u përball me dy sahabë medinas të cilëve u foli në formë sqarimi:

*“Kjo është nëna juaj Safije binti Huzej.”*

Sahabët thanë:

“O i Dërguar i Allahut! Allahu është larg çdo të mete! E si mundet i Dërguari i Tij të veprojë gjëra të papërshtatshme?”

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut tha:

*“Shejtani qarkullon në trupin e njeriut si gjaku. Prandaj, kam frikë se mos ju hedh ndonjë të keqe -apo dyshim- në zemrat tuaja.”* (Buhârî, I'tikâf, 11; Muslim, Selâm, 23-25. Po ashtu shih: Ebû Dâvûd, Savm, 79, Edeb, 81; Ibn-i Mâxhe, Sijâm, 65)

Një nga kushtet më të rëndësishme për lumturinë familjare në dy botët është:

## DURIMI DHE MATORIA

Jeta është plot surpriza. Mund të ketë edhe

*Admiruesit e perëndimit që kundërshtojnë me fanatizëm hixhabin apo mbulesën, le të hedhin pak shikimin tek portretet e Marisë (Hz. Merjemit). Do të përballen me imazhin e një femre fisnike të mbuluar në kuptimin e plotë (e vërtetë) të fjalës.*



periudha të vështira dhe fatkeqësi. Prandaj, në periudha të tilla, gruaja duhet të gjendet pranë burrit të saj dhe të përpiqet t'ia lehtësojë barrën. Nisur nga kjo të parët tanë kanë thënë:

*“Bëhu qilim, që të të mbajnë si kurorë!”*

*“Edhe po të të rrjedhë gjak nga goja, thuaj piva sherbet të kuq! (lëng qershie)” (Pra mos u anko, por mundohu t'i lehtësosh vuajtjet përmes durimit dhe sakrificës.)*

Problemet familjare duhet të gjejnë zgjidhje brenda anëtarëve të saj, pa qenë e nevojshme të zbulohen nga të tjerët. Përndryshe, cenohet një prag i ndjeshëm që e bën të pamundur kthimin e gjërave si më parë.

*“Mbështille me lumturi çerdhen tënde familjare në të cilën hyre me fustan nusërie. Por kur të dalësh prej asaj dere pas një jete të paqte e të nisesh për në udhëtimin e përjetshëm, dil me një qefin të bardhë e të panjollosur.”*

(Pra mos e ço nëpër mend ndarjen përmes divorcit. Martesa nuk kërkon besnikëri të përkohshme por qëndrueshmëri të përherëshme.)

*“Bëhu qilim, që të të mbajnë si kurorë!”*

*“Edhe po të të rrjedhë gjak nga goja, thuaj piva sherbet të kuq! (lëng qershie)”*

*(Pra mos u anko, por mundohu t'i lehtësosh vuajtjet përmes durimit dhe sakrificës.)*

Natyrisht, kjo nuk do të thotë që duhet të pranohet padrejtësinë, keqtrajtimet apo të heqim dorë nga të drejtat që na takojnë.

Por këto mesazhe janë këshilla të vyera në drejtim të ruajtjes së paqes familjare nga çështje të parëndësishme.

Në marrëdhëniet ndërnjerëzore është e natyrshme të hasen probleme të ndryshme. Problemet e herëpashershme që hasen në jetën familjare duhet të mënjanohen përmes durimit, tolerancës dhe altruzimit. Kjo është mënyra e vetme për të fituar lumturinë e dy botëve.

Realiteti me të cilin përballemi sot fatkeqësisht është shumë larg këtyre mësimëve. Vajzat e sapomartuara këshillohen nga familja dhe të afërmit e tyre: “Të mos lejojnë askënd t’i nëpërkëmbin; në rastin më të parë të largohen, të divorcohen.” Si rezultat numri i martesave gjithnjë e në zbritje po u lë vendin divorceve, ku ata që lëndohen më së shumti janë natyrisht fëmijët.

Durimi dhe sakrificat është ilaçi më i mirë në të gjitha marrëdhëniet njerëzore.

*Problemet familjare duhet të gjejnë zgjidhje brenda anëtarëve të saj, pa qenë e nevojshme të zbulohen nga të tjerët. Përndryshe, cenohet një prag i ndjeshëm që e bën të pamundur kthimin e gjërave si më parë.*



Sidoqoftë, kur tehu të ketë prekur kockën, pra kur bëhet fjalë për një zullum vërtet të padurueshëm, natyrisht lind nevoja të kërkohet mendimi i prindërve apo të ndiqen rrugë të tjera për ta zgjidhur këtë situatë. E rëndësishme është të përfitohet nga përvoja e duhur.

Çdo njeri dorëzohet përballë sjelljes dhe fjalës së bukur. Një grua fisnike që fiton respektin e bashkëshortit përmes maturisë dhe sjelljes së saj të bukur, do të gëzojë nderimin dhe besnikërinë e tij.

Me pak fjalë;

Sa më shumë që të dhurosh dashuri aq më shumë do të marrësh dashuri, sa më shumë që të respektosh të tjerët, aq më shumë do respektohesh. Sakrifica nuk humb, por këmbëhet me të mira dhe shpërblime. Madje njerëzit besimtarë, e dinë mirë që shpërblimin e munguar në jetën e kësaj bote do ta marrin shumëfish në jetën e përtejme.

Dashuria, respekti dhe sakrifica në familje fillimisht duhet të tregohen nga gruaja. Në një hadith profetik thuhet:

*“Mbështille me lumturi çerdhen tënde familjare në të cilën hyre me fustan nusërie. Por kur të dalësh prej asaj dere pas një jete të paqtë e të nisësh për në udhëtimin e përjetshëm, dil me me një qefin të bardhë e të panjollosur.”*



*“Gruaja që vdes ndërkohë që burri i saj është i kënaqur me të, hyn në xhenet.”* (Tirmidhî, Radâ, 10; shih: Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 4)

Në këtë hadith tregohet shpërblimi që do të ketë një grua e mirë e cila ka arritur të fitojë kënaqësinë e burrit dhe në të njëjtën kohë vendin që zë burri në familje dhe rëndësinë e përkushtimit të gruas.

Nga ana tjetër, burri duhet të bëjë kujdes ndaj mënyrës së fitimit në punën e tij. Ai nuk duhet t’i ushqejë gruan dhe fëmijët me gjëra të dyshimta, të cilët nuk mund të kenë dijeni për burimin e shpenzimeve që bëhen në familje.

Kjo është një çështje shumë delikate, sepse mënyra e të ushqyerit (haram apo hallall) ndikon shumë në botën shpirtërore të njeriut.

Gratë duhet t’u gjenden gjithmonë pranë bashkëshortëve të tyre në punë të lejuara, në mënyrë që burrat të gjejnë prehje dhe mbështetje tek ato. Siç dihet, mirësitë dhe bukuritë shtohen sa më shumë që të ndahen me të tjerët, ndërsa fatkeqësitë dhe hidhërimet pakësohen sa më shumë që të ndahen me të tjerët.

*Bija ime!*

*Mos e ço nëpër mend ndarjen  
përmes divorcit. Martesa nuk kërkon besnikëri  
të përkohshme por qëndrueshmëri të  
përhershme.*



Burri dhe gruaja nuk duhet të harrojnë asnjëherë që janë bashkudhëtarë në rrugëtimin e jetës së kësaj bote dhe botës tjetër. Ndërkohë që më parë secili prej tyre kishte një jetë të pavaruar, përmes martesës ata bëhen pjesë e një jete dhe fati të përbashkët. Për rrjedhojë, ata duhet të respektojnë detyrimet e jetës së përbashkët dhe duhet të mbështesin gjithmonë njëri-tjetrin përballë sfidave të jetës.

## LARGPAMËSIA DHE MORALI I BUKUR

Nëse shqyrtojmë çështjet që prishin qetësinë familjare, konstatojmë se këto mund të parandalohen përmes moralit të bukur, sjelljeve të matura dhe largpamëse.

Një grua e mençur duhet të zotërojë mjeshhtërinë e të fituarit të zemrës së bashkëshortit të saj.

Ajo, duhet të bëjë kujdes ndaj sjelljeve të burrit të saj dhe, kur vëren se ai është i nevriko-

*Realiteti me të cilin përballemi sot fatkeqësisht është shumë larg mësimeve të të parëve tanë;*

*Vajzat e sapomartuara këshillohen nga familja dhe të afërmit e tyre: "Të mos lejojnë askënd t'i nëpërkëmbin; në rastin më të parë të largohen, të divorcohen."*

sur për diçka nuk duhet ta zmadhojë çështjen duke e çuar atë deri në përmasat e një mosmarrëveshjeje. Kjo, sepse grindjet serioze dhe afatgjata, e cenojnë dashurinë dhe respektin midis bashkëshortëve, duke e vënë në rrezik harmoninë e familjes. Në raste të tilla, është e domosdoshme që gratë të bëjnë kujdes në sjelljet e tyre ndaj burrave, duke u treguar të matura dhe të durueshme. Në fund, edhe burri do ta kuptojë gabimin e vet dhe do t'i kthehet gruas me një respekt më të thellë. Përndryshe, edhe pse fajtor, burri nuk do ta kuptojë padrejtësinë që bën kundrejt bashkëshortes së tij dhe si rezultat shejtani do të hedhë farat e urrejtjes dhe armiqësisë në zemrat e tyre.

Një çështje tjetër ndaj së cilës bashkëshortët duhet të jenë të kujdesshëm është edhe xhelozia e tepruar dhe ndjenja e mosbesimit. Humbja e besueshmërisë tek të tjerët është një ndjesi që njerëzit nuk e duan. Nisur nga kjo, para se të fajësojnë njëri-tjetrin për çfarëdolloj çështjeje, bashkëshortët duhet të ndjekin rrugën e diskutimit të gjërave me qetësi. Përndryshe nuk ka

*Si rezultat i orientimeve të gabuara,  
numri i martesave gjithnjë e në zbritje  
po u lë vendin divorceve, ku ata që lëndohen  
më shumë janë sigurisht fëmijët.*



kuptim që gjërave të vogla e të parëndësishme t'u jepet vend aq sa të kthehen në probleme të mëdha.

Njerëzve, mund t'ju mungojë intuita në lidhje me disa çështje, ata mund të harrojnë ose të gabojnë. Prandaj, nëse gruaja e sheh se burri ka nevojë të këshillohet, ajo duhet t'i gjendet pranë bashkëshortit dhe ta mbështesë me sinqeritet duke i ofruar mendimin e saj më të drejtë. Nuk duhet harruar që burri dhe gruaja janë udhëtarë në një rrugëtim të përbashkët ku duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin.

Nga ana tjetër gruaja duhet t'i shmanget kritikës dhe këshillimit të burrit pranë të tjerëve. Sado që të ketë gabuar, ajo nuk duhet ta turpërojë burrin dhe të shfaqë mangësitë e tij në mesin e të tjerëve. **Kjo bie ndesh me parimet etike. Por e njëjta gjë natyrisht vlen edhe për burrat.** Kështu në ajetin fisnik thuhet:

**“Ato (bashkëshortet) janë petk për ju e ju jeni petk për ato.”** (Bakare, 187)

Nga ana tjetër, nuk është urtësi që gruaja

*Çdo njeri dorëzohet përballë  
sjelljes dhe fjalës së bukur.*

*Një grua fisnike që fiton respektin  
e bashkëshortit përmes maturisë  
dhe sjelljes së saj të bukur, do të gëzojë  
nderimin dhe besnikërinë e tij.*

përkundër të metave dhe magësive të burrit të saj, të lavdërojë një burrë tjetër pranë tij. Ajo nuk duhet të ankohet për burrin e saj tek askush, qoftë edhe tek prindërit e saj dhe duhet të ketë kujdes të mos e vërë në pozitë të vësh-tirë pranë të tjerëve. Në vend që t'i shfaqin mosmarrëveshjet midis tyre tek të tjerët duhet të përpiqen t'i zgjidhin ato mes vete.

Me pak fjalë, themeli i arritjes së lumturisë në këtë jetë dhe në jetën tjetër është vlerësimi dhe respekti i ndërsjellë midis burrit dhe gruas. Ata duhet ta dinë mirë vlerën e njëri-tjetrit.

Nëse bashkëshortët respektojnë parimet e bukura të moralit, ata do të bëhen xhene-ti i njëri-tjetrit. Në të kundërt, nëse shkelin mbi këto parime, jeta do bëhet e papërballue-shme.

Në lidhje me vlerën e gruas së devotshme i Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Pas përkushtimit ndaj Allahut, mirësia më e madhe për besimtarin është një grua e mirë e cila:*

*Çdo njeri dorëzohet përballë sjelljes dhe fjalës së bukur. Një grua fisnike që fiton respektin e bashkëshortit përmes maturisë dhe sjelljes së saj të bukur, do të gëzojë nderimin dhe besnikërinë e tij.*



- *E gëzon burrin kur ai shikon fytyrën e saj,*
- *Përmbush kërkesat e ligjshme të bashkëshortit të saj,*
- *Ruan pasurinë dhe nderin edhe në mungesë të bashkëshortit të saj.”* (Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 5/1857)

## EKONOMIA NË FAMILJE

Disa njerëz pandehin se lumturia është fshehur tek pasuria dhe mundësia ekonomike për të zotëruar gjithçka. Nisur nga kjo ata e quajnë fat të madh martesën në një derë të pasur.

Lumturia e vërtetë është lumturia në jetën e dy botëve. Pasuria e kësaj bote është sprovë dhe mjet për të fituar botën tjetër (ahiretin).

Një grua e mirë, edhe nëse bën pjesë në një familje të pasur, nuk bie pre e tundimit të luksit dhe shpërdorimit, por mëson të jetë e përmbajtur.

*“Gruaja që vdes  
ndërkohë që burri i saj  
është i kënaqur me të, hyn në xhenet.”*

*(Tirmidhî, Radâ, 10; shih: Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 4)*

Ndërsa një grua e mirë që ka mundësi të kufizuara materiale, arrin ta përjetojë lumturinë dhe paqen përmes ndjenjës së dorëzimit ndaj caktimit hyjnor. Ajo nuk shpreh ambicie të zotërimit të gjithçkaje që sheh në kurriz të rëndimit të buxhetit familjar. Pasuria më e madhe që mund të zotërojë njeriu është kënaqja me atë që ka dhe jo endja në kërkim të diçkaje që nuk mund ta zotërojë dot.

Sepse ambicia e tepruar e rrokullis njeriun drejt një amullie shpirtërore dhe mbingarkese të papërballueshme.

Për shkak të kartave të kreditit gjithnjë e më të përhapura në ditët tona, shumë familje që mendojnë se mund të marrin me lehtësi gjithçka që shohin, bien në vorbullën e borxheve dhe kamatës si rezultat i harxhimeve të panevojshme. Kështu sa e sa familje të lumtura humbasin harmoninë dhe qetësinë familjare duke përfunduar deri në shkatërrim.

Edhe nëse gjendja ekonomike e një familjeje është shumë e mirë, duhet të shmangen shpenzimet e tepruara dhe shpërdorimi. Kjo

*Gratë duhet t'u gjenden gjithmonë pranë bashkëshortëve të tyre në punë të lejuara, në mënyrë që (burrat) të gjejnë prehje dhe mbështetje tek ato. Siç dihet, mirësitë dhe bukuritë shtohen sa më shumë që të ndahen me të tjerët, ndërsa fatkeqësitë dhe hidhërimet pakësohen sa më shumë që të ndahen me të tjerët.*



është një detyrë që i përket si gruas ashtu edhe burrit. Vjen një ditë që njeriu bie në pozitën e padëshiruar të kërkimit të asaj që e ka shpërdoruar. Krijuesi Fuqiplotë në ajetin kuranor shprehet:

“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepëruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë **vëllezërit e djallit** dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (Isra, 26-27)

Si mund të jenë dorëshpuarit vëllezër të djallit?

Nuk duhet harruar se shpërdorimi është përpjekja për të shtypur ndjenjën e inferioritetit përmes pasurisë dhe dukjes.

Sepse si rezultat i tendencës së njeriut për të imituar, familjet fillojnë të ndjekin shembullin e njëra-tjetrës në çështjen e shpërdorimit duke e kthyer atë në një epidemi. Kjo natyrisht e bën më të lehtë punën e djallit.

Nëse njeriu zotëron ushqime, pije apo veshje të tepërta, duhet të kërkojë dhe të gjejë nevojtarët dhe t'ua ndajë të drejtat që u takojnë.

*Burri dhe gruaja  
nuk duhet të harrojnë asnjëherë  
që janë bashkudhëtarë në rrugëtimin e jetës  
së kësaj bote dhe botës tjetër.*



Sepse gëzimi i nevojtarëve dhe fitimi i duasë së tyre të sinqertë është garanci për bereqetin dhe lumturinë e familjes. Nuk duhet harruar se besimtari është përgjegjës për vëllanë e tij besimtar dhe po ashtu nuk duhet të harrojmë se ne mund të ishim në pozitën e nevojtarëve dhe nevojtarët mund të ishin në pozitën tonë.


Dhurimi i gjërave të vjetruara dhe sendeve të pavlerë, nuk përbën kriterin e dhurimit të një besimtari; ky kriter shprehet më së miri në ajetin vijues:

**“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (parsi) që e doni.”** (Al-i Imran, 92)

Po ashtu vlen të theksohet se menazhimi i duhur i ekonomisë familjare së pari është detyrë e zonjës së shtëpisë. Nëse ajo tregohet e kujdes-shme dhe e matur në çështjet e veshmbathjes, ngrënies dhe pirjes, atëherë sado të ulëta të jenë të ardhurat e familjes, në të do të mbizotërojë mirëqenia, begatia dhe paqja.

Si rrjedhojë e mosrespektimit të këtyre parimeve, fatkeqësisht me dhjetra ton bukë

*Burri dhe gruaja duhet të respektojnë detyrimet e jetës së përbashkët dhe të mbështesin gjithmonë njëri-tjetrin përballë sfidave të jetës. Ata duhet të jenë bastun për njëri-tjetrin sa herë të kenë nevojë për mbështetje.*



hidhen çdo ditë në mbeturina.

Në të vërtetë një grua kursimtare duhet të sigurojë që jo vetëm buka, por çdo gjë që hyn në shtëpi të jetë në masën e duhur dhe të përdoret në vendin e duhur. Sepse hedhja e diçkaje pa e konsumuar fare është një formë shpërdorimi të cilën vetëm gratë e kujdesshme mund ta parandalojnë.

Në të kaluarën gratë ishin shumë të kujdesshme dhe të gatshme të qepnin ose të riparonin rrobat e grisura me qëllim që të mos shpërdoronin. Ndërsa sot shumica e tyre preferon të blejë menjëherë diçka të re pas grisjes më të vogël. Kjo reflekton një edukatë jo të mirë të shpërdorimit.

Veshja e diçkaje të vjetruar reflekton një lloj modestie. Po ashtu kjo përbën edhe një këshillë që mbron këdo që ngulit sytë e smirës në lumturinë dhe paqen e një familjeje.

Me pak fjalë, nëse për zonjat e shtëpisë jeta e ahiretit është parësore, familja e tyre do të përjetojë lumturinë e dy jetëve...

*Nëse gruaja e sheh se burri ka nevojë të këshillohet, ajo duhet t'i gjendet pranë bashkëshortit dhe ta mbështesë me sinqeritet duke i ofruar mendimin e saj më të drejtë.*

Kështu, asnjë dallgë e jetës nuk do mund të prishë harmoninë e familjes. Për rrjedhojë çerdhet familjare të ngritura me përkushtimin e një gruas fisnike, do të shndërrohen në kop-shte xheneti. Në këto kushte, burrit i mbetet ta kuptojë vlerën e një gruaje të tillë, ta mbrojë dhe të tregohet mirënjohës ndaj saj.

## NJË BURRË MIRËNJOHËS, NJË BABA I MIRË

Themelet e sigurta të lumturisë familjare mbështeten në administrimin e një babai të përkushtuar.

Një baba i mirë është ai i cili përmbush më së miri detyrat familjare, si: sigurimin e të ardhurave, edukimin, mbrojtjen dhe përkujdesjen ndaj familjes. Kjo kërkon që një baba të jetë i aftë, i ditur, vigjilent, me përvojë dhe mbi të gjitha besimtar i devotshëm dhe njeri i edukuar.

Feja jonë e shtrenjtë i ka ngarkuar burrit

*Burri dhe gruaja  
nuk duhet të harrojnë asnjëherë  
që janë bashkudhëtarë në rrugëtimin e jetës  
së kësaj bote dhe botës tjetër.*



përgjegjësinë për të siguruar të ardhurat e familjes.

Për këtë arsye, për një person që është i paaftë të sigurojë të ardhurat vetjake fillimisht nevojitet të sigurojë një burim jetese para se të ndër marrë hapin e martesës.

Megjithatë, edhe nëse mundësitë ekonomike janë të ulëta, Allahu i ndihmon ata që mendojnë të martohen për të jetuar më mirë fenë e tyre.

Sepse Allahu i Madhëruar e ka nxitur martesën duke tërhequr vëmendjen në gjerësinë e mirësisë së Tij:

**“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllëverit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm!”**

**Nëse janë të varfër, Allahu, do t’i begatojë ata me dhuntinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshtëm.”** (Nur, 32)

Siç kuptohet nga ky ajet; ata që mund të përballojnë barrën materiale të martesës du-

*Nga ana tjetër gruaja duhet t’i shmangët kritikës dhe këshillimit të burrit pranë të tjerëve.*

*Sado që të ketë gabuar, ajo nuk duhet ta turpërojë burrin dhe të shfaqë mangësitë e tij në mesin e të tjerëve. Kjo bie ndesh me parimet etike.*

het të martohen sa më shpejt të jetë e mundur, ndërsa ata që nuk mund ta përballojnë këtë barrë me mundësitë e tyre duhet të ndihmohen nga të tjerët.

Kjo është një përgjegjësi e shoqërisë islame. Është një portë e madhe bamirësie. Kështu ruhet nderi i shoqërisë dhe individit.

Nderi dhe dëlirësia është një tipar i çmuar që i është dhënë vetëm njeriut, ndryshe nga kafshët, për të cilat nuk mund të flitet për nderin e tyre. Kësisoj nëse njeriu e humb këtë tipar, natyrisht ai bie në nivelin e kafshëve.

Në ditët tona, shpesh njerëzit gabojnë duke e shtyrë martesën deri sa të arrijnë ndërtimin e një shtëpie me kushte optimale. Kjo e zgjat moshën martesore deri në 30 vjeç.

Është e pamundur që rinia e sotme t'i shpëtojë tundimeve të epshit në një kohë si kjo e jona. Për rrjedhojë, nëse ekziston mundësia për t'u martuar nuk është mirë të shtyhet pa ndonjë arsye.

*Burri dhe gruaja duhet të ruajnë  
të fshehtat e njëri-tjetrit.*

*"Ato (bashkëshortet) janë petk për ju  
e ju jeni petk për ato."*

(Bakare, 187)



## RESPEKTIMI I EKUILIBRIT

Nuk ka dyshim që mençuria, fuqia, aftësia, veçoritë dhe prirjet që Allahu i ka dhënë secilit njeri, janë të ndryshme. Për rrjedhojë kanë lindur temperamente dhe profesione të ndryshme. Nevoja për çdo profesion dhe profesionistë në çdo fushë, është një domosdoshmëri për të siguruar rendin shoqëror. Për rrjedhojë në shoqëri duhet të ketë mjekë, mësues, kasapë, patrues etj...

Kështu që të gjithë duhen të përpiqen të ndërtojnë një familje në përputhje me mundësitë e tyre. Gjatë ndërtimit të kësaj familjeje, palët duhet të gëzojnë pozita shoqërore të ekuilibruara.

Ky ekuilibër nuk nënkupton vetëm aspektin ekonomik por shpreh edhe baraspeshën në çështjen e mirësjelljes, diturisë dhe zakoneve. Nëse respektohet parimi i baraspeshës, familja nuk do të tronditet nga kërkesat e ndërsjella të palëve. Përkundrazi, anëtarët e familjes do të mirëkuptohen lehtësisht.

*Themeli i arritjes së lumturisë  
në këtë jetë dhe në jetën tjetër është  
vlerësimi dhe respektimi i ndërsjellë midis  
burrit dhe gruas. Ata duhet ta dinë mirë  
vlerën e njëri-tjetrit.*

Mungesa e ekuilibrit midis bashkëshortëve e bën thuajse të pamundur jetën e përbashkët familjare aq sa mund të shkaktojë edhe zhgënjimin e palëve, përveç rasteve të rralla ku ndjenja e fortë e dashurisë mund të bëhet pengesë e këtij zhgënjimi.

Në këtë kontekst poeti Mevlana, domosdoshmërinë e ekuilibrit midis bashkëshortëve e shpreh me fjalët:

“Ç’vlerë kanë këpucët nëse njëra është me vogël se tjetra?!”

Nuk duhet harruar se martesat janë kontratë (marrëveshje) e përjetshme dhe se me kalimin e kohës emocionet e përjetuara në muajt e parë fillojnë të zbehen dhe të bien në nivele normale. Për rrjedhojë, martesat e lidhura mbi parimin e ekuilibrit midis familjeve kanë rezultuar gjithnjë më të dobishme dhe të duhura.

Kjo do të thotë që, njerëzit të cilët përtej pozitës materiale, ndajnë të njëjtat ndjenja, qëllime dhe kënaqësi shpirtërore e kanë më

*Nëse bashkëshortët respektojnë parimet e bukura të moralit, ata do të bëhen xheneti i njëri-tjetrit. Në të kundërt, nëse shkelin mbi këto parime, ata do të bëhen xhehenemi i njëri-tjetrit.*



## **të lehtë të mirëkuptohen dhe të jetojnë një jetë të përbashkët.**

Sigurimi i të ardhurave familjare i përket babait. Ai ka për detyrë të plotësojë nevojat familjare të strehimit, ushqimit dhe veshmbathjes me aq sa ka mundësi. Por, nga ana tjetër, nëna dhe fëmijët nuk kanë të drejtë të kërkojnë diçka që është përtej mundësisë dhe fuqisë së babait për të fituar.

Babai përmbush kërkesat familjare në përputhje me kushtet dhe zakonet e vendit ku jeton.

Mundësisht banesa duhet të sigurohet në një vend afër xhamisë dhe fqinjët e familjes të jenë njerëz të mirë, të respektuar.

Baballarët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj ushqimeve dhe frutave që i pëlqejnë më shumë fëmijëve. Në mënyrë të veçantë ata duhet të tregohen të ndjeshëm sidomos ndaj vajzave të cilat mund të turpërohen të kërkojnë diçka.

Ata duhet t'i trajtojnë mysafirët me bujari dhe respekt. Ky është një virtyt moral, po aq

*H. Ibrahim shkoi ta vizitonte djalin e tij H. Ismailin, kur ai nuk ishte në shtëpi. Në derë e priti e shoqja e cila ankua për H. Ismailin.*

*H. Ibrahim i tha:*

*"Thuaji bashkëshortit tënd ta ndryshojë pragun e derës."*

*H. Ismaili e kuptoi mesazhin e tij dhe e ndau të shoqen.*





edhe një nderim njerëzor. Mysafiri është bereqeti i shtëpisë.

Sa i takon çështjes së veshmbathjes, babai duhet të përmbushë nevojat e fëmijëve në përputhje me parimet e fesë dhe traditën e vendit. Ai nuk duhet të lejojë që të përdoren veshje transparente, të ngushta, të papërshtatshme qoftë edhe për fëmijët e vegjël në mënyrë që ato të mos i qasen një veshjeje të tillë që në moshtë të vegjëlisë. Po ashtu duhet bërë kujdes që veshjet e vajzave dhe të djemve të bëjnë dallim nga njëra-tjetra.

## PARIMI NË VESHJE

Sa i takon veshjes, Islami ka vendosur disa rregulla që janë në përputhje me dinjitetin njerëzor. Një nga këto është parimi që veshja nuk duhet të jetë aq transparente dhe e ngushtë sa të zbulojë format e trupit.

I Dërguari i Allahut kur pa se motra e Hz. Aishes, Esmë kishte veshur një fustan të hollë, ktheu kokën dhe tha:

*Hë. Ismaili u martua përsëri me një grua që karakterizohej nga virtyti i mirënjohjes. Kur Ibrahim i a.s. erdhi ta vizitonte i tha:*

*“Thuaji bashkëshortit ta mbajë mirë pragun e derës.”*



*“O Esmâ! Pasi gratë të kenë arritur moshën e pjekurisë, nuk duhet të zbulojnë asnjë pjesë të trupit përveç kësaj dhe kësaj (duke treguar fytyrën dhe duart).” (Ebû Dâvûd, Libâs, 31)*

Kjo është një nga bazat themelore që Islami ka vendosur në mënyrë që të parandalojë sjelljet që dëmtojnë feminitetin, nderin dhe dinjitetin e gruas.

Si burri ashtu edhe gruaja duhet të respektojë në mënyrë të përpiktë dhe të mos hedhë hije mbi këtë virtyt dhe nder që i është bërë gruas që në krijimin e saj.

## URTËSIA E HIXHABIT (MBULESËS)

Mbulesa e gruas është mbrojtje e personalitetit të saj. Me këtë mbulesë ajo përcjell hijeshi dhe mirësi tek të tjerët.

Përndryshe, femra mund të shihet si një burim provokimi të prirjeve epshore. Kjo dëm-

*Për shkak të kartave të kreditit gjithnjë e më të përhapura në ditët tona, shumë familje që mendojnë se mund të marrin me lehtësi gjithçka që shohin, bien në vorbullën e borxheve dhe kamatës si rezultat i harxhimeve të panevojshme.*

ton personalitetin dhe dinjitetin e saj dhe zbeh imazhin e bukur të mëmësisë.

Këtu duhet të theksojmë edhe një pikë tjetër me rëndësi:

Natyra e krijimit të burrit dhe të gruas ndryshon nga njëra-tjetra. Ky fakt buron nga veçoritë dhe përgjegjësitë e ndryshme me të cilat janë ngarkuar burrat dhe gratë. Kësisoj, forma e mbulesës së gruas është e ndryshme nga ajo e burrit.

Allahu i Lartësuar mbulesën e femrës në Kuranin Famëlartë e shpreh me fjalën “**xhilibab**”, e cila nënkupton një veshje që nuk tregon format e trupit. (Ahzab, 59)

Femra është më tërheqëse se mashkulli. Nëse ajo e zbulon veten në shoqëri, atëherë mund të zbehet hijeshia dhe dëlirësia me të cilën karakterizohet. Po aq edhe imazhi i mëmësisë dhe përkujdesja ndaj brezit të ri mund të dëmtohen.

Nisur nga kjo, urdhri për mbulesën e femrës nuk lë shteg që hiri dhe bukuria e saj t'i

*Një grua durimtare  
dhe mirënjohëse, falënderuese  
është perla më e çmuar  
e bashkëshortit të saj.*



shfaqen tjetërkujt pos bashkëshortit. Tërheqja mes dy gjinive të kundërta është një prirje e natyrshme njerëzore, andaj nëse nuk respektohet urdhri i mbulesës kjo prirje mund të shkaktojë një kolaps moral aq të rrezikshëm sa të përfundojë deri në prishjen e kufijve hyjnorë. Kështu Allahu i Lartësuar në ajetin kuranor paralajmëron:

وَلَا تَقْرَبُوا الزَّوْنَىٰ

“Dhe mos iu qasni imoralitetit.” (Isra, 32)

Pra, mos i hapni rrugën imoralitetit duke nëpërkëmbur urdhrin e mbulesës.

Ky është një urdhër absolut, i pakushtëzuar. Nëse vërejmë me kujdes, shohim se Islami ka udhëruar mbulesën e çdo femre qoftë ajo tërheqëse në dukje apo jo.

Pra, nuk mund të thuhet: “Kjo grua nuk është tërheqëse andaj mund të zbulojë cilëndo pjesë të trupit të saj.” Këtu është thelbësore të mbrohet dinjiteti i gruas përmes mbulesës së saj.

Nisur nga fakti se Islami, merr për bazë

*“Jepuni të afërmeve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.”*

(Isra, 26-27)

natyrën e ndryshme të krijimit të mashkullit dhe të femrës i Dërguari i Allahut ka mallkuar meshkujt që përpiqen t'u ngjajnë femrave dhe femrat që përpiqen t'u ngjajnë meshkujve. (Buhârî, Libâs, 61)


Për t'u mbrojtur nga ky rrezik, gratë e mira duhet të përpiqen të jenë të pranishme në ambiente të duhura.

Sepse njeriu nuk mund të rri pa u ndikuar nga personi me të cilin shoqërohet. Ky është një ligj i psikologjisë. Kur gruaja përfshihet në një ambient të përzier me burrat nuk mund t'i shpëtojë humbjes së hijeshisë femërore me të cilën karakterizohet.

Përngjasimi i burrave dhe grave në stilin e veshjes është po ashtu i ndaluar. Pejgamberi ﷺ ka bërë të ditur se mashkulli që vishet si femër dhe femra që vishet si mashkull janë larg mëshirës së Allahut. (Ebû Dâvûd, Libâs, 28/4098) Kjo sepse të dy palët duhet të ruajnë karakteristikat përkatëse të gjinisë së tyre.

Për më tepër, imitimi i veshjeve të gjinisë

*Si rezultat i tendencës së njeriut për të imituar, familjet fillojnë të ndjekin shembullin e njëra-tjetrës në çështjen e shpërdorimit duke e kthyer atë në një epidemi. Kjo natyrisht e bën më të lehtë punën e djallit.*



së kundërt shkakton çrregullime të personalitetit dhe karakterit. Për shembull, njerëzit që adoptojnë stilin e veshjeve që i përkasin gjinisë së kundërt -për çfarëdolloj arsye qoftë-, me kalimin e kohës fitojnë tipare dhe sjellje karakteristike të asaj gjinie.

Kjo nënkupton prishjen e natyrshmërisë së krijimit.

Nga ana tjetër;

Ndarja e dhomave të djemve dhe vajzave para se të arrijë moshën e pjekurisë është gjithashtu një nga çështjet që duhet të merren parasysh për të siguruar pjekurinë shpirtërore dhe për të ngulitur personalitetin e fëmijëve tanë.

Burrat janë mbrojtësit (kavvam) e familjes, pra udhëheqësit (drejtuesit) e familjes.

Një ndër detyrat më të rëndësishme të burrit është mbrojtja e familjes pra e gruas dhe fëmijëve përmes edukimit të duhur moral dhe fetar për të mundësuar lumturinë në jetën e dy botëve. Këtë detyrë thelbësore Kurani Famëlar-të e shpreh me fjalët:

*Gëzimi i nevojtarëve dhe fitimi i lutjes (duasë) së tyre të sinqertë është garanci për bereqetin dhe lumturinë e familjes. Nuk duhet harruar se besimtari është përgjegjës për vëllanë e tij besimtar dhe po ashtu nuk duhet të harrojmë se ne mund të ishim ne pozitën e nevojtarëve dhe nevojtarët mund të ishin në pozitën tonë.*

**“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** (Tahrim, 6)

Një baba i mirë, duhet t'i japë rëndësi edukimit të familjes me frymën kuranore dhe t'ua mundësojë fëmijëve të shijojnë kënaqësinë e adhurimit. Po aq me rëndësi është t'u tregojë rrugën, metodën dhe etikën e duhur në lidhje me çështjet e dynjasë dhe ahiretit. Në këtë kontekst kur fëmijët arrijnë moshën shkollore duhet të dërgohen në kurse verore dhe më pas me mbarimin e arsimit fillor duhet të marrin edukimin e duhur në kurset e Kuranit. Kjo është edhe më thelbësore, veçanërisht për vajzat.

Nuk duhet harruar që;

Pasuria më e çmuar që mund t'u lihet pasardhësve (fëmijëve) është trashëgimia e Ahiretit.

Lum për ato nëna dhe baballarë që i bëjnë fëmijët e tyre hafiza dhe i zbukurojnë me kulturën kuranore (e Kuranit)!

Në hadithin profetik thuhet:

*Dhurimi i gjërave të vjetruara dhe sendeve të pavlerë,  
nuk përbën kriterin e dhurimit të një besimtari;*

*ky kriter shprehet më së miri në ajetin vijues:*

*“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë,  
derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni.”*

(Al-i Imran, 92)



*“Kush e lexon Kuranin dhe punon sipas tij, në Ditën e Gjykimit prindërve të tij do t’u vendoset një kurorë. Drita e kësaj kurore është më e bukur se drita që mund të japë (përcjellë) dielli nëse do vendosej brenda një shtëpie në tokë. Vallah, si mund të jetë drita e atij që vetë punon sipas Kuranit? Mendoni...!”* (Ebû Dâvûd, Vitr, 14)

Si rezultat i neglizhimit të misionit prindëror në edukimin e fëmijëve duke lënë pas dore edukimin e tyre shpirtëror, sot fatkeqësisht këto fëmijë po brumosen me një mentalitet materialist, pjellë e një medieje dashakeqe. Kështu këto fëmijë po mëkohen nga televizioni, pamja e tyre e jashtme po formësohet nga interneti, ndërsa ëndrrat dhe emocionet (bota e brendshme) e tyre po diktohen nga moda dhe reklamet.

Në këto kushte prindërve u mbetet vetëm të plotësojnë kërkesat e tyre. Po ashtu është për të ardhur keq gjendja e fëmijëve që bien në batakun e programeve imorale të servirura djallëzisht nga interneti. Heshtja ndaj këtyre realiteteve të dhimbshme është kushtim i një llogaridhënieje të vështirë para Krijuesit Fuqiplotë.

*Në të vërtetë një grua  
kursimtare duhet të sigurojë  
që jo vetëm buka, por çdo gjë që hyn  
në shtëpi të jetë në masën e duhur dhe të  
përdoret në vendin e duhur.*



Burri ka për detyrë ta mbrojë familjen e tij nga çdo e keqe. Ai duhet t'i mbajë larg anëtarët e familjes nga çdo lidhje, miqësi, vizita apo pushime, programe televizive, libra, gazeta dhe çfarëdolloj botimesh pa nivel që prishin vlerat fetare dhe morale të familjes.


Me pak fjalë, burri duhet ta orientojë familjen e tij për një jetë të devotshme. Por;

## PA HARRUAR VETVETEN

Edhe burri duhet të jetë i kujdesshëm në lidhje me kufijtë që ka vendosur feja, dhe nëse nuk është i detyruar, duhet të përpiqet të mos gjendet në ambiente të përziara ku gratë dhe burrat punojnë së bashku. Kjo çështje duhet të merret në konsideratë në zgjedhjen e arsimit dhe profesionit.

Ata që janë në pozicionin e punëdhënësit duhet të mundohen të mos krijojnë mjedise të përzier pune, dhe nëse është e nevojshme, duhet të organizojë kohë dhe vende të veçanta pune për burra dhe gra.

*Nëse gruaja tregohet e kujdesshme dhe e matur në çështjet e veshmbathjes, ngrënies dhe pirjes (të ushqyerit), atëherë sado të ulëta të jenë të ardhurat e familjes, në të do të mbizotërojë mirëqenia, begatia dhe paqja.*



Në ambientet e punës duhet të shmanget qëndrimi vetëm për vetëm me çdo personel ndihmës, si psh. sekretare, zëvendëse etj., të gjinisë së kundërt.

Realiteti i sotëm tregon se këto përzgjedhje të gabuara kanë çuar deri në divorce dhe shkatërrime të familjeve.

Në hadithin profetik thuhet:

*“Kur një burrë qëndron vetëm për vetëm me një grua, i treti në mesin e tyre është shejtani.”*

(Tirmidhî, Radâ, 16/1171; Fiten, 7/2165; Ahmed, I, 18, 26)

Një burrë i mençur dhe i urtë ndërsa shkel në pragun e shtëpisë nuk sjell me vete problemet e punës. Me fjalë të tjera, ai di ta ruajë paqen dhe harmoninë familjare duke mbajtur larg saj shqetësimet dhe problemet e punës.

Në marrëdhëniet me bashkëshorten dhe fëmijët ai duhet të tregohet falës i gabimeve dhe të metave në lidhje me çështjet e kësaj bote dhe t'u qaset atyre me dhembshuri dhe butësi.

Ai duhet të fshehë nga të gjithë të metat dhe mangësitë e bashkëshortes së tij.

*Familja do arrijë të përjetojë  
lumturinë e dy botëve dhe do kalojë  
çdo sprovë me lehtësi,  
për sa kohë nënat tona fisnike  
të synojnë jetën e Ahiretit.*

Nga ana tjetër, duhet t'i qaset me seriozitet mangësive dhe neglizhencës së saj në lidhje me çështjet e fesë dhe të mundohet të plotësojë zbrazëtinë e padijes dhe dembelizmit. Në çdo moment ai duhet të jetë i gatshëm të plotësojë mungesën e njohurive fetare të bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Ashtu sikurse mund të kontribuojë vetë në këtë drejtim, mund të përfitojë edhe nga njerëz të ditur dhe të aftë. Këto praj janë ndër detyrat e baballarëve. Në veçanti, ata duhet të jenë të gatshëm t'i edukojnë pasardhësit me një karakter dhe personalitet islam sesa t'u lënë një trashëgimi thjesht materiale.

Brenda ambienteve të familjes, burrat duhet të sillen me butësi, të përdorin fjalë të bukura dhe të hijshme. Ata nuk duhet të sillen me vrazhdësi dhe të qëndrojnë me fytyra të vrenjtura. I Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Më i miri nga ju është ai i cili sillet më mirë me bashkëshorten e tij.”* (Tirmidhî, Radâ, 11. Shih edhe: Ebû Dâvûd, Sunnet, 15; Ibn-i Mâxhe, Nikâh, 50)

Burri duhet të konsultohet dhe të marrë mendimin e bashkëshortes së tij në çështjet fa-

*Veshja e diçkaje të vjetruar  
reflekton një lloj modestie. Po ashtu  
kjo përbën edhe një recetë shpirtërore  
mbrojtëse për këdo që ngulit sytë  
e smirës në lumturinë dhe paqen  
e një familjeje.*



miljare dhe nuk duhet t'i ngarkojë barra të rënda që tejkalojnë mundësitë e saj. Ai, herë pas here duhet ta ndihmojë bashkëshorten në edukimin e fëmijëve. Sepse fëmijët dhe punët e shtëpisë e lodhin gruan së tepërmi. Kjo e përforcon me tepër lidhjen midis bashkëshortëve duke shtuar mirëkuptimin dhe dashurinë midis tyre.

Ai duhet të lutet për bashkëshorten, në prani dhe në mungesë të saj.

Bashkëshorti nuk duhet të niset në udhëtime të largëta pa dijeninë e bashkëshortes. Po ashtu nuk duhet të sjellë mysafirë të huaj në shtëpi pa dijeninë e saj. Ai nuk duhet t'i kërkojë bashkëshortes të takojë dhe t'i shërbejë njerëzve të huaj (që për të nuk bëjnë pjesë në kategorinë e njerëzve të afërt). Ai duhet ta mbajë familjen e tij larg ambienteve të përziera sa më shumë të jetë e mundur.

## SHPËRBLIMI I NJË BABAI TË VIRTYTSHËM

Babai është një diell në qiellin e lumturisë

*“Pa dyshim, ata që lexojnë  
Librin e Allahut, falin namazin dhe japin  
fshehurazi apo haptazi nga ajo që u kemi  
dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim  
që nuk do të humbasë.”*

(Fatir, 29)



familjare, nëna është një hënë që shkëlqen butësisht dëlirësinë e saj, ndërsa fëmijët janë yjet e atij qielli virtytesh të bukur si margaritarë.

Një baba i cili me gjithë fuqinë, vullnetin, dijen dhe përvojën e tij i përkushtohet edukimit, mirëqenies dhe të ardhmes së familjes, natyrisht meriton respekt, bindje dhe dashuri. Mosbindja, mosmirënjohja dhe mungesa e respektit ndaj një babai të tillë është tejet e papranueshme.

Për këtë arsye, Profeti ka thënë:

*“Kënaqësia e Allahut fshihet në kënaqësinë e prindit, ndërsa dënimi dhe zemërimi i Tij, fshihet në pakënaqësinë dhe zemërimin e prindit.”*

(Tirmidhî, Birr, 3)

Gruaja dhe fëmijët duhet të shprehin përherë respekt dhe nderim ndaj babait si përgjegjësi i parë i familjes. Sepse çdo ditë në mungesë të babait pasohet nga një natë e trishtë. Pesha e vërtetë e tij ndihet shumë më thellë kur ai nuk është më. Kësisoj, duhet t’ua dimë vlerën ballarëve tanë, kur janë ende në mesin tonë, të

*“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllëvërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm!  
Nëse janë të varfër, Allahu, do t’i begatojë ata me dhuntinë e Tij; Allahu është i Gjerë në mirësi dhe i Gjithëdijshëm.”*

(Nur, 32)



mundohemi ta fitojmë duanë e tyre, t'i bindemi urdhrave të tyre dhe t'i respektojmë ashtu siç e meritojnë.

Lusim Krijuesin Fuqiplotë t'i dhurojë çdo familjeje islame lumturinë në jetën e dy botëve. Çerdhet familjare të ngritura si djepi i lumturisë në jetën e kësaj bote, qofshin urë lidhëse për lumturinë e përhershme në jetën e përtejme.

Amin!..

*Një grua që rrokulliset në vorbullën e nefsit,  
ngjan me një lule që çel në trotuare. Herët apo  
vonë ajo shkelet nën këmbët e kalimtarëve. Sa keq  
për një diamant që bie në koshin e fundërrinave.*





# Pëmbajtja

Një krahasim midis së shkuarës dhe të tashmes.....	13
Nënat e nderuara.....	25
Edukimi i paqes në familje.....	83
Detyrat e prindërve të përkushtuar ndaj fëmijëve të tyre.....	115
Detyrat e burrave dhe grave për të arritur lumturinë në jetën e dy botëve .....	137